RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"MBI AUDITIMIN FINANCIAR"

BASHKIA KOLONJË

Tiranë, shtator 2026

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
AK	Autoritet Kontraktore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
UP	Urdhër Prokurimi
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

		PËRMBAJTJA	Faqe
SHKURTIME			**2-2**
I		**PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4-10**
	1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	4-5
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-8
	3	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	8-10
II.		**HYRJA**	**10-15**
	1	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	10-10
	2	Identifikimi i çështjes	10-11
	3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11-11
	4	Përgjegjësitë e audituesve	12-12
	5	Kriteret e vlerësimit	12-13
	6	Standardet e auditimit	13-14
	7	Metodat e auditimit	14-14
	8	Dokumentimi i auditimit	14-15
III.		**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	
	1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	15-16
	2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	**16-121**
	2.1.1	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	16-36
	2.2.1	Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	36-59
	2.3.1	Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025	59-94
	2.4.1	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	94-121
IV.		**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**122-150**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Kolonjë është njësi vendore institucion i pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim i 2 (dy) ish- Bashkive Ersekë, Leskovik dhe katër ish-komunave.

Për vitin 2025 Bashkia Kolonjë është e ndarë në 8 njësi administrative si vijon: Njësitë administrative Ersekë, qendër Ersekë, Leskovik, qendër Leskovik, Novoselë, Barmash, Mollas, Çlirim.

Buxheti i Bashkisë Kolonjë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj. Planifikimi i buxhetit për vitin 2025 është në vlerën 601,284 mijë lekë dhe realizimi është në vlerën 525,894 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "*Për financat e qeverisjes vendore*", nenit 50 "*Auditi i jashtëm*", pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Kolonjë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Kolonjë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.*
- *mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.*
- *mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2025.*
- *mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. ***Vlerësimi i riskut të kontrollit;***

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2025 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 10,588 mijë lekë dhe gabimi i lejuar *(10% - 20%)* në vlerën 1,058 mijë lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është

arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli);
Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 22 gjetje dhe ka dhënë 29 rekomandime, nga ku masa organizative 20 gjetje dhe 26 rekomandime masa për eliminimin e efekteve negative financiare te konstatuara ne administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficecne dhe efektivitet te ardhura te munguara 2 gjetje dhe 3 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.
-Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 520 *"Disponibilitete në thesar"* është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2025 në shumën 59,349,003 lekë e cila nuk përputhet me pasqyrën e aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 "*Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor"* e cila është paraqitur në vlerën 48,932,109 lekë. Mos përputhja është për vlerën 10,416,894 lekë e cila konstatohet që është vlera e llogarisë 466 "*Kreditorë në ruajtje".*
-Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*" paraqitet në fund të vitit 2025 në shumën prej 75,934,838 lekë.
Konstatohet që llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*" nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Bashkisë Kolonje. Detyrimet e 32 individëve dhe subjekteve për gjoba policie dhe gjoba IMT në vlerën 4,580,500 lekë janë keq klasifikuar në llogarinë 423-429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* dhe duhej të klasifikohej në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"*.
Llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*" është nënvlerësuar në vlerën 4,580,500 lekë dhe llogaria 423-429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* është mbivlerësuar në vlerën 4,580,500 lekë
- Nga auditimi i llogarisë 202 *"Studime dhe Kërkime"* në regjistrin e aktiveve nuk është mbajtur në mënyrë analitike për çdo projekt sipas vitit të hyrjes, vlerës së blerjes, por projektet e çdo viti janë bashkuar në një zë.
Konstatohet që janë 17 projekte investimesh në vlerën 37,157,606 lekë (kosto historike) që janë të përfshirë në llogarinë 202 "*Studime dhe kërkime"* nuk ka informacion të saktë nëse këto investime janë kryer, objektet kanë përfunduar ose jo duke qenë që shumica e tyre i përkasin periudhave të hershme para vitit 2025.
- Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 210 *"Toka, Troje, terrene"* paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën neto 3,330,850 lekë . Llogaria 211 "*Pyje, kullota, plantacione"* paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën neto 25,909,872 lekë. Llogaria 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën neto 497,804,348 lekë. Llogaria 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën neto 2,232,363,500 lekë. Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 214

“Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë” paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitin 2025 në vlerën 55,151,317 lekë vlere e mbetur.
- Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 215 *“Mjete transporti”* paraqitet në vlerën neto 15,487,066 lekë.
Konstatohet që nuk disponohet regjistër analitik i aktive të mësipërme dhe vlera historike e aktiveve është e pa analizuar si në kontabilitet ashtu edhe në gjendjen fizike dhe ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
- Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 218 *“Inventar ekonomik”* paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 7,887,006 lekë me vlere neto në fund të vitit 2025.Nga auditimi i llogarisë 218 *“Inventar ekonomik”* u konstatua që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje nuk disponon të dhëna të sakta analitike të llogarisë për vitin e krijimit të shtesës se llogarisë si dhe ka ndryshim midis të dhënave sipas regjistrit të aktiveve me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b. Sipas regjistrit të aktiveve vlera e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik”* është në shumen 61,882,490 lekë ndërsa sipas Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b është 65,171,094 lekë ose me një ndryshim prej 3,288,604 lekësh e paraqitur me shume në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b, rrjedhimisht për vlerën 3,288,604 lekë Drejtoria e Financës nuk disponon informacion për gjendjen e saj kontabël analitike.
- Nga auditimi i pasqyrës se pozicioni financiar u konstatua që llogaria 26 *‘‘Pjesëmarrje në kapitalin e vet’’* është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën zero lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 625,621 lekë.
-Konstatohet që ka mospërputhje midis shtesës se aktivit llogaria 21 *“Aktive afat gjata materiale”* vlerës debitorë të saj dhe pakësimit të llogarisë 231*“Investime për aktive afatgjata materiale”* vlerës kreditore të saj për vlerën 5,433,658 lekë (33,474,388 - 28,040,730). Llogaria 21 *“Aktive afat gjata materiale”* është nënvlerësuar për vlerën 5,433,658 lekë.
- Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Kolonje në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 10,416,894 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Konstatohet që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka të detajuara për 30 projekte vlerën prej 8,937,618 lekë dhe për vlerën prej 1,479,276 lekë nuk disponon informacion të detajuar se kujt investimi i përket kjo vlere e ngurtësuar në llogarinë 466 *“Kreditorë për mjete në ruajtje”*.
- Nga auditimi i paraqitjes se llogarisë 4341‘‘*Operacionë me shtetin detyrime*’’ në pasqyrën e pozicionit financiar u konstatua që kjo llogari është mbivlerësuar për shtesën e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 vlerën 4,229,644 lekë. Konstatohet që llogaria 470 *‘‘Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë’’* është nënvlerësuar për shtesën e debitorëve për vitin 2025 vlerën 4,229,644 lekë.
-Sipas informacionit kontabël llogaria 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”* është paraqitur në vlerën 2,990,399,663 lekë në fund të vitit 2025 dhe duhej të paraqitej në vlerën 2,945,107,271 lekë ose është paraqitur 45,292,392 lekë më shume (2,990,399,663-2,945,107,271=45,292,392).Llogaria 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”* është mbivlerësuar për vlerën 45,292,392 lekë
- Nga auditimi u konstatua që ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave llogaria 720 *“Grant korrent i brendshëm”* në pasqyrën e performancës financiare, pasi duhej të paraqitej në vlerën 432,798,690 lekë (466,736,101-33,937,411) dhe është paraqitur 425,314,889 lekë ose është paraqitur 7,483,801 lekë me pak (432,798,690 - 425,314,889). Llogaria 720 *“Grant korrent i brendshëm”* në pasqyrën e performancës financiare është nënvlerësuar për vlerën 7,483,801 lekë duke ndikuar negativisht

në rezultatin e vitit ushtrimor për vlerën 7,483,801 lekë.
-Nga auditimi u konstatua që pasqyrimi i pagave llogaria 6001 ***"Paga, personel i përhershëm"*** në pasqyrën e performancës financiare është pasqyruar në vlerën 247,675,842 lekë ose është pasqyruar 4,393,789 lekë me shume (247,675,842 - 243,282,053) në pasqyrën e performancës financiare duke u mbi vlerësuar për vlerën 4,393,789 lekë dhe duke ndikuar negativisht në rezultatin e vitit ushtrimor për vlerën 4,393,789 lekë.
-Llogaria 85 "*Teprica ose deficiti i periudhës*" është pasqyruar 48,932,109 lekë në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2025. Konstatohet që si pasoje e pasqyrimit të pasakte të llogarisë 720 *"Grant korrent i brendshëm"* në pasqyrën e performancës financiare për vlerën 7,483,801 lekë dhe llogarisë 6001 "Paga, personel i përhershëm" për vlerën 4,393,789 lekë ,llogaria 85 *"Teprica ose deficiti i periudhës"* është nënvlerësuar për vlerën 11,877,590 lekë (7,483,801 + 4,393,789).
-Nga auditimi i aktiveve afatgjata u konstatua se nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot respektivisht; 202- *"Studime dhe kërkime"*, 210 *"Toka, Troje, terrene"*, 211 *"Pyje, Plantacione"* 212 *"Ndërtesa e Konstruksione"*, 213 "*Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore"*, 214 *"Instalime teknike, makineri e pajisje"*. Proces verbalet e inventarizimit nuk kanë evidentuar llogarite kontabël të inventarizuara për llogarite 31 *"Materiale"*; 32 *''Inventar i imët"* dhe llogarinë 218 *"Inventar ekonomik"*. Inventarizimi në proces verbale përfshin vlera të grupuara të llogarive dhe jo identifikim të vlerave sipas kartelave të llogarive 31 *"Materiale"* Llogaria 32 *''Inventar i imët"* llogaria 218 "*Inventar ekonomik"* rrjedhimisht nuk janë hartuar në mënyre të plote dhe të sakte. Nga auditimi u konstatua se procesi i inventarizimit të aktiveve është kryer me proces verbale të gjendjeve të aktiveve dhe vlerësimit të tyre me shkresa të pa protokolluar në zyrën e protokoll arshivës.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:
-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa për saktësimin e mospërputhjes midis llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar"* me gjendjen e likuiditeteve në pasqyrën e aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 për vlerën 10,416,894 lekë.
-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje të marre masa për paraqitjen e sakte të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm"* duke kontabilizuar sakte shtesën për vlerën 4,580,500 lekë dhe pakësimin e llogarisë 423-429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* për vlerën 4,580,500 lekë.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje të marre masa që të saktësoje gjendjen e llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"* duke verifikuar përfundimin e 17 projekteve të investimeve me kosto historike në vlerën 37,157,606 lekë dhe paraqitjen e drejte të llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"* për objektet e përfunduara.
-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marrë masa të hartojë regjistrin e aktiveve afatgjata materiale sipas udhëzimeve përkatëse për llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 211 *"Pyje, Kullota, Plantacione"*, 212 *"Ndërtesa"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* për të dhënë informacion kontabël të saktë në lidhje me detajimin e këtyre llogarive .
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të identifikoje sakte në regjistrin e aktiveve të llogarisë 218 "*Inventar ekonomik"* të dhënat analitike të aktiveve të kësaj llogarie. të marre masa për saktësimin e mospërputhjes prej 3,288,604 lekësh midis regjistrit të

aktiveve dhe Pasqyrës se Aneksit statistikor 7/b, si dhe të siguroje që vlera historike e saj të përputhet Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të pasqyroje në llogarinë 26 *''Pjesëmarrje në kapitalin e vet''* pjesëmarrjen në kapital në shoqërinë "K" SH.A për vlerën 261,821 lekë dhe pjesëmarrjen në kapital në shoqërinë Rajonale *"UKK"* SH.A në vlerën 363,800 lekë.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të saktësoje mospërputhjen e shtesës se aktivit llogaria 21 *"Aktive afat gjata materiale"* për vlerën 5,433,658 lekë me vlerën kreditore të llogarisë 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"*.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të saktësoje të dhënat analitike të llogarisë 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* sipas objekteve përkatëse të paraqitura të ngurtësuara në llogarinë e thesarit .Te marre masa të identifikoje të dhënat analitike për vlerën 1,479,276 lekë e ngurtësuar në thesar për të cilën nuk disponon të dhëna të detajuara
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të saktësoje llogarinë 470 *''Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë'' e cila* është nënvlerësuar për shtesën e debitorëve për vitin 2025 në vlerën 4,229,644 lekë.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të saktësoje llogarinë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* për vlerën e mbivlerësuar prej 45,292,392 lekë duke e paraqitur sakte atë.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të saktësoje llogarinë 720 "*Grant korrent i brendshëm"* në pasqyrën e performancës financiare për vlerën e nënvlerësuar për vlerën 7,438,801 lekë duke e pasqyruar sakte atë.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të saktësoje llogarinë 600 *"Pagat dhe përfitimet e punonjësve"* në pasqyrën e performancës financiare për vlerën nënvlerësuar për vlerën 7,438,801 lekë duke e pasqyruar sakte atë.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje të marre masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, si dhe të marre masa për kryerjen se inventarizimit të aktiveve të bashkisë duke i verifikuar ato me gjendjen kontabël sipas kartelave të llogarive përkatëse 202 *"Studime dhe kërkime";* 210- *"Toka, Troje, terrene"*; 211 *"Pyje, Plantacione";* 212- *"Ndërtesa e Konstruksionë"*;213 *"Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore"*; 214 "*Instalime teknike, makineri e pajisje"*; 31 *"Materiale"*; 32 *''Inventar i imët"* dhe 218 *"Inventar ekonomik"*.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje të marre masa që procesin e inventarizimit të aktive ta dokumentoje me proces verbale të inventarizimit të protokolluara në zyrën e protokoll arshivës.

I.1. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2025:

Në kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Kolonjë për periudhën ushtrimore 2025, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave

financiare.

Opinioni:

" Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Kolonjë nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin e Kualifikuar"[1]*, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinionin e kualifikuar:

Në e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Në jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Në besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm. Në dhënien e opinionit, në kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 10,588 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një "Opinioni të Kualifikuar" të auditimit.

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2025, paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, trajtuar hollësisht në Raportin e Auditimit, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

-Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" nuk përputhet me pasqyrën e aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 "Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor". Mos përputhja është për vlerën 10,416,894 lekë e cila konstatohet që është vlera e llogarisë 466 "Kreditorë në ruajtje".

-Sipas regjistrit të aktiveve vlera e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" është në shumen 61,882,490 lekë ndërsa sipas Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b është 65,171,094 lekë ose me një ndryshim prej 3,288,604 lekësh e paraqitur me shume në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b, rrjedhimisht për vlerën 3,288,604 lekësh Drejtoria e Financës nuk disponon informacion për gjendjen e saj kontabël analitike.

-Llogaria 21 "Aktive afat gjata materiale" është nënvlerësuar për vlerën 5,433,658 lekë.

-Llogaria 470 ''Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë'' është nënvlerësuar për shtesën e debitorëve për vitin 2025 në vlerën 4,229,644 lekë.

-Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është mbivlerësuar për vlerën 45,292,392 lekë

-Llogaria 720 "Grant korrent i brendshëm" në pasqyrën e performancës financiare është nënvlerësuar për vlerën 7,483,801 lekë.

-Llogaria 6001 **"**Paga, personel i përhershëm**"** në pasqyrën e performancës financiare është

[1] Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar " të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (fa që 54 dhe 60-61), "Një "Opinion i Kualifikuar", jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë."*

mbivlerësuar për vlerën 4,393,789 lekë.
-Llogaria 85 "Teprica ose deficiti i periudhës", është nënvlerësuar për vlerën 11,877,590 lekë (7,483,801 + 4,393,789) si pasoje e pasqyrimit të pasakte të llogarisë 720 "Grant korrent i brendshëm" në pasqyrën e performancës financiare për vlerën 7,483,801 lekë dhe llogarisë 6001 "Paga, personel i përhershëm" 4,393,789 lekë.
-Llogaria 26 "Aktivet Afatgjata Financiare" është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 625,621 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së i ndryshuar, nga data 14.04.2026 deri në datë 29.05.2026, në subjektin Bashkia Kolonjë për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 u krye auditimi *"Mbi auditimin Financiar"*, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. L Gj, Përgjegjës grupi,
2. J G, auditues;
3. A V, auditues;

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.
Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.
Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një punë audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.
Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo*

kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi", duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.
Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kolonjë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Kolonjë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.
Kryetari i Bashkisë Kolonjë ***(****Administratori i Përgjithshëm)*, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Kolonjë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetë qeverisjen vendore*", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.
NA i njësisë së vetë qeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.
Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.
Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.[2]
Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

[2] Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 15

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Kolonjë me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia, vlerësimi, periudha, klasifikimi, kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Kolonjë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:* Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm publik*"; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetë qeverisjen vendore*", i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetë qeverisjes Vendore*"; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*"; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*"; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*".
- *Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:* Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 "*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*"; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "*Për pagesat e vonuara në*

detyrimet kontraktore e tregtare" i ndryshuar; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" etj. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "*Për përgatitjen e buxhetit vendor*"; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetë qeverisjes vendore*".

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*"; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 "*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*", Udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 "*Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetë qeverisjes vendore*" .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar*"; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "*Për sistemin e taksave lokale*", i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*", me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave* " i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, "*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*", i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë*", i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, "*Për pagat e vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*"; ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*"; INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*"; ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*"; INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*" etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës

Evropianë të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "*Dokumentimi i Auditimit*", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 4 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikimi. Gjatë hartimit të raportit përfundimtar te auditimit nga ana e Bashkisë Kolonje nuk janë paraqitur observacione ne lidhje me projekt raportin e auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Kolonjë u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi dhe menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, menaxhimin, inventarizimin dhe hipotekimin e pronave/aseteve.
Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.
Zona Gjeografike: Bashkia Kolonjë kufizohet në veri me Bashkinë Korçë dhe Bashkinë Devoll , në lindje me shtetin e Greqisë në perëndim dhe jug me Bashkinë Përmet. Krye qendra e Bashkisë është qyteti i Ersekës.
Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2023, Bashkia Kolonjë numëron 7,519 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 19,919 banorë. Bashkia e Kolonjës ka një sipërfaqe prej 864.06 km^2.
Historik i zhvillimit ekonomik: Në kuadër të nxitjes së turizmit, qyteti i Kolonjës ka përfituar grante të kushtëzuara për përmirësimin e infrastrukturës së qytetit. Nga këto investime nga buxheti i shtetit është rehabilituar sheshi kryesor i qytetit të Ersekës, rruga e cila lidh qytetin e Ersekës më fshatin e Rehovës. Një prej investimeve më të rëndësishme e cila gjatë viteve të fundit ka nxitur edhe turizmin në zonë është rehabilitimi i segmentit Ersekë-Leskovik. Gjatë vitit 2025 është përfunduar investimi strategjik më i madh për të gjithë zonën rruga Korçë-Ersekë.
Megjithëse janë kryer investime të mëdha në infrastrukturë kjo zonë vazhdon të karakterizohet nga de popullim i shpejtë.
Zonat e Kolonjës në fushën e biznesit janë të fokusuara në blegtori, në pemëtari dhe në mbledhjen e bimëve medicinale.
Sfidat me të cilat përballet: Bashkia përballet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbanë dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe

shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit historik dhe kulturor përmes lehtësimin e procedurave dhe politikave fiskale të banorëve për vetëpunësim në këtë fushë, ruajtjen e banesave muzeale nga erozioni dhe zjarret, por dhe ndalimi i ndërtimeve pa leje në qendrën historike; Krijimi i mundësisë së integrimit të formave alternative të turizmit në zonat përreth qytetit, si eko turizmi dhe turizmi i aventurës; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.

Rëndësia e këtij auditimi është të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. "**Mbi identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK"**, të programit të auditimit, u audituа dokumentacioni si më poshtë:

Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për periudhën e aktivitetit viti 2025.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga Bashkia Kolonjë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

<u>Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik</u>

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem i rëndësishëm politikash i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga stafi i Bashkisë Kolonjë, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se:

I. Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Mjedisi i kontrollit i jep tonin njësisë, duke influencuar vetëdijen kontrolluese të njerëzve të saj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Menaxhimi ka rolin kyç në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike;

Parimi 2 - Titullari/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje;

Parimi 3 - Titullari/ Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë;

Parimi 4 - Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave;

Parimi 5 - Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se "*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje"*. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Kolonjë në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

- Bashkia Kolonjë ka miratuar Kodin e Etikës me shkresën nr. 2747.Prot., datë 02.06.2022. Gjithashtu Bashkia Kolonjë në vitin 2022 ka miratuar me VKB nr.47, datë 17.05.2022 Kodin e Sjelljes.

Për zbatimin e tij bashkia mbështetet në Ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 *"Për rregullat e etikës në administratën publike",* ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike",* i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik.
- Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se Bashkia Kolonjë vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me VKB nr.157, datë 20.12.2023, Konfirmimi i Rregullores është bërë nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.1091/1, datë 08.01.2024.
Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për strukturat e institucionit.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore rezulton se struktura e Bashkisë Kolonjë, për vitin 2025, është miratuar me VKB nr. 136, datë 23.12.2024 *"Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Kolonjë dhe nivelit të pagës për punonjësit e bashkisë dhe ndërmarrjeve të varësisë si dhe nivelin e pagave për vitin 2025"*, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 41/1, datë 10.01.2025, dhe miratuar nga Titullari me Urdhër nr. 17, datë 17.01.2025.
Pozicionet e punës sipas strukturës aktuale janë përkatësisht:
-10 pozicione punë me statusin i zgjedhur dhe funksionarë kabineti;
-67 pozicione punë me status të nëpunësit civil; nga të cilët 44 janë me status të nëpunësit civil.
-223 pozicione punë janë punonjës administrativë dhe rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar.
-Me Urdhër nr. 681, datë 23.12.2024, *"Për miratimin e planit për trajnimin e brendshëm të punonjësve për vitin 2025"* është miratuar plani për trajnimin e stafit të bashkisë për vitin 2025.
-Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Kolonjë në përputhje me ligjin nr. 60/2016 *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit"* e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me Urdhër nr. 01, datë 10.01.2022 *"Për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e Konfidencialitetit në Institucionin e Bashkisë"* .
Gjatë vitit 2025 janë dhënë 2 masa disiplinore për punonjësit me status nëpunës civil si më poshtë vijon.
1. Znj. D. M, masë disiplinore "Vërejtje", me Vendimin e Eprorit direkt nr. 42, datë 27.10.2025, *"për shkelje të rregullave të etikës në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", neni 57, pika 4, germa b) dhe c)"*
2. Znj. E. J, masë disiplinore "Vërejtje", me Vendimin e Eprorit direkt nr. 41, datë 23.10.2025, *"për shkelje të rregullave të etikës në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", neni 57, pika 4, germa b) dhe c)"*

- Për rastet e raportimit lidhur me ankesat për korrupsion, nuk është ngritur një sektor për çështje të anti korrupsionit, veprime jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike", i ndryshuar.*
- Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.
Procesi i vlerësimit për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil, është kryer sipas formularit tip një herë në 6 muaj (ose dy herë në vit).
Parimi 2 - Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil punë të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstron dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* të ndryshuar, përcaktohet se *"Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*". Për sa më sipër rezulton se Bashkia Kolonjë nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

-Për vitin 2025, situata paraqitet pjesërisht efektive dhe ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion. Evidentohet se ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

Titullari i Bashkisë mbikëqyr projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Rezultojnë Raporte nga Njësia e Auditimit të Brendshëm lidhur me monitorimin e kontrollit të brendshëm të institucionit të cilat janë të miratuara nga titullari.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se "*GMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike"*. Për sa më sipër, për vitin 2025, rezulton të jenë kryer dhe dokumentuar mbledhjet e kryera nga GMS si më poshtë vijon;

- GMS për Bashkinë Kolonjë është ngritur me Urdhrin e Titullarit nr. 02, datë 06.01.2025 , me shkresën nr. 18.Prot., datë 06.01.2025.

Mbledhjet e GMS-së janë të protokolluara në fletoren e protokollit të mbledhjeve të GMS viti 2025 si më poshtë vijon

Mbledhja nr. 1, datë 06.01.2025 "Për diskutimin mbi hartimin e planit të punës për vitin 2025, hartimin e regjistrave të riskut, rishikimi i rregulloreve të drejtorive, hartimin e hartave të proceseve, manualit të proceseve ,vlerësimet e punës ,etj.";

Mbledhja nr. 2 datë 16.01.2025 " Për miratimin e vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave 2026-2028."

Mbledhja nr. 3, datë 19.02.2025 "Mbi treguesit e monitorimit për vitin 2024,diskutim mbi deklaratën e sistemit dhe plotësimin brenda afateve të pyetësorit të vetëvlerësimit";

Mbledhja nr. 4, datë 07.03.2025 " Për diskutimin dhe miratimin e tavaneve buxhetore faza e pare për PBA 2026 - 2028 si dhe njohja dhe planin e veprimit të MFK-së";
Mbledhja nr. 5, datë 28.04.2025 "Për miratimin e kërkesave buxhetore të EMP-ve";
Mbledhja nr. 6, datë 26.05.2025 "Për miratimin e treguesve të monitorimit për Janar-prill 2025",
Mbledhja nr. 7, datë 13.07.2025, Për miratimin e tavaneve përfundimtare të vitit 2026-2028";
Mbledhja nr. 8, datë 15.09.2025 "Për miratimin e treguesve të monitorimit Janar-Gusht 2025";
Mbledhja nr. 9, datë 03.10.2025 " Analizimi i dëgjesave publike për tu reflektuar në buxhetin 2026-2028";
Mbledhja nr.10, datë 10.11.2025, "Për hartimin e tavaneve përfundimtare dhe miratimin e tyre pas dërgimit të transfertave nga Ministria e Financave";
Mbledhja nr. 11, datë 02.12.2025 " Mbi miratimin e buxhetit përfundimtar 2026. dhe PBA 2026-2028";
Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, përcaktohet se "Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës".
- Me urdhrin nr. 03, date 06.01.2025, me nr. 19.prot, datë 06.01.2025 "Për ngritjen e grupit për menaxhimin dhe koordinimin e riskut në Bashkinë Kolonjë", i ndryshuar me urdhrin nr. 128, datë 27.03.2025.
Mungon plani i menaxhimit të risqeve të nivelit të lartë e të mesëm për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqën mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Parimi 3 *- Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.*
Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organi gramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit/Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.
- Bashkia Kolonjë vepron në bazë të Rregullores së Brendshme të miratuar me VKB nr.157, datë 20.12.2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.1091/1, datë 08.01.2024.
Rregullorja e brendshme e Bashkisë Kolonjë është publikuar dhe pasqyron veprimtarinë e institucionit, përfshirë të gjitha autoritetet, përgjegjësitë menaxheriale dhe operacionale, linjat e raportimit sipas strukturës organizative si dhe bazën ligjore për të gjithë veprimtarinë e bashkisë.
- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore rezulton se struktura e Bashkisë Kolonjë, për vitin 2025, është miratuar me VKB nr. 136, datë 23.12.2024 "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë kolonjë dhe nivelit të pagës për punonjësit e bashkisë dhe ndërmarrjeve të varësisë si dhe nivelin e pagave për vitin 2025", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 41/1, datë 10.01.2025 dhe miratuar nga Titullari me Urdhër nr. 17, datë 17.01.2025, strukturë e përbërë (plan) nga 300 punonjës.
Në tabelën e mëposhtme po paraqesim strukturën e Bashkisë Kolonjë Plan/Fakt sipas statusit të punonjësve;

Tabela 2/1.Struktura Plan Bashkisë Kolonjë për vitin 2025

	Plan	Fakt		Plan	Fakt
Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	300	256	Nëpunës Civilë	67	44
			Nëpunës me kontratë	223	203
			Të zgjedhur	10	9

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sikurse shihet edhe nga të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit ka 44 pozicione punë Vakante apo të paplotësuara me staf, fenomen që ul performancën e Bashkisë Kolonjë si dhe mund të ndikojë në realizimin e objektivave të kësaj Bashkie.

- Nga auditimi konstatohet se nuk është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore të bëra ndër vite.
- Rezulton se delegohen përgjegjësitë brenda bashkisë nga ana e menaxherëve nëpërmjet urdhrave të delegimit;

Bashkia Kolonjë, ka hartuar përshkrimet e pozicioneve të punës, dhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre është bërë në përputhje me nenin 24, të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*" në të cilin përcaktohet se "Procesi i vlerësimit të punës ndjek këto faza: a) krijimi i komitetit të vlerësimit; b) identifikimi i pozicionit/ pozicioneve të punës që do të vlerësohen; c) vlerësimi me faktorë dhe pikëzimi sipas metodologjisë së vlerësimit të pozicionit të punës; ç) klasifikimi i pozicionit të punës në kategorinë, klasën dhe grupin përkatës". Gjithashtu, këto përshkrime punë nuk janë miratuar nga DAP, sikurse përcaktohet në nenin 35 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 "Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës shtetërore: a) miraton propozimin për klasifikim të pozicionit/pozicioneve të punës; b) kthen për rivlerësim pozicionin/pozicionet e punës dhe vendos një afat të arsyeshëm për plotësimin e rivlerësimit".

- Sekretari Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore kanë kryer vlerësimet 6-mujore dhe vjetore të punonjësve me status të nëpunësit civil.

Parimi 4 - Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave.

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

- *Përshkrimet e punës nuk janë rishikuar periodikisht edhe pse bashkia ka ndryshuar strukturën e saj.*
- Nga auditimi i dosjeve të personelit rezulton se këto janë në përputhje me përcaktimet ligjore të specifikuar në VKM nr. 833, datë 28.10.2020, "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"*
- Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Burimeve Njerëzore mbi rekrutimet dhe largimet, rezultoi se përgjatë vitit 2025 janë rekrutuar 39 punonjës të rinj dhe janë larguar 34 punonjës.
- Për sa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, gjatë vitit vitin 2025, bashkia ka hartuar një plan vjetor të trajnimeve për të gjithë punonjësit pjesë e Shërbimit Civil dhe i është drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) të cilët

bëjnë vlerësimin e nevojave për trajnim, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Me Urdhër nr. 681, datë 23.12.2024, *"Për miratimin e planit për trajnimin e brendshëm të punonjësve për vitin 2025"* është miratuar plani për trajnimin e stafit të bashkisë për vitin 2025.
-Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të *ligjit 114/2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit".*

Parimi 5 *- Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale*
Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.
-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se bashkia nuk i ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale për hartimin dhe monitorimin e objektivave strategjikë në dokumentin e rregullores së brendshme.
- Gjithashtu, evidentohet se Bashkia Kolonjë, nuk ka hartuar planë vjetore punë për të gjitha drejtoritë.
Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.
Për vitin 2025, është hartuar shkresa me nr.18.prot., datë 06.01.2025 me Urdhrin nr. 2, datë 06.01.2025 *"Për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe caktimin e koordinatorit të GMS për vitin 2025"*
- Gjithashtu për vitin 2025, është hartuar shkresa me nr.19.prot, datë 06.01.2025 me Urdhrin nr. 3, datë 06.01.2025 *"Për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe caktimin e koordinatorit të GMS për vitin 2025"*
- Për vitin 2025, është hartuar shkresa me nr. 18.prot, datë 06.01.2025 me Urdhrin nr. 2, datë 06.01.2025 "Për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit të Riskut dhe caktimin e koordinatorit të Riskut për vitin 2025"
Gjatë vitit 2025 është mbajtur 11 mbledhje e GMS.
GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.
Për vitin 2025, është përgatitur *"Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Kolonjë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm"* me shkresën nr. 1469.prot., datë 27.02.2025, dhe dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE me shkresën nr. Nr. 1470.prot., datë 27.02.2026.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 20.
- VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Kreu II. "Dosja e Personelit";

- *"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.1, Kapitulli IV "Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit", Kapitulli V, Anekset.*

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqën gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 6 - Specifikimi i objektivave të përshtatshëm.
Parimi 7 - Identifikimi dhe analiza e risqeve.
Parimi 8 - Mundësia e riskut të mashtrimeve.
Parimi 9 - Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme.

Parimi 6 - Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.
Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.
Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.
Nga analiza e të dhënave, duke marrë në konsideratë se Bashkia Kolonjë duhet të specifikoj dokumentet e planifikimit, njësia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin.

Parimi 7. Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.
- Me shkresën nr. 4622.prot., datë 07.10.2024, *"Për miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut për bashkinë Kolonjë për periudhën 2025-2027"*, vendimi nr. 34, datë 07.10.2024, është miratuar strategjia e Menaxhimit të Riskut për Bashkinë Kolonjë, 2025-2027.
- Është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Kolonjë por ka mangësi në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre.

Parimi 8 - Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.
Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.
- Nga auditimi evidentohet se Bashkia Kolonjë nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme
Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqët dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.
- Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel jo të mirë sa i takon plotësimit të strukturës me auditues.
- Bashkia Kolonjë nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c ,ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 21, pika 2;
-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3 "Përgjegjësitë dhe detyrat e KR", pika 3.2.1 "Titullari i njësisë publike" pika 4 "Hapat për ngritjen e sistemit të MR"
-"Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

III. Komponenti: Aktivitetet e Kontrollit
Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqëve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 10 - Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.
Parimi 11 - Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.
Parimi 12 - Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në Bashkinë Kolonjë, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsive dhe nxjerrjen e përgjegjësive.
Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e

kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.
Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.
- Bashkia Kolonjë ka hartuar dhe miratuar hartën e proceseve të punës.
- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.
- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Kolonjë.
- Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktuale të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponilibiteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.
- Bashkia Kolonjë ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.
- Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Nuk ka asnjë procedurë të miratuar nga titullari dhe gjurmë auditi për inventarizimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" i ndryshuar.

Gjurma e auditimit
Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.
Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë. Titullarët e

njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.
Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* të ndryshuar përcaktohet se *"Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi".* Për sa më sipër, rezulton se *Titullari i Bashkisë Kolonjë për vitin 2025 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.*
- Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.
Gjurma e auditimit duhet të ndërtohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.
Në Drejtorinë e Financës janë përcaktuar dhe ndarë detyrat për çdo specialist, dhe miratohen konform ligjit nga përgjegjësi i sektorit dhe n/zbatues në vijim nga nëpunësi autorizues.
Specialisti i buxhetit kryen gjithë procedurën për regjistrimin e çeljeve të fondeve dhe pakësimit të tyre në Microsoft Access.
Specialisti i kontabilitetit kryen gjithë regjistrimet e aktiveve në sistemin Excel;, shtesat pakësimet, amortizimet, etj., janë të regjistruara në këtë sistem.
Specialisti i pagave mban liste pagesat për çdo sektor kontabilizimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP, harton dhe nënshkruan gjithë urdhërpagesat që kryhen nga ky sektor. Në vijim çdo dokument kontrollohet dhe miratohet pastaj regjistrohet në sistem konform Udhëzimit të MF Nr. 24, datë 29.08.2019 "*Për Përdorimin e Arshivës Elektronike në Procesin e ekzekutimit të Buxhetit të Shtetit nga Njësitë e qeverisjes së Përgjithshme''*, të ndryshuar.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë
Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.
- Bashkia Kolonjë ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra sisteme qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS).
- Nga auditimi rezulton se bashkia nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it. Bashkia Kolonjë për vitin 2025 ka vendosur procedura për të siguruar vazhdimësinë e veprimeve kundrejt risqeve kryesore që mund të pengojnë këtë veprimtari. Pra, ka planë të vlerësimit të riskut për Bashkinë Kolonjë, për sigurinë e aktiveve nga zjarri/përmbytjet dhe rimëkëmbjet nga fatkeqësitë miratuar nga titullari i institucionit me nr. 874/1.prot, datë 26.09.2024.

Parimi 12 - Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.
Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrolle dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listë pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Financës.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

- Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7 "Monitorimi dhe Raportimi";

-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

IV Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"

Komponenti i katërt i kontrollit të brendshëm ka të bëjë me çështjet e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është Gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 13 - Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor.

Parimi 14 - Komunikimi i brendshëm

Parimi 15 - Komunikimi i jashtëm

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Kolonjë ka një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen web Bashkia Kolonjë ka programin e transparencës, në zbatim me *ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku në nenin 4 përcaktohet se 'Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga 19 hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim të një program institucional të transparencës*, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni". Gjithashtu, Bashkia Kolonjë ka edhe regjistrin me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në zbatim me këtë ligj ku në nenin 8 përcaktohet se "Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.

Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër".

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
- Në vijim të auditimit, rezulton se bashkia i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. Bashkia ka një sistem komunikimi si brenda dhe jashtë institucionit dhe ky sistem jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
- Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.
- Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.
-Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, në përputhje me udhëzimet dhe ligjin e kontabilitetit të pasqyrave financiare.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm
Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
- Për sa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalet e mbledhjeve komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.
- Faqja zyrtare e institucionit përditësohet rregullisht dhe punonjësit kanë e-mail zyrtar.
- Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.
- Bashkia Kolonjë siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.
- Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
Për vitin 2025 janë zhvilluar 12 dëgjesa publike në Bashkinë Kolonjë. Dëgjesa Publike janë zhvilluar në lidhje me konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, miratimin e Buxhetit të Bashkisë Kolonjë, Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, Miratimi i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kolonjë për vitin 2025 për vitin 2025 dhe Plani i Përmirësimit të Arsimit Para shkollor, etj.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 23, "Informacioni dhe Komunikimi" pika 2;
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

V. Komponenti: "Monitorimi"

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 16 - Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta
Parimi 17 - Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herë pas hershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

- Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucion nuk ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

-Bashkia Kolonjë monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE.

Për vitin 2025, është përgatitur "Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Kolonjë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm" me shkresën nr. 1469.prot., datë 27.02.2025, dhe dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE me shkresën nr. Nr. 1470.prot., datë 27.02.2026.

Për vitin 2025 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Kolonjë ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në zbatim me nenin 18, të ligjit për MFK-në. Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Bashkia Kolonjë nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

- Me Urdhër nr. 681, datë 23.12.2024, *"Për miratimin e planit për trajnimin e brendshëm të punonjësve për vitin 2025"* është miratuar plani për trajnimin e stafit të bashkisë për vitin 2025.

-NJAB ka hartuar Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2025.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

- Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por ecuria e zbatimit të tyre është e ngadaltë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 24, "Monitorimi" pika 1;
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

Sa më sipër, arrihet në konkluzion se:
Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:
Komponenti *"Mjedisi i kontrollit"*
- Nga auditimi konstatohet se nuk është rishikuar Rregullorja e Brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara;
- Ka procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj.
- Titullari i bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë.
- Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor;

Komponenti *"Menaxhimi i Riskut"*
- Për vitin 2025 është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku janë të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Kolonjë si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre;

Komponenti: *"Aktivitetet e Kontrollit"*
- Bashkia Kolonjë nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës;
-Mungojnë manualet e proceseve të punë gjë që mund të sjellë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive;
- Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset e punës.

Komponenti: *"Informimi dhe komunikimi"*
-Faqja zyrtare e institucionit përditësohet rregullisht dhe punonjësit kanë e-mail zyrtar.
-Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.

Komponenti: *"Monitorimi"*
-Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Bashkia Kolonjë nuk ka

hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.
-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se
-Nuk është plotësuar struktura për 44 vende punë.
-Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar planë vjetore punë për të gjitha drejtoritë.
Mungojnë manualet e proceseve të punës çka mund të sjellë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive.
Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.

Këto veprime janë në mos përputhje me përcaktimet ligjore të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"*; Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*; Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi
Z. P. R, Nënkryetar i Bashkisë Kolonjë
Znj. D. T, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

2.1.2 Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm;

Në zbatim të pikës 1.2. të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:
- Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Kolonjë;
- Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
- Programimi i auditimeve për vitin 2025;
- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
- Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
- Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.
- Vlerësimi i auditimeve.
Auditimi u krye referuar akteve ligjore e nënligjore si më poshtë:
- Ligji Nr.114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar;
- Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 "*Për Arkivat*";
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*";

- Manuali i "*Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*" miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016;
-VKM nr.160, datë 02.03.2016 "*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike*" i ndryshuar;
-Udhëzimi Nr.42, datë 27.10.2020 "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik*";
-Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë *"Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016";*
-Normat tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:
-Organizimi dhe funksionimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm/Komitetit të Auditimit, niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme, bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, niveli i raportimit në këtë drejtori,
-Realizimi i treguesve të planifikuar nga NJAB,
-Sigurimi i cilësisë së auditimit, me qëllim vlerësimin nëse veprimtaria e auditit të brendshëm është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e auditimit, konkretisht Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",* "*Manualin e Auditimit të Brendshëm*", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar.

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkisë Kolonjë, rezultoi se:
- Organizimi dhe Funksionimi: Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, *"Për miratimin e kritereve për ngritjen e NJAB në sektorin publik"* Bashkia Kolonjë ka ngritur NJAB.
Sipas strukturës organizative të Bashkisë Kolonjë për vitin 2025, të miratuar me VKB nr. 136, datë 23.12.2024 *"Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Kolonjë dhe nivelit të pagës për punonjësit e bashkisë dhe ndërmarrjeve të varësisë si dhe nivelin e pagave për vitin 2025",* konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 41/1, datë 10.01.2025, dhe miratuar nga Titullari me Urdhër nr. 17, datë 17.01.2025 sektori i njësisë së Auditimit të Brendshëm është parashikuar me tre punonjës, nga të cilët një përgjegjës dhe dy specialiste.
Për vitin 2025 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 2 (auditues), një përgjegjës dhe një specialist.
Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Kolonjë **2024** *"Për Miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Bashkisë Kolonjë"* përcaktuar me Rregulloren e Brendshme për "Njësinë e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kolonjë, e miratuar me nr. 2520, datë 23.05.2024, ndryshuar me nr. 815, datë 03,02,2026 *"Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e NJAB-së" (mbi bazën e kërkesave të MFK-së dhe Manualit të Ri të Auditimit)* mbi bazën e të cilës funksionojnë struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe të gjitha Struktura e NJAB, niveli i arsimit, certifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës si më poshtë:

Struktura e NJAB, niveli i arsimit, certifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Tabela 2/2: Struktura e NJAB, niveli i arsimit, certifikimi

Nr.	Periudha 2025	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	**L S**	Përgjegjëse	I lartë Master Shkencor	3	2	JO	PO
2	**A F**	Audituese	I lartë Master Shkencor	2	1	JO	PO

Burimi: Bashkia Kolonjë

Konkluzion:
Konstatohet se Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm nuk ka plotësuar vjetërsinë e punës prej 3 vjet në fushën e auditimit, veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar, neni nr. 11, *"Punësimi i audituesit të brendshëm",* pika 2*, "Përveç kushteve të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit që punësohen në njësinë e auditimit të brendshëm, kërkohet plotësimi i kushteve të posaçme si më poshtë:*
drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të ketë përvojë punë 5 vjet në profesion, nga të cilat jo më pak se 3 vjet në fushën e auditimit, dhe të jetë i certifikuar si "Audites i brendshëm në sektorin publik"

Konkluzion:
Për vitin 2025 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 2(dy) auditues, veprime këto jo në përputhje me VKM nr.83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"* pika 3 e cila përcakton se*: "Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(3) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si audites të brendshëm në sektorin publik"*

- Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Kolonjë.
Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e organit që bashkërendon, harmonizon dhe monitoron veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, me shkresën nr.13893.,prot, datë 22.07.2019 *"Mbi krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm,* ka ofruar asistencë në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kukës nëpërmjet propozimit të disa hapave konkrete.
Referuar ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* neni 12, pika b, përcakton se *Titullari i Njësisë Publike është përgjegjës për vendimmarrjen e krijimit të Komitetit të Auditimit.*
Nga auditimi rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 13 "Komitetit të Auditimit të Brendshëm" *i cili përcakton se: "Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*
a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
d) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;
dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.
3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 13 të ligjit 114/2015 *"Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik".*

- Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik
NJAB në mbështetje të Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*" ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" në Bashkinë Kolonjë e cila është miratuar nga titullari me urdhrin nr. 517, datë 26.09.2024.

- Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm.
NJAB në mbështetje të Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"* ka hartuar *"Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm"* në Bashkinë Kolonjë, e cila është miratuar nga titullari me urdhrin nr. 516, datë 26.09.2024.

- Regjistri i riskut të NJAB
Për vitin 2025 nuk është hartuar dhe as miratuar regjistër risku për Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

- Planet Strategjike dhe Vjetore:
Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:
Për vitin 2025 me vendim nr. 36, datë 16.10.2024 është miratuar Plani Strategjik për vitet 2025-2027 dhe Plani Vjetor i auditimeve për vitin 2025.
Plani Vjetor 2025 dhe Plani Strategjik për vitet 2025 - 2027 është dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 4800.prot, datë 16.10.2024 në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*".
Është bërë ndryshim i planit strategjik gjatë vitit 2025 me Vendim nr. 40, datë 17.10.2025, për *"Ndryshim të Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kolonjë viti 2025 – 2027"* e cila është miratuar nga titullari i bashkisë dhe me shkresën nr. 5745.prot, datë 17.10.2025 është dërguar zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
Njësia e AB në Bashkinë Kolonjë mbulon me auditim 19 subjekte: ku 16 subjekte janë drejtori, sektorë e inspektorate të tjera në juridiksionin e Bashkisë Kolonjë, si IMVT, MNZSH, Mbrojtja Civile si edhe 3 subjekte Njësi Administrative në juridiksionin e Bashkisë Kolonjë si: NJA Mollas-Çlirim, NJA Leskovik- qendër Leskovik dhe NJA qendër-Ersekë.
Nisur nga sa më sipër është bërë kërkesa për ndryshim të Planit Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2025-2027, sipas shkresës nr. 5681.prot., datë 15.10.2025 si dhe Vendim nr. 40, datë 17.10.2025 "Për ndryshim të Planit Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kolonjë viti 2025-2027", e cila është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF.

Plani strategjik 2025-2027 i përgatitur nga NJAB e Bashkisë Kolonjë pasqyrohet ne Aneksin 1/1 bashkëngjitur raportit te auditimit

Konstatim:
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se veprimtaria e disa sektorëve me një risk të lartë, si sistemi i pagave dhe sidomos ai i prokurimeve, nuk janë vendosur në hartimin e Planit Strategjik me një frekuencë të lartë për kryerjen e auditimeve për sektorët përkatës, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Auditit të Brendshëm, Kapitulli III, *"Planifikimi i veprimtarive të Auditit të brendshëm", pika "Hartimi i planit strategjik të auditimit të brendshëm"*

- **Realizimi i Planeve Vjetore:**

Sipas rishikimit të planit**,** janë realizuar gjithsej 6 misione auditimi në 6 subjekte auditimi, sipas planifikimit.

Tabela 2/3:Realizimi e auditimeve viti 2025

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputhshmëri	Financë	Kombinuar	Performancë	Zb.Rek
1	Viti 2025	7	6			5		1

Burimi: Bashkia Kolonjë

Raportimi: Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Kolonjë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr. 1103.prot., datë 13.02.2026, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kolonjë për vitin 2025. Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten ne Aneksin 1/2:

- **Gjetje - Rekomandimet**

Për vitin 2025, Nga auditimet janë evidentuar 144 gjetje, për të cilat janë dhënë 144 rekomandime, nga të cilat 53 rekomandime për përmirësimin e sistemit, 10 rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, 0 janë rekomandime të karakterit organizativ, 5 rekomandime për arkëtime, dhe 76 rekomandime të tjera, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2/5:Gjetje - Rekomandimet nga A.B

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
4	Viti 2025	144	38	37	69	0	0	0	0
TOTALI		**144**	**38**	**37**	**69**				

Burimi: Bashkia Kolonjë

Për vitin 2024, Nga auditimet në 4 Njësitë Administrative dhe një angazhim këshillimi për implementimin e strukturës së re, janë evidentuar 53 gjetje, për të cilat janë dhënë 53 rekomandime, nga të cilat 49 rekomandime për përmirësimin e sistemit, 2 janë rekomandime të karakterit organizativ dhe 2 rekomandime të tjera, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2/6: Rekomandimet nga A.B 2024, ndjekja gjatë 2025

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
4	Viti 2024	53	8	7	38	0	0	0	0
TOTALI		**53**	**8**	**7**	**38**	**0**	**0**	**0**	**0**

Burimi: Bashkia Kolonjë

Grupi i auditimit ka analizuar ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm me Raportimin Vjetor të Nivelit të Zbatimit të Rekomandimeve me nr. 2304.prot, datë 10.04.2026 i cili është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në MF me shkresën përcjellëse me nr. 2305.prot., datë 10.04.2026, kjo për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.
Nga auditimi i detajuar i dosjeve të auditimeve të kryera në subjektet:
Për vitin 2025 dosjet:

1. Ndjekja e rekomandimeve të lëna gjatë 2024.
2. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
3. Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit;
4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore;
5. Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave;
6. Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Dosjet e procedurave të auditimit, procedura e ndjekur gjatë proceseve të auditimit si dhe afatet, kanë qene përgjithësisht në përputhje me përcaktimet e Manualit për Auditimin e Brendshëm.

Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit rezulton se;
-Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2025, është miratuar me nr. 7419.prot., datë 29.12.2025 dhe është dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MF.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi
Znj. L. S, Përgjegjëse në Sektorin e Auditit të Brendshëm, Bashkia Kolonjë,
Z. A. F, specialist në Sektorin e Auditit të Brendshëm, Bashkia Kolonjë.

2.2.1Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit
2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2025;
2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;
2.2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuar progresive dhe për vitin buxhetor.
Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;

- Situacioni i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit';
- PBA dhe buxheti vjetor;
- Raportet e monitorimit;
- Vendimet e Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë";
- Vendime të tjera të Këshillit Bashkiak, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Dokumente të bankës etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

2.2.1. **Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2025;**
2.2.2. **Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.**
2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mall e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.
Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetë qeverisjes vendore. Për vitin 2025 janë hartuar kërkesat shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj. për nevojat reale e mbi bazën e të cilave ndërtohet dhe buxheti faktit nga ky institucion, duke përzgjedhur ato më prioritare.
Për vitin 2025 buxheti bazë fillestar vjetor (*në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor*), është miratuar me VKB nr. 140, datë 23.12.2024, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë me shkresën nr.41 datë 10.01.2025.
Buxheti vjetor është miratuar brenda afateve që përcakton neni 41 i ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetë qeverisjes vendore*" (*Brenda datës 25 dhjetor*).
Në këtë VKB të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2025 kanë vlerën 102,982,057 lekë, transfertat e pakushtëzuar + rritja e nivelit të pagave ka vlerën 199,451,830.09 lekë, transfertat specifike ka vlerën 153,495,112 lekë. Të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm 0,000 lekë
Në total të ardhurat kanë vlerën 455,928,999.09 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 455,928,999.09 lekë. Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2025 paraqiten në Aneksin nr.2/1 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të cituar më sipër si dhe të dhënave të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit nëpërmjet pyetësorëve u konstatua se midis fazës së dytë të PBA dhe projekt buxhetit për vitin 2025 ka një diferencë në vlerën 54,799 mijë lekë. Ndryshimi midis fazës së dytë të PBA dhe projekt buxhetit për vitin 2025 në vlerën 54,799 mijë lekë ka ardhur si rezultat i rritjes së parashikimit të të ardhurave të veta në vlerën 18,327 mijë lekë miratuar me VKB nr. 119. date 24.11.2024 dhe rritjes së trasnfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale në vlerën 36,472 nga Ministria e financave dhe Ekonomisë me shkresën e datës 29.10.2024 me nr.14488.prot , përditësuar me shkresën e datës 17.12.2024.

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit vënë në dispozicion të grupit të auditimit, konstatohet se planifikimi i buxhetit në këtë institucion është bërë duke ndjekur hapat si më poshtë:

Në zbatim të Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë *"Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetë qeverisjes Vendore",* i ndryshuar, GMS i ngritur me urdhër të titullarit nr. 3, dt. 05.01.2024 ka kryer parashikimin afatmesëm të të ardhurave të cilat janë miratuar me VKB nr. 7, dt. 24.01.2024.
Duke u bazuar në udhëzimin nr.03, datë 28.02.2024 të Ministrisë së Financave "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027",* GMS ka analizuar dhe përcaktuar *"Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027"* të cilat janë miratuar me VKB nr. 30, datë 15.03.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.308/1prot, datë 03.04.2024.
Me urdhrat e titullarit 157, datë 19.03.2024 dhe nr. 1364.prot, datë 19.03.2024 *"Për hartimin dhe zbatim e udhëzimit për hartimin e kërkesave buxhetore të PBA-së ,2025-2027, në zbatim të VKB nr.30, datë 15.03.2024 "Për miratimin e tavaneve buxhetore",* janë ngritur Ekipet e manaxhimit të programeve buxhetore me drejtuesit e ekipeve përkatëse. Sa më sipër në të gjitha drejtoritë, sektorët apo njësitë e varësisë është dërguar urdhri për përgatitjen e kërkesave buxhetore të PBA-së 2025-2027 duke respektuar tavanet buxhetore për çdo program dhe afatet e dorëzimit të tyre.
Në vazhdim të udhëzimit të brendshëm GMS në mbledhjen e protokolluar me nr.6 të datës 20.05.2024 ka miratuar " Kërkesat buxhetore, kërkesat buxhetore shtesë, relacionin e programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 Faza e Parë", të hartuara sipas udhëzimit nr. 03, datë 28.02.2024 dhe sistemit të menaxhimit të buxhetit vendor.
Me VKB nr. 59, Këshilli Bashkiak ka miratuar kërkesat buxhetore, kërkesat buxhetore shtesë, relacionin e programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 Faza e Parë. Ky vendim u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.603/1.prot, datë 09.07.2024. Në vazhdim të procesit Ministria e Financave ka dërguar rekomandimet "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027" ndërsa me shkresën nr.8592, datë 19.06.2024, Ministria e Financave ka dërguar pranë këtij institucioni udhëzimin plotësues "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027".
GMS në mbledhjen e protokolluar me nr.7 datë 15.07.2024 ka miratuar *"Tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027"*. të cilat u miratuan me VKB nr. 70, datë 19.07.2024 dhe u konfirmuan nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.790/1, datë 30.07.2024.
Këshilli i Bashkisë së kësaj NJQV-je me vendimin nr. 87 datë 27.09.2024 ka miratuar *" Programin Buxhetor Afatmesëm të Rishikuar 2025-2027"*. Në vazhdim të procesit Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 14488.prot datë 29.10.2024 ka dërguar transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2025, përditësuar me shkresën 17266 date, 17.12.2024. GMS në mbledhjen e protokolluar me nr. 10, datë 13.11.2024 miratoi Projekt-dokumentin e Buxhetit Vjetor 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 Përfundimtar. Programi Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2025-2027 u miratua me VKB nr. 139, datë 23.12.2024 . Buxheti vjetor u miratua me VKB nr. 140 .datë 23.12.2024, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë me shkresën nr.41 datë 10.01.2025.
Gjatë vitit 2025, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2025). Këto ndryshime paraqiten si vijon:
- VKB nr. 24, datë 20.02.2025 "Për miratimin e buxhetit shtesë, nga fondet e trashëguara" me vlerë 30,441,299.72 lekë.
- VKB nr. 129 datë 29.10.2025 "*Për miratimin e* buxhetit shtesë për vitin 2025, në transfertën e pakushtëzuar sektoriale". Shtim fondi në vlerën 1,860,000 lekë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë me shkresën nr.1021/1prot datë 12.11.2025.Pasqyra përmbledhëse për

planifikimin e buxhetit për vitin 2025 në 000/lekë paraqiten në Aneksin nr.2/2 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit:

Nga auditimi i planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2025 u konstatua se buxheti total është miratuar në vlerën 488,230 mijë lekë, duke reflektuar një rritje krahasuar me buxhetin fillestar prej 455,929 mijë lekë, si pasojë e përfshirjes së të ardhurave të trashëguara dhe shtesave buxhetore të miratuara gjatë vitit. Në strukturën e të ardhurave evidentohet një peshë e konsiderueshme e transfertave nga buxheti i shtetit, në vlerën 382,068 mijë lekë, krahasuar me të ardhurat e veta në vlerën 106,162 mijë lekë, çka tregon një varësi të lartë nga financimi qendror. Në drejtim të shpenzimeve, pjesën më të madhe e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (264,930 mijë lekë në total), të ndjekura nga shpenzimet operative (101,041 mijë lekë), si dhe investimet kapitale (73,861 mijë lekë). Gjithashtu, fondi rezervë dhe transfertat për familjet dhe individët zënë një peshë relativisht të kufizuar në strukturën e përgjithshme. Në tërësi, planifikimi paraqitet i balancuar në aspektin formal ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, megjithatë përfshirja në masë të lartë e të ardhurave të trashëguara dhe rritja e ndjeshme e buxhetit gjatë vitit tregon mangësi në parashikimin fillestar buxhetor, si dhe nevojën për përmirësim të planifikimit afatmesëm dhe të qëndrueshmërisë financiare të institucionit. PBA 2025-2027 krahasuar me planin buxhetor 2025, paraqiten në Aneksin nr.2/3 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga krahasimit ndërmjet planit buxhetor për vitin 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 u konstatua se ndërmjet treguesve të planifikimit, të gjitha zërat kryesorë paraqiten me vlera identike dhe pa diferenca. Konkretisht, shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (300,524 mijë lekë), shpenzimet operative dhe transfertat (rreth 93,725 mijë lekë), si dhe investimet e financuara nga bashkia (rreth 61,680 mijë lekë) janë planifikuar në mënyrë të njëjtë si në planin vjetor ashtu edhe në PBA, duke reflektuar një koherencë të plotë ndërmjet planifikimit afatmesëm dhe atij vjetor. Gjithashtu, mungesa e shtesave nga pushteti qendror dhe e investimeve të tjera shtesë në këtë fazë konfirmon që plani buxhetor 2025 është ndërtuar mbi të njëjtat parashikime të miratuara në PBA. Përgjithësisht, kjo përputhje në tërësi evidenton një proces korrekt formal të harmonizimit të dokumenteve buxhetore, megjithatë mungesa e devijimeve mund të tregojë edhe një nivel të kufizuar rishikimi apo reflektimi të ndryshimeve të mundshme gjatë fazës së hartimit të buxhetit vjetor. Sa më sipër ndodh si rezultat i mungesës të një analizë më dinamike të nevojave dhe prioriteteve në procesin e planifikimit.

Nga auditimi mbi programet buxhetore lidhur me shpërndarjen e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve u konstatua se:

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli përgjithësisht është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.
- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, përgjithësisht është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore(janë përzgjedhur ato më prioritare në respektim të tavaneve, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*".
Buxhet fillestar miratuar me VKB nr. 140, datë 23.12.2024 me vlerë 455,928,999 lekë i cili përbëhet nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 199,451,830.09 lekë, nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale në vlerën 153,495,112 lekë dhe nga të ardhura tona në vlerën 102,982,057 lekë.
Buxheti nga fondet e trashëguara miratuar me VKB nr. 24, datë 20.02.2025 me vlerë 30,441,299.72 lekë i cili përbehet nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 18,579,317.68 lekë, nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale në vlerën 8,681,938 lekë dhe nga të ardhurat e veta në vlerën 3,180,044.04 lekë.
Shtesë buxheti miratuar me VKB nr. 129 datë 29.10.2025 me vlerë 1,860,000 lekë transfertë e pakushtëzuar sektoriale.
Rakordimet; Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionët e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Ndryshimet brenda shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nen artikuj;

Ndryshimet brenda shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj janë bërë me:
- VKB nr. 63 date 30.05.2025 "*Për rishpërndarjen e fondeve Buxhetore ndryshim të VKB nr. 83 datë 27.11.2024 lidhur me miratimin e nivelit të pagave të bashkisë institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2025*";
- VKB nr. 76 date 30.06.2025 "*Për rishpërndarjen e fondeve Buxhetore"*
- VKB nr. 97 date 29.08.2025 "*Për rishpërndarjen e fondeve Buxhetore*"
- VKB nr. 98 date 29.08.2025 "*Për disa ndryshime në vendimin nr.136 datë 23.12.2024 "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Kolonjë dhe ndërmarrjeve të varësisë si dhe nivelin e pagave për vitin 2025"*
- VKB nr. 121 date 29.10..2025 "*Për rishpërndarjen e fondeve Buxhetore"*
- VKB nr. 130 date 29.10.2025 " Për *shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore*"
Ndryshimet në buxhetin 2025 paraqiten në Aneksin nr.2/4 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga auditimi mbi programet buxhetore dhe shpërndarjen e fondeve sipas burimeve të financimit (transfertat të pakushtëzuara, transfertat të kushtëzuara dhe të ardhura nga burimet e veta) u konstatua se planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në përputhje me kërkesat e disiplinës buxhetore dhe kuadrin rregullator në fuqi. Buxheti fillestar i miratuar me VKB nr. 140, datë 23.12.2024 në vlerën 455,928,999 lekë është rritur gjatë vitit përmes përfshirjes së fondeve të trashëguara (30,441,299.72 lekë) dhe shtesave të

mëvonshme, duke reflektuar çelje të reja fondesh për funksione të deleguara dhe programe specifike. Gjithashtu, gjatë vitit janë kryer ndryshime buxhetore (shtesa dhe pakësime), të realizuara në përputhje me kompetencat ligjore përkatëse, ku lëvizjet brenda programeve janë miratuar me urdhër të titullarit, ndërsa ato ndërmjet programeve me vendime të Këshillit Bashkiak. Bazuar në informacionit vënë në dispozicion të grupit të Auditimit (pyetësorët) si dhe nga shqyrtimi i korrespondencave respektive konstatohet se përgjithësisht fondet janë ndjekur dhe raportuar në mënyrë periodike dhe të rakorduar me Degën e Thesarit dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duke siguruar pasqyrim korrekt të situacioneve financiare.

Konkluzion: Nga auditimi i procesit të programimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027, programimit të buxhetit vjetor 2025, çeljes së fondeve buxhetore dhe ndryshimeve të kryera gjatë vitit, u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndjekur procedurat formale të përcaktuara në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë *"Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"*, si dhe Udhëzimin nr. 03, datë 28.02.2024 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"*, duke ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik, Ekipet e Menaxhimit të programeve buxhetore, duke miratuar tavanet përgatitore e përfundimtare dhe duke zhvilluar fazat përkatëse të PBA-së. Megjithatë, nga krahasimi i Fazës së Dytë të PBA-së me Projekt-Buxhetin Vjetor 2025 rezulton një diferencë në vlerën 54,799 mijë lekë, pasi totali i shpenzimeve në Fazën II të PBA-së paraqitet në vlerën 401,130 mijë lekë, ndërsa në Projekt-Buxhetin 2025 paraqitet në vlerën 455,929 mijë lekë. Kjo diferencë lidhet me rritjen e të ardhurave të veta në vlerën 18,327 mijë lekë dhe rritjen e transfertës së pakushtëzuar dhe sektoriale në vlerën 36,472 mijë lekë, të komunikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë pas miratimit të Fazës së Dytë të PBA-së. Nga auditimi i strukturës së buxhetit rezulton se në Projekt-Buxhetin 2025 fondet për paga dhe sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 300,524 mijë lekë, kundrejt 238,423 mijë lekë të parashikuara në Fazën II të PBA-së, me një rritje prej 62,101 mijë lekë ose 26%, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime janë ulur nga 97,027 mijë lekë në 89,525 mijë lekë, ose me 7,502 mijë lekë. Këto ndryshime tregojnë se parashikimet fillestare të PBA-së nuk kanë reflektuar në mënyrë të plotë dhe realiste nevojat financiare të institucionit, veçanërisht për fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore.
Gjithashtu, gjatë vitit 2025 buxheti fillestar i miratuar me VKB nr. 140, datë 23.12.2024, në vlerën 455,928,999 lekë, është rritur me 32,301 mijë lekë, duke arritur në 488,230 mijë lekë, si rezultat i përfshirjes së fondeve të trashëguara në vlerën 30,441 mijë lekë dhe shtesës së transfertës së pakushtëzuar sektoriale në vlerën 1,860 mijë lekë, të miratuara respektivisht me VKB nr. 24, datë 20.02.2025 dhe VKB nr. 129, datë 29.10.2025. Nga kjo shumë shtesë, 18,579 mijë lekë përfaqësojnë transfertë të pakushtëzuar të trashëguar, 8,682 mijë lekë transfertë specifike të trashëguar dhe 3,180 mijë lekë të ardhura të veta të trashëguara.
Për pasojë, pesha e financimit nga transfertat e buxhetit të shtetit në buxhetin përfundimtar arrin në 382,068 mijë lekë, ose rreth 78.3% të totalit të burimeve financiare prej 488,230 mijë lekë, ndërsa të ardhurat e veta zënë vetëm 106,162 mijë lekë, ose rreth 21.7%**,** duke evidentuar një nivel të lartë varësie nga financimi qendror. Gjithashtu, nevoja për rritje të buxhetit me 32,301 mijë lekë gjatë vitit dhe diferenca prej 54,799 mijë lekë ndërmjet Fazës së Dytë të PBA-së dhe Projekt-Buxhetit vjetor tregojnë mangësi në realizmin dhe saktësinë e parashikimeve fillestare buxhetore, duke kufizuar funksionin e PBA-së si instrument planifikimi afatmesëm dhe duke reduktuar besueshmërinë e treguesve të përdorur në procesin e programimit financiar.
Kryetari i Bashkisë, Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe strukturat përgjegjëse për planifikimin financiar, nuk kanë marrë masa për përmirësimin e metodologjisë së parashikimit të të ardhurave

dhe shpenzimeve gjatë hartimit të PBA-së, me qëllim që treguesit e Fazës së Dytë dhe dokumentet përfundimtare buxhetore të reflektojnë në mënyrë sa më reale nevojat financiare të institucionit, duke minimizuar diferencat ndërmjet planifikimit afatmesëm dhe buxhetit vjetor dhe duke rritur besueshmërinë e procesit të planifikimit buxhetor. Situata e konstatuar vjen për shkak se: Parashikim i burimeve financiare dhe nevojave për shpenzime gjatë fazave të hartimit të PBA-së nuk është plotësisht realist, dhe i bazuar në analiza të plota si dhe si pasojë e mos reflektimit të plotë të nevojave për fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore në dokumentet fillestare të planifikimit. Bazuar në sa më sipër kjo situate ka sjellë: Diferenca prej 54,799 mijë lekë ndërmjet Fazës së Dytë të PBA-së dhe Projekt-Buxhetit, rritje të buxhetit(shtesa) gjatë vitit me 32,301 mijë lekë, dobësim i rolit të PBA-së si instrument planifikimi afatmesëm, si dhe varësi e lartë e buxhetit vendor nga transfertat e buxhetit të shtetit në masën 78.3% të totalit të burimeve financiare.

Veprime në mos përputhje me**:** Nenet 22, 32, 36 dhe 41 të ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetë qeverisjes Vendore*", i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 03, datë 28.02.2024 "*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027*".

2.2.3. **Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit**.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2025, plani i buxhetit i gjenëruar nga thesari ka vlerën 601,284 mijë lekë. Diferenca e cila nuk përputhet me vlerën e planit të buxhetit fillestar të miratuar nga Këshilli Bashkiak paraqitet (601,284 mijë lekë-455,929 mijë lekë**)**. në vlerën 145,355 mijë lekë. Bazuar në të dhënat sipas Akt-rakordimit përfundimtar dhe të dhënave të grumbulluara nga pyetësorët drejtuar institucionit, diferenca vjen për shkak se në buxhetin përfundimtar janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe ndryshimet përfshirë këtu edhe fondet e pushtetit qendror, të cilat nuk janë objekt i miratimit të Këshillit Bashkiak të NJQV. Më poshtë paraqitet buxheti përfundimtar plan-fakt për vitin 2025.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2025, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.2/ 7 Plani dhe fakti i buxhetit të Bashkisë viti 2025 në 000/lekë

Art.	Emërtimi	Plan	Fakti	%
600	Paga	261,671	245,746	93.91%
601	Sigurime Shoqërore	42,432	40,492	95.42%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	118,619	105,787	89,18%
604	Transferta Korente të Brendshme	3,430	2,693	78,51%
606	Trans për Buxhet. Familjar. & Individ	92,082	90,457	98.23%
609	Fondi Rezervë	2,090		0%
230	Kapitale të Patrupëzuara	4,730	1,730	36,57%
231	Kapitale të Trupëzuara	76,230	38,989	51,14%
	TOTAL	**601,284**	**525,894**	**87.46%**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kolonjë.

Nga auditimi i realizimit të shpenzimeve buxhetore sipas zërave rezulton se niveli i përgjithshëm

i realizimit paraqitet në masën 87,46% (525,894 mijë lekë kundrejt planit 601,284 mijë lekë), duke reflektuar një shkallë mesatare të ekzekutimit të buxhetit. Analiza sipas zërave evidenton se shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore paraqiten në nivele relativisht të larta realizimi, përkatësisht 94% dhe 95%, çka tregon një planifikim dhe zbatim më të qëndrueshëm të kostove të personelit. Në të njëjtën linjë, zëri "Transferta për buxhetet familjare dhe individët" realizohet në masën 98%, duke reflektuar prioritet në mbështetjen sociale. Nga ana tjetër, shpenzimet për "Mallra dhe Shërbime të Tjera" dhe "Transferta Korente të Brendshme" paraqesin nivele më të ulëta realizimi (89% dhe 79%), duke evidentuar mangësi në ekzekutimin e shpenzimeve operative dhe transfertave. Në drejtim të investimeve, "Kapitale të Trupëzuara" realizohen në masën 51%, duke treguar ritme jo të plota të zbatimit të projekteve kapitale, ndërsa "Kapitale të Patrupëzuara" paraqiten me realizim në masën 37%. Gjithashtu, zëri "Fondi Rezervë" rezulton i pa përdorur (0%), duke reflektuar mos aktivizim të këtij fondi gjatë vitit. Në tërësi, këta tregues evidentojnë një performancë të diferencuar ndërmjet zërave buxhetorë, me qëndrueshmëri në shpenzimet sociale dhe të personelit, por me dobësi në realizimin e shpenzimeve operative dhe investimeve, duke ndikuar në nivelin e përgjithshëm të realizimit të buxhetit. Më poshtë paraqitet buxheti përfundimtar plan-fakt për vitin 2025, sipas burimeve të financimit.

Tabela nr.2/ 8 Buxheti përfundimtar Plan-Fakt. Në 000/lekë

					Burimi i financimit të shpenzimit të realizuar				
Nr.	**Përshkrimi Shpenzimeve**	**Plani**	**Fakti**	**Realizimi në %**	**Nga të ardhurat e veta+ donator**	**Nga Granti qeveritar**			
						Nga transfertat e pakushtëzuar	**Nga transfertat e kushtëzuar specifike**	**Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara**	**Nga transfertat e kushtëzuar për investimet**
1	Paga 600	261,671	245,746	94%	47,659	112,073	96,658	5,281	
2	Sigurime shoqërorë 601	42,432	40,492	95%	0	24,800	16,758	874	
3	Shp. Operat 602	118,619	105,787	89%	40,142	45,591	30,960	1,926	
4	Fond. Emergj 609	2,090	0		2,000	90			
5	Transferta Korrente të brendshme 604	3,430	2,693	79%		200		3,230	
6	Transferta për familje dhe individë 606	92,082	90,457	98%		897	30	91,155	
7	Investime 230-231	80,960	40,719	50%	16,550	31,544	23,592		9,274
	Totali	**601,284**	**525,894**	**87%**	**106,351**	**215,195**	**167,998**	**102,466**	**9,274**

Burimi: Bashkia Kolonjë

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2025 për zërin e shpenzimeve (sipas burimeve të financimit, të ardhurat e veta vendore, transfertat e pa kushtëzuar, si dhe granti, transfertat e kushtëzuar) ka vlerën 601,284 mijë lekë, ndërsa realizimi 525,894 mijë lekë, ose në masën 87%.

- Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 261,671 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 245,746 mijë lekë, ose në masën 94 %, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 95%. Diferenca (mosrealizimi) ka ardhur si rezultat i vendeve vakante.
- Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 118,619 lekë dhe është realizuar në vlerën 105,787 lekë, ose në masën 89 %. Diferenca (mosrealizimi) ka ardhur si rezultat i çlirim fondi kontratë me vlerë objekti dhe të tjerat janë në proces prokurimi .
- Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 80,960 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 40,719 mijë lekë, ose në masën 50 %. Diferenca (mosrealizimi) ka ardhur

si rezultat i çlirim fondi kontratë me vlerë objekti dhe të tjerat që janë në proces prokurimi ,për disa objekte janë lidhur kontratat dhe janë në proces që likuidohen në vitin pasardhës.
- Sipas raportimit nga Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë nuk ka dhënë subvencione për vitin 2025.

2.2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizmit të të ardhurave (faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE).
Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga pyetësorët drejtuar institucionit (Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë) si dhe nga shqyrtimi i dokumentacioneve të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se në këtë institucion:
Për vitin 2024 detyrimet e konstatuara raportuara në MFE por të papaguara (*Detyrimet për fatura të pa likuiduara për shpenzime operative apo kapitale që i përkasin vitit 2024 dhe që trashëgohen për tu paguar në vitin 2025,*) paraqiten në vlerën 13,090,758 lekë**.** Gjatë vitit 2025 ky institucion sipas Urdhër shpenzimeve rezulton të ketë kryer pagesa për detyrimet e prapambetura *për fatura të pa likuiduara për shpenzime operative apo kapitale që i përkasin vitit 2024* në vlerën 8,362,060 lekë ose 64% e vlerës së raportuar në MFE për këtë zë. Pasqyra e Detyrimeve të prapambetura paraqitet në Aneksin nr.2/5 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga auditimi mbi detyrimet e prapambetura të evidentuara në fund të periudhës rezulton se institucioni paraqet detyrime të papaguara në vlerën totale 13,090,758 lekë, të regjistruara kryesisht në llogaritë 4864200 "Detyrime të prapambetura për mallra dhe shërbime", 4864300 *"Detyrime të prapambetura për mirëmbajtje"*, 4864400 *"Detyrime të prapambetura për investime"* dhe 4864600 *"Detyrime të prapambetura për mallra".* Struktura e detyrimeve tregon se peshën kryesore e zënë detyrimet për mallra dhe furnizime të ndryshme, të cilat arrijnë në rreth 6,794,443 lekë ose 51.9% të totalit të detyrimeve, të lidhura kryesisht me furnizime karburanti dhe vajrash, materiale ndërtimi, pelet për ngrohje, materiale mirëmbajtjeje dhe materiale për institucione arsimore e publike. Detyrimet për mallra dhe shërbime përbëjnë 4,416,800 lekë ose 33.7% të totalit, ndërsa detyrimet për investime paraqiten në vlerën 1,758,600 lekë ose 13.4% të totalit. Sipas natyrës së shpenzimeve konstatohet se detyrimet lidhen kryesisht me shpenzime operative dhe investime të kryera gjatë vitit 2024, për të cilat pagesat nuk janë realizuar brenda afateve buxhetore, duke sjellë krijimin e detyrimeve të prapambetura. Kjo situatë tregon se planifikimi dhe menaxhimi i fondeve buxhetore nuk ka garantuar mbulimin e plotë financiar të angazhimeve të marra, duke ndikuar në akumulimin e detyrimeve të papaguara ndaj operatorëve ekonomikë dhe duke krijuar risk për rëndimin e pozicionit financiar të institucionit në periudhat pasardhëse.

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.
Bashkia Kolonjë nuk ka detyrime të prapambetura për sa i përket vendimeve gjyqësore për vitin 2025.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.
Nga auditimi i pasqyrës së investimeve të financuara nga Pushteti qendror për vitin 2025, u konstatua se Bashkia Kolonjë ka administruar një portofol prej 4 investimesh me vlerë totale

120,551 mijë lekë, nga të cilat janë likuiduar 78,693 mijë lekë ose rreth 65% e vlerës së përgjithshme, ndërsa 41,858 mijë lekë mbeten të pa likuiduara. Statusi i investimeve për kontratat më poshtë i referohet vlerës së likuiduar sipas urdhër shpenzimeve.
Për vitin 2025 janë financuar me fonde të buxhetit të shtetit 4 investime publike, prej të cilave:
- 1 kontratë është lidhur në vitin 2023;
- 1 kontratë është lidhur në vitin 2024;
- 2 kontratë janë lidhur në vitin 2025;
p

Tabela nr.2/9: Pasqyra e investimeve nga Pushteti qendror

Nr.	Objekti i prokurimit	Kontrata nr.	datë	Vlera e plotë e kontratës me TVSH	Vlera e likuiduar	Vlera. e pa likuiduar	%	Arsyet
1	Ndërtim palestre për kompleksin " shkolla qendër Komunitare për shkollën 9 –vjeçare petro nini luarasi dhe papa kristo nëgovani ,Ersekë	12	06.12.2023	64,031	53,968	10,063	16	në proces
2	"Përmirësimi I kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara, Bashkia Kolonjë" Nr. reference REF-17133-08-27-2024	4	21.10.2024	19,495	19,495	0	0	përfunduar
3	"Përmirësimi I kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara, Bashkia Kolonjë" Nr. reference REF-55606-07-21-2025	6	01.09.2025	14,606	5,230	9,376	64	në proces
4	"Rikonstruksion I terreneve sportive të shkollës se Mesme të Bashkuar "Jani Vreto Leskovik"	2	10.03.2025	22,419	0	22,419	100	në proces
Totali				**120,551**	**78,693**	**41,858**	**35**	

Burimi i të dhënave: Bashkia Kolonjë

Nga auditimi u konstatua se, sipas projekteve shumica e investimeve vijojnë të jenë "në proces", me diferenca të konsiderueshme ndërmjet vlerës së kontraktuar dhe asaj të likuiduar, veçanërisht për projektin e terreneve sportive (100% e pa likuiduar) dhe për projektin e përmirësimit të banesave për vitin 2025" (64% e pa likuiduar), duke treguar ritme të ulëta të ekzekutimit financiar në raport me angazhimet e marra. Nga ana tjetër, projekti i përmirësimit të banesave për vitin 2024 rezulton i përfunduar. Investimet e reja të vitit 2025 paraqesin nivele të ulëta realizimi (64%–100%), çka reflekton fillim të vonuar ose ecuri të ngadaltë të zbatimit. Në tërësi, këta tregues evidentojnë një nivel të pjesshëm të ekzekutimit të investimeve nga fondet e Pushtetit qendror, me vonesa në realizimin fizik dhe financiar të projekteve, rritje të detyrimeve të pambyllura dhe nevojë për përmirësim të menaxhimit të kontratave, planifikimit të flukseve financiare dhe saktësisë së raportimit buxhetor.

Konkluzion: Nga auditimi i saktësisë së realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimit të tyre në raportet e monitorimit u konstatua se, megjithëse Bashkia Kolonjë ka realizuar shpenzime në vlerën 525,894 mijë lekë kundrejt planit përfundimtar prej 601,284 mijë lekë, niveli i përgjithshëm i realizimit paraqitet vetëm 87.46%, duke mos realizuar fonde në vlerën 75,390 mijë lekë. Mosrealizimi më i lartë evidentohet në shpenzimet kapitale, ku artikujt 230 dhe 231 janë planifikuar në vlerën 80,960 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 40,719 mijë lekë ose vetëm 50.3%, duke lënë të parealizuara 40,241 mijë lekë. Gjithashtu, artikulli 230 *"Kapitale të patrupëzuara"* është realizuar vetëm në masën 36.57% (1,730 mijë lekë kundrejt planit 4,730 mijë lekë), ndërsa fondi rezervë në vlerën 2,090 mijë lekë nuk është përdorur fare. Në të njëjtën kohë, në fund të vitit 2024 institucioni ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë detyrime të prapambetura në vlerën 13,090,758 lekë, nga të cilat gjatë vitit 2025 janë likuiduar vetëm 8,362,060 lekë ose 64%, ndërsa mbeten të pa likuiduara 4,728,698 lekë ose 36% e detyrimeve të trashëguara. Struktura e këtyre detyrimeve tregon se 6,794,443 lekë ose 51.9% lidhen me furnizime mallrash,

4,416,800 lekë ose 33.7% me mallra dhe shërbime dhe 1,758,600 lekë ose 13.4% me investime, duke evidencuar angazhime të marra pa mbulim të plotë financiar brenda vitit buxhetor. Nga auditimi i investimeve të financuara nga fondet e Pushtetit qendror rezultoi se për 4 investime me vlerë totale kontraktore 120,551 mijë lekë janë likuiduar vetëm 78,693 mijë lekë ose 65%, ndërsa 41,858 mijë lekë ose 35% mbeten të pa likuiduara. Veçanërisht, objekti "Rikonstruksion i terreneve sportive të shkollës së mesme të bashkuar 'Jani Vreto' Leskovik", me vlerë kontrate 22,419 mijë lekë, rezulton 100% i pa likuiduar, ndërsa projekti "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara" i kontraktuar në vitin 2025 paraqet nivel pa likuidimi prej 64% ose 9,376 mijë lekë. Situata e konstatuar tregon mangësi në planifikimin dhe ekzekutimin e investimeve, krijim të detyrimeve të pambyllura dhe ritme jo të kënaqshme të realizimit financiar të projekteve, duke ndikuar në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike dhe në realizimin e objektivave të planifikuara buxhetore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* dhe kërkesat për raportim e monitorim financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore.

2.2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuar
Struktura e Drejtorisë së të ardhurave dhe tatim-taksave, Bashkia Kolonjë.
Për vitin 2024-2025 është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sektorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe drejtoria e të ardhurave dhe tatim-taksave *(në vijim DATT)*.
-DATT ka në përbërjen e saj, 1 drejtor, 2 specialist dhe 2 inspektor. Gjithashtu në NJA Leskovik është i punësuar 1 specialist për taksat, në varësi organizative të DATT.
-DATT Bashkia Kolonjë, për vitin 2024-2025 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Kolonjë nga taksat dhe tarifat.
Struktura e DATT Bashkia Kolonjë, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2024-2025 paraqitet në Aneksin nr.2/6 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Taksat dhe Tarifat e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Kolonjë.
Përgjatë vitit 2024-2025, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, konkretisht:
-Paketa fiskale për vitin 2024-2025 është miratuar me VKB përkatëse dhe është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë .
Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2024-2025, kryesisht në ndarjen e detyrave, mbi strukturën që bën përllogaritjen e taksës dhe tarifës dhe strukturën që ngarkohet për vjeljen e saj, konstatohet se për disa lloje taksash dhe tarifash nuk është përcaktuar sektori që do të bëjë përllogaritjen dhe sektori që do të ndjekë vjeljen e taksës ose tarifës përkatëse. Gjithashtu konstatohet se në raste të caktuara për një lloj takse ngarkohet i njëjti sektor për përllogaritjen, faturimin dhe vjeljen e taksës. Situatë e mësipërme ndikon negativisht në aktivitetin e bashkisë në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave, pasi krijohet mundësia për mbivendosje të funksioneve, mos identifikim të saktë të përgjegjësisë për veprimin/mosveprimin, paqartësi dhe vonese në zbatimin e paketës fiskale etj. Mangësitë e mësipërme janë konstatuar në taksën e ndikimit në infrastrukturë, tarifën e tregtimit, parkimit, licencë/certifikatë në fushën e transportit, shërbimit nga institucionet e arsimit, kulturës, sportit, muzetë, tarifën për ujitjen dhe kullimin, shërbimet administrative, gjueti dhe peshkim, zhvillimin e turizmit. **Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në** shkronjën "f" në pikën 4 në nenin

9, nenin 20 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar. Regjistrat për të gjitha kategoritë e taksapaguesve mbahen në tabela Excel sipas llojit të tyre dhe jo me sistem informatikë të licencuar, çka nuk jep siguri për mbajtjen, përllogaritjen dhe administrimin e saktë e numrit të secilës kategori, si debitorëve dhe atyre të cilët taksohen dhe tarifohen.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. E. J, Drejtor i DATT.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2024-2025 dhe evidencave për raportime periodike, kryesisht për llojet e taksave dhe tarifave të miratuara për subjektet tatimpagues që kryejnë aktivitet në Bashkinë Kolonjë, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur 36 lloje taksash dhe tarifash.
Për vitin 2024-2025 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, ndahen në 4 kategori:
1.Biznës;
2.Ambulant;
3.Familjar;
4.Institucionë.
Kategoritë e mësipërme (përjashtuar institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:
- Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.
- Kategoria e tretë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore, si dhe numri i tyre.

Tabela 2/10:Biznëse dhe institucione.

Nr.	Lloji	2024	2025
1	Biznesi i Madh	67	67
2	Biznesi i Vogël	230	225
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	11	10
4	Institucione	22	22
	Total	**330**	**324**

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

5.Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*:*

Për vitin 2025 në total të ardhurat nga burimet e veta janë planifikuar 60.3 % më shumë për tu arkëtuar, krahasuar me mesataren e realizimit faktik të viteve 2023 - 2024, e shprehur kjo në vlerë absolute 37674 mijë lekë më shumë. Në total të ardhurat nga burimet e veta janë planifikuar 20.1 % më shumë për tu arkëtuar, krahasuar me mesataren e planifikimit të viteve 2023 - 2024 në vlerë absolute 16795 mijë lekë më shumë.
Realizimi faktik për vitin 2025 është 70.3% e planifikimit vjetor. Krahasuar me mesataren e realizimit faktik të viteve 2023 - 2024 realizimi i të ardhurave për vitin 2025 rezulton 12.6 % më i lart, e shprehur kjo në vlerë absolute 7893 mijë lekë më shume. Të dhënat mbi planifikimin dhe realizimin për vitin 2025 paraqiten në Aneksin nr.2/7 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të Bashkisë Kolonjë u konstatua se për vitin 2025 janë planifikuar të ardhura gjithsej në vlerën 100,117 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik ka qene 70,336 mijë lekë, me nivel realizimi 70.3%**,** duke mos u realizuar plani në masën 29,781 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2024, kur realizimi paraqitet 60,945 mijë lekë, të ardhurat e arkëtuara janë rritur me 9,391 mijë lekë ose rreth 15.4%, megjithatë niveli i përgjithshëm i realizimit ka mbetur pothuajse në të njëjtin nivel (72.0% në vitin 2024 kundrejt 70.3% në vitin 2025).
Nga auditimi sipas strukturës së të ardhurave konstatohet se tarifat vendore, të cilat përbëjnë zërin me peshën më të madhe në buxhetin e të ardhurave, për vitin 2025 janë planifikuar 71,372 mijë lekë, ndërsa janë realizuar 45,219 mijë lekë, me nivel realizimi 63.4%**,** ose 26,153 mijë lekë. Brenda kësaj kategorie evidentohet planifikim jo real dhe mosrealizim i konsiderueshëm në tarifën e druve të zjarrit, ku nga plani prej 12,000 mijë lekë janë arkëtuar vetëm 3,017 mijë lekë ose 25.1%**,** duke krijuar një diferencë negative prej 8,983 mijë lekë. Po kështu, tarifa për mirëmbajtjen e varrezave realizohet vetëm në masën 37.7%**,** tarifa e tregut në 44.4%**,** tarifa e parkimit në 40.4%**,** ndërsa tarifa e kullotave dhe pyjeve realizohet në 78.9%**.**
Veçanërisht problematike paraqitet tarifa "Fond pyjor me qira"**,** për të cilën është planifikuar një e ardhur prej 15,348 mijë lekë, por nuk rezulton asnjë arkëtim gjatë vitit 2025, duke realizuar 0% të planit. Kjo kategori e vetme përfaqëson mbi 51.5% të totalit të mosrealizimit të tarifave vendore dhe ka ndikuar ndjeshëm në mosrealizimin e planit të përgjithshëm të të ardhurave.
Në kategorinë e taksave vendore u konstatua se nga plani prej 23,903 mijë lekë janë realizuar 18,420 mijë lekë, me nivel realizimi 77.1%**,** ose 5,483 mijë lekë më pak. Mosrealizimi lidhet kryesisht me taksën mbi tokën bujqësore, e cila realizohet vetëm në masën 40.9%**,** taksën e ndërtesave të reja në infrastrukturë me 30.7%**,** taksën e hoteleve me 25.8%**,** si dhe taksën e biznesit të vogël me 40.5%**.** Në të kundërt, disa zëra rezultojnë të tejkaluar ndjeshëm ndaj planit, si TAP-i me realizim 195.1%**,** taksa e regjistrimit të automjeteve me 121.9% dhe taksa për ndërtesat e banimit me 129.0%**.**
Në kategorinë e gjobave dhe penaliteteve konstatohet se realizimi është në masën 25.3%**,** ku nga plani prej 800 mijë lekë janë arkëtuar vetëm 202 mijë lekë, duke reflektuar efikasitet të ulët në arkëtimin e penaliteteve administrative dhe detyrimeve të vendosura nga strukturat e kontrollit.
Të ardhurat jo tatimore paraqesin gjithashtu nivel të ulët realizimi prej 22.5%**,** ku nga plani prej 800 mijë lekë janë realizuar vetëm 180 mijë lekë. Edhe pse disa nën zëra si të ardhurat nga çerdhet dhe kopshtet kanë tejkaluar planin me 207.3%**,** pesha e tyre mbetet e kufizuar në totalin e të ardhurave.
Nga auditimi mbi arkëtimin e detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme, konstatohet se nga plani prej 3,000 mijë lekë janë arkëtuar 5,438 mijë lekë, me realizim 181.3%, çka tregon Planifikim jo të saktë dhe angazhim të strukturave përgjegjëse në mbledhjen e borxheve të akumuluara. Megjithatë, kjo performancë nuk ka qenë e mjaftueshme për të kompensuar mosrealizimin e kategorive kryesore të të ardhurave.
Konkluzion: Konstatohet se megjithëse Bashkia Kolonjë ka shënuar rritje të vlerës faktike të të ardhurave krahasuar me vitin paraardhës, niveli i realizimit të planit vijon të mbetet i ulët. Mosrealizimi lidhet kryesisht me planifikimin optimist të disa zërave të veçantë, veçanërisht të ardhurat nga fondi pyjor me qira, tarifat e druve të zjarrit, taksat mbi tokën bujqësore dhe tarifat e shërbimeve vendore, duke treguar se procesi i planifikimit të të ardhurave nuk është mbështetur plotësisht në analiza realiste të potencialit arkëtues dhe në performancën historike të mbledhjes së tyre. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë financiare të bashkisë, kufizon kapacitetin e financimit të shërbimeve publike dhe rrit varësinë nga burime të tjera financimi.

Tabela më poshtë tregon ndryshimet në planifikim dhe realizim për vitin 2025 krahasuar me mesataret e periudhës 2023–2024 dhe me vetë vitin 2023, për secilën nga strukturat përgjegjëse për administrimin e të ardhurave. Vlerat në tabelat më poshtë janë në mijë lekë.

Tabela 2/11: Ndryshimet në planifikim dhe realizim për vitin 2025

	Strukturat e ngarkuara për Administrimin e të ardhurave	Plan 2023	Fakt	Realizim	Plan 2024	Fakt	Mesatare e planifikimit 2023-2024	Mesatare e realizimit 2023-2024	Planifikimi 2025	Fakt	Realizimi %
A	**Drejtoria e të Ardhurave**	31590	27686	87.6%	43,473	27,763	37531	27725	95067	64241	**67.6%**
B	**Taksat nga AGJENTE**	5,031	9764	194.1%	5,031	10,763	5031	10263			
C	**Drejtoria e të Ardhurave & Drejtoritë e tjera**	46,297	26896	58.1%	3,6819	22,425	41558	24660	5050	6095	**120.7**

	Strukturat e ngarkuara për Administrimin e të ardhurave	Planifikimi 2025/mesatare Planifikimit 2023-2024 në %	Planifikimi 2025/mesatare Planifikimit 2023-2024 në VL ABS	Planifikimi 2025/mesatare Realizimit 2023-2024në %	Planifikimi 2025/mesatare Realizimit 2023-2024 në Vlerë Absolute	Realizimi2025/mesataren e realizimit 2023-2024 në %	Realizimi2025/mesataren e realizimit 2023-2024 në Vlerë Absolute	Realizimi 2025/ realizimit 2023 në %	Realizimi 2025/ realizimit 2023 në VL ABS
A	**Drejtoria e të Ardhurave**	153.3	57536	153.3	57536	56.85	36516	43.11	36555
B	**TAKSAT NGA AGJENTE**	0 -	-0	-0	-0	0	0	0	0
C	**Drejtoria e të Ardhurave & Drejtoritë e tjera**	87.8	-36508	-79.5	-19610	20.48	-19610	19.5	-20846

Burimi i të dhënave: Bashkia Kolonjë.

Strukturat e ngarkuara për administrimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kolonjë janë: *Drejtoria e të Ardhurave; Drejtoria e të ardhurave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera; Taksat nga AGJENTE.*

Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave sipas strukturave të ngarkuara për administrimin e tyre u konstatua se përgjithësisht të ardhurat që kanë një tejkalim të realizimit në krahasim me planifikimin vjetor janë të ardhurat nga taksat që mblidhen nga në Bashkëpunim ,me drejtoritë e tjera. Duke analizuar të dhënat mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave në Bashkinë Kolonjë konstatohet se për taksa/tarifa vendore të cilave nuk është bërë planifikim real edhe pse në dy vitet e mëparshme kanë rezultuar me realizime ndjeshëm më të larta.

Drejtoria e të Ardhurave: Planifikimi 2025 u rrit me 153.3% (57536 mijë lekë më shumë) krahasuar me mesataren e Planifikimeve për periudhën 2023–2024, kurse krahasuar me realizimin mesatar për periudhën 2023–2024 ky planifikim është rritur me +242.8% (67342 mijë Lekë më shumë). Realizimi i 2025 krahasuar me mesataren e realizimeve për periudhën 2023–2024 pësoi rritje pasi Taksat nga agjentet i kanë kaluar të gjitha Drejtorisë së të Ardhurave .

Drejtoria e të ardhurave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera: Planifikimi për vitin 2025 pati rënie me mesataren e planifikimit për periudhën 2023–2024 me -87.8% (36508 mijë lekë më pakë) dhe realizimin mesatar për periudhën 2023–2024 (-1,278%, 19610 mijë lekë më pak). Realizimi për vitin 2025 krahasuar me mesataren për periudhën 2023–2024 arriti +56.85% (36516 mijë lekë më shumë), dhe përsëri paraqitet me lart me 43.11% (pra +36555 lekë më shumë) në krahasim me realizimin e vitit 2023.

Mbi kontrollin e cilësisë së të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve

Veprimtaria e Drejtorisë së të ardhurave në vijim DA sa i përket procesit të planifikimit, realizimit të të ardhurave dhe evidentimi të detyrimeve të pa arkëtuara progresive për secilin vit buxhetor bazohet në proceset që menaxhojnë:

Kërkesa për regjistrim të subjekteve të reja
Ndryshime të të dhënave rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese
Kërkesat për çregjistrim, pezullim të subjekteve ekzistuese
Të dhënat e administruara në regjistrin elektronik të DA janë në funksion të identifikimit të subjektit tatimpagues dhe përcaktimit të detyrimit për tu paguar lidhur me taksat dhe tarifat vendore.
Bashkia Kolonjë ka një regjistër elektronik të subjekteve, Rakordimi i kërkesave për regjistrim/çregjistrim, ndryshimit të të dhënave të subjekteve etj., nuk është pjesë vetëm e aktivitetit të këtij institucioni por një ndërthurje midis Degës Rajonale të Tatimeve në vijim (DRT), qendrës Kombëtare të Biznesit në vijim (QKB) dhe sektorit/inspektorëve të kontrollit në terren pranë DA. Kjo drejtori nuk ka një korrespondence të plotë me QKB dhe DRT. *Për vitin 2025 nuk ka asnjë komunikim me QKB dhe DRT lidhur me rakordimin mujor apo vjetor për numrin e subjekteve të reja, subjekteve të cilat kanë ndryshuar të dhënat rreth adresës primare ose sekondare, subjekteve të çregjistruara.*
Sektori/inspektorët e terrenit janë hallka e vetme për të përcaktuar përputhjen midis të dhënave të deklaruara vullnetarisht nga subjekti në QKB, të dhënat faktike në terren dhe të dhënave që administron DA në dosjen e subjektit.
Popullimi i regjistrit elektronik të subjekteve me kërkesa për regjistrim të subjekteve të reja, ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese nuk realizohet bazuar në përcaktimet e cituara në manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe duke rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT. Mungon Gjurma e auditimit dhe nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve.
Akt konstatimet nga sektori i terrenit në shumicën e rasteve janë të bazuara në vetë deklarimet e subjekteve/individëve ose nuk janë të rifreskuara periodikisht (çdo vit) dhe nuk shprehin qartë objektin për të cilin është kërkuar mbajtja e këtij akt konstatimi konkretisht për:

"Kërkesat për regjistrim të subjekteve të reja, kërkesat për ndryshime të dhënash, kërkesat për ndryshimin e statusit të aktivitetit (çregjistrim, pasiv apo pezullim të subjekteve ekzistuese) nga subjektet tatim pagues".
Ky akt konstatim është shumë i rëndësishëm, ai duhet të realizohet konform kuadrit rregullator ligjor brenda afateve të përcaktuara në ligj sepse: Në rast të mos respektimit të afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor, QKB procesion automatikisht me ndryshimin e statusit. DA Kolonjë për të gjitha rastet kur statusi ka ndryshuar ndërpret faturimin e mëtejshëm të subjektit edhe pse ky çregjistrim ka ardhur si pasojë e mos përgjigjes në kohë ndaj kërkesës për evidentimin e gjendjes debitorë nga QKB.
Nga evidencat e administruara në DA nuk u konstatua asnjë dokument i cili tregon rakordimin me degët rajonale të tatimeve lidhur me:

- Klasifikimin e biznesit dhe llojin e aktivitetit që kryen.
- Për rastet kur subjekti edhe pse ka gjendje debitorë, rezulton me statusin çregjistruar, pasiv apo pezulluar.

Për rastet kur subjekti, ka gjendje debitorë, rezulton me statusin aktiv në QKB por në regjistër pasqyrohet me statusin mbyllur pasiv apo pezulluar. Ky status në regjistër elektronik ndërpret njoftim detyrimin

Nga auditimi i dokumentacionit financiar të Bashkisë Kolonjë për vitin 2025, u konstatua se planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta nuk është hartuar në përputhje me të dhënat reale, të përditësuara dhe të rakorduar me drejtoritë e tjera, si dhe mungon regjistri i plotë i tatimpaguesve. Planifikimi për periudhën në auditim nuk është kryer mbi analiza të mbështetura në të dhëna faktike dhe historike, konkretisht, ky planifikim është ndjeshëm më i lartë krahasuar me realizimin faktik të vitit 2024, duke rezultuar në një mosrealizim. Gjithashtu, u konstatua se në kontabilitetin e Bashkisë mungon një listë analitike për evidentimin e të ardhurave të trashëguara nga burimet e veta, e cila bën të pamundur verifikimin e burimit nga është krijuar kjo e ardhur (e ardhura e trashëguar) e si pasojë nuk jep mundësinë për të kontrolluar mënyrën e përdorimit të tyre si dhe pasaktësi në klasifikimin dhe destinimin e shpenzimeve, duke cenuar procesin e buxhetimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, datë 18.05.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar; Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 6; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar.

Nga auditimi i veprimtarisë së strukturave për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kolonjë për vitin 2025, u konstatua se struktura e Drejtorisë të të Ardhurave nuk është plotësisht në funksion të planifikimit dhe realizimit të të ardhurave vendore. Kjo pasi në strukturën e saj mungojnë sektorët thelbësorë si "Sektori i menaxhimit të borxhit tatimor", "Sektori i regjistrimit të subjekteve" dhe "Sektori i kontrollit në terren", të cilët janë të domosdoshëm për ndarjen e funksioneve dhe realizimin efikas të proceseve të arkëtimit dhe monitorimit të tatimpaguesve. Në paketën fiskale të miratuar për vitin 2025 janë miratuar 110 taksa/tarifa vendore, ndërkohë që evidenca e realizimit përfshin vetëm 29 prej tyre. Mungon përcaktimi i qartë i përgjegjësive për përllogaritjen dhe vjeljen e çdo takse, si dhe evidencat e plota për listat e debitorëve dhe për planifikimin e të ardhurave nga të gjitha strukturat përgjegjëse. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligjin nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*"; Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "*Për regjistrimin e biznesit*" i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*"; Ligjin nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; Ligjin nr. 13/2016, "*Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportele*", Ligjin nr. 119/2014, "*Për të drejtën e informimit*"; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Udhëzimin nr. 26, datë 16.12. 2014 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*"; Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007, "*Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve proceduralë dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore*.

Bashkia Kolonjë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, nuk ka marrë masa për ristrukturimin e drejtorisë së të ardhurave, duke krijuar sektorët për menaxhimin e borxhit tatimor, regjistrimin e subjekteve dhe kontrollin në terren. Ky institucion nuk ka kryer përmirësimin e regjistrave elektronikë të tatimpaguesve dhe të vendosë në funksion një adresar të unifikuar për individë dhe biznese, për të mundësuar planifikimin, vlerësimin dhe njoftimin në kohë të detyrimeve tatimore. Nuk ka kryer rakordime të rregullta ndërmjet strukturave të përfshira në mbledhjen e të ardhurave për të siguruar një proces të koordinuar dhe të dokumentuar të administrimit të të ardhurave. Të sigurohet që për çdo taksë/tarifë të përcaktohet struktura përgjegjëse për përllogaritjen dhe vjeljen dhe të hartohet një evidencë e përbashkët për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave

Nga auditimi i regjistrit elektronik të subjekteve në format Excel dhe sistemit të kontrollit të të dhënave për administrimin e tatimpaguesve në Bashkinë Kolonjë për vitin 2025, u konstatua se mungon një sistem funksional verifikimi dhe kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave të regjistruara. Bashkia nuk ka zhvilluar asnjë proces rakordimi me qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe Degën Rajonale të Tatimeve (DRT) mbi regjistrimet, çregjistrimet, ndryshimet e statusit apo të dhënave të subjekteve. Regjistri elektronik nuk përmban elementët e nevojshëm të gjurmës së auditimit dhe nuk është i integruar me procesverbale apo akt-konstatime të rregullta dhe të përditësuara nga kontrolli në terren. Sa më sipër mungon gjurma e auditimit për raste kur subjektet me status aktiv në QKB figurojnë si të mbyllura ose pasive në regjistrin elektronik në format Excel, duke ndërprerë faturimin dhe njoftimin e detyrimit tatimor, si dhe raste të kundërta kur subjektet me gjendje debitorë rezultojnë të çregjistruar apo pezulluar pa ndjekur procedurën përkatëse verifikuese. Kjo situatë krijon pasaktësi në vlerësimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, cenon integritetin e të dhënave dhe dëmton procesin e planifikimit financiar dhe fiskal të Bashkisë Kolonjë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligjin nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*"; Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "*Për regjistrimin e biznesit*" i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*"; Ligjin nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; Ligjin nr. 13/2016, "*Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportele*", Ligjin nr. 119/2014, "*Për të drejtën e informimit*"; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Udhëzimin nr. 26, datë 16.12. 2014 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*"; Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007, "*Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore*;

<u>Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e taksave/tarifave kategoria familjare;</u>

Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e taksapaguesve "Familjar", u konstatua se me VKB nr. 138, datë 25.11.2025 "Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kolonjë", për vitin 2025 janë miratuar nivelet e taksave dhe tarifave vendore për familjarët, konkretisht: taksa e ndërtesës për familjarët në Njësitë Administrative në masën 500 lekë/vit për familje, taksa e ndërtesës për banesat në Qytetin Ersekë në masën 8.05 lekë/m² dhe në Qytetin Leskovik në masën 7.35 lekë/m², tarifa e pastrimit 2,000 lekë për familjet në qytet dhe 1,000 lekë për familjet në Njësitë Administrative, tarifa e ndriçimit 1,800 lekë për familjet në qytet dhe 1,000 lekë për familjet në Njësitë Administrative, si dhe taksa mbi tokën bujqësore dhe tarifa e mirëmbajtjes së varrezave. Në të njëjtin vendim janë përcaktuar

edhe kategoritë përfituese të përjashtimeve dhe lehtësive fiskale, ku sipas të dhënave të administruara nga Bashkia Kolonjë rezultojnë të përjashtuara 799 familje, nga të cilat 219 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, persona me aftësi të kufizuara dhe kategori të tjera sociale, si dhe 580 kryefamiljarë pensionistë. Në mënyrë të përmbledhur familjet e përjashtuara paraqiten në Aneksin 2/8 bashkëngjitur projektit të auditimit.
Sipas evidencave të Drejtorisë së të Ardhurave, planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat familjare për vitin 2025 është në vlerën 7,517 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik paraqitet në vlerën 4,937 mijë lekë ose 65.7% e planit. Nga analiza krahasuese e viteve 2023–2025 rezulton se taksat familjare janë planifikuar në vitin 2025 në vlerën 7,517 mijë lekë kundrejt 7,219 mijë lekë në vitin 2024, ndërsa realizimi faktik ka rënë nga 4,454 mijë lekë në vitin 2024 në 4,937 mijë lekë në vitin 2025, duke reflektuar rritje prej vetëm 483 mijë lekë ose 10.85%, ndërkohë që planifikimi është ndërtuar mbi një bazë 3,063 mijë lekë ose 40.75% më të lartë se realizimi i vitit paraardhës.
Nga auditimi sipas nënkategorive u konstatua se taksa mbi ndërtesat e banimit është planifikuar në nivel pothuajse të pandryshuar krahasuar me vitin 2024, por realizimi i vitit 2025 ka arritur në 2,731 mijë lekë kundrejt 2,380 mijë lekë në vitin 2024, me rritje prej 351 mijë lekë ose 14.75%. Në Qytetin Ersekë realizimi është rritur nga 676 mijë lekë në 751 mijë lekë ose 11.09%, në Qytetin Leskovik nga 340 mijë lekë në 462 mijë lekë ose 35.88%, ndërsa në Njësitë Administrative qendër Ersekë, Mollas, Çlirim, Barmash dhe Novoselë realizimi është rritur nga 1,285 mijë lekë në 1,421 mijë lekë ose 10.58%. Përkundrazi, për tarifat familjare planifikimi është mbajtur në të njëjtin nivel prej 12,000 mijë lekë si në vitin 2024, megjithëse realizimi faktik i vitit 2024 ishte vetëm 7,899 mijë lekë. Në vitin 2025 realizimi ka zbritur në 7,454 mijë lekë ose 445 mijë lekë më pak se viti paraardhës. Rënie evidentohet në tarifën e pastrimit familjar, e cila ka kaluar nga 3,841 mijë lekë në 3,463 mijë lekë ose 378 mijë lekë më pak, si dhe në tarifën e ndriçimit familjar, e cila ka kaluar nga 3,027 mijë lekë në 2,861 mijë lekë ose 166 mijë lekë më pak. Tarifa për mirëmbajtjen e varrezave ka mbetur pothuajse në të njëjtin nivel, nga 1,131 mijë lekë në 1,130 mijë lekë. Në mënyre të përmbledhur evidenca e planifikimit dhe realizimit për familjaret paraqitet në Aneksin 2/9 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit

Nga auditimi mbi krahasimin e planifikimit me realizimin historik u konstatua se planifikimi i vitit 2025 për taksat dhe tarifat familjare është ndërtuar në vlerën 8,703 mijë lekë ose 80.5% më të lartë se realizimi faktik i vitit 2024, ndërkohë që realizimi faktik i vitit 2025 është rritur vetëm me 1,539 mijë lekë ose 14.2% krahasuar me vitin paraardhës. Kjo tregon se planifikimi nuk është mbështetur plotësisht në analizën e performancës historike të arkëtimeve dhe potencialin real të mbledhjes së të ardhurave nga kjo kategori taksapaguesish.

Auditim i bazës së tatueshme për kategorinë familjare krahasuar me të dhënat e gjendjes civile;
Nga auditimi mbi bazën e tatueshme të kategorisë “Familjar” dhe krahasimi i saj me të dhënat e gjendjes civile, u konstatua se Bashkia Kolonjë planifikon të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore për 4,596 familje, ndërkohë që sipas të dhënave të sistemit të gjendjes civile numri i familjeve rezidente në territorin e bashkisë është 6,587 familje. Pas zbritjes së 728 familjeve të përjashtuara sipas paketës fiskale, rezulton një diferencë prej 1,263 familjesh të pa përfshira në bazën e planifikimit të të ardhurave.
Nga auditimi u konstatua se sipas zonave administrative në Qytetin Ersekë janë planifikuar 1,563 familje, ndërsa sipas gjendjes civile rezultojnë 2,222 familje. Pas zbritjes së 376 familjeve të përjashtuara mbeten 283 familje të paplanifikuara, me efekt financiar prej 3,205 mijë lekë të cilat

përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Kolonjë. Në Qytetin Leskovik janë planifikuar 575 familje, ndërsa sipas gjendjes civile rezultojnë 846 familje; pas zbritjes së 175 familjeve të përjashtuara rezultojnë 96 familje të paplanifikuara me efekt financiar prej 463 mijë lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Kolonjë. Në Njësitë Administrative janë planifikuar 2,458 familje kundrejt 3,519 familjeve sipas gjendjes civile dhe pas zbritjes së familjeve të përjashtuara rezultojnë 884 familje të pa përfshira në planifikim, me efekt financiar prej 2,672 mijë lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Kolonjë. Në total, diferenca prej 1,263 familjesh përfaqëson të ardhura të munguara potenciale në vlerën 6,340 mijë lekë për Bashkinë Kolonjë. Në mënyre të përmbledhur paraqitet në aneksin 2/10 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga auditimi mbi metodologjinë e llogaritjes së detyrimeve u konstatua se ngarkesa mesatare fiskale për një familje në Qytetin Ersekë është 4,863.5 lekë/vit, e përbërë nga taksa e ndërtesës 563.5 lekë, tarifa e pastrimit 2,000 lekë, tarifa e ndriçimit 1,800 lekë dhe tarifa e varrezave 500 lekë. Për Qytetin Leskovik ngarkesa mesatare është 4,814.5 lekë/vit, ndërsa për Njësitë Administrative është 3,023 lekë/vit. Krahasimi i këtyre treguesve me numrin e familjeve sipas gjendjes civile tregon se procesi i planifikimit të të ardhurave nuk është mbështetur mbi bazën e plotë të tatueshme të familjeve rezidente në territorin e bashkisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në nënvlerësimin e potencialit të të ardhurave vendore.

Në mënyre të përmbledhur planifikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore paraqitet në aneksin 2/11 dhe 2/12 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Auditim mbi planifikimin dhe administrimin e taksës mbi tokën bujqësore;

Nga auditimi mbi planifikimin dhe administrimin e taksës së tokës bujqësore u konstatua se në territorin e Bashkisë Kolonjë fondi i tokës bujqësore është 11,215 ha sipas evidencave të Drejtorisë së Bujqësisë, ndërsa sipas regjistrave të administruar për ndarjen me AMTP rezultojnë 7,279 ha tokë e ndarë dhe 3,990 ha tokë e pandarë. Megjithatë, në procesin e planifikimit të të ardhurave për vitin 2025 janë marrë në konsideratë vetëm 6,709 ha, duke lënë jashtë planifikimit 570 ha të sipërfaqes së ndarë me AMTP. Në mënyre të sipërfaqja e tokës bujqësore në Bashkinë Kolonjë paraqitet në aneksin 2/13 dhe 2/14 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga auditimi mbi planifikimin e të ardhurave për këtë taksë u konstatua se për vitin 2025 janë planifikuar 5,400 mijë lekë kundrejt 5,100 mijë lekë në vitin 2024, me rritje prej 300 mijë lekë ose 5.9%. Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2024 në vlerën 2,074 mijë lekë, planifikimi i vitit 2025 është 3,326 mijë lekë ose 160.4% më i lartë. Megjithatë, realizimi faktik i vitit 2025 ka arritur vetëm 2,206 mijë lekë, me rritje prej 132 mijë lekë ose 6.37% krahasuar me vitin paraardhës, duke treguar një diferencë të madhe ndërmjet pritshmërinë të planifikimit dhe kapacitetit real të arkëtimit.

Nga auditimi mbi administrimin e bazës së tatueshme u konstatua se për 4,436 familje përfituese të tokës bujqësore sipas AMTP rezultojnë të regjistruara 7,279 ha, ndërsa në regjistrat e përdorur për planifikimin e të ardhurave figurojnë vetëm 6,869 ha. Diferenca prej 410 ha lidhet me familje që kanë deklaruar heqjen dorë nga posedimi i tokës për efekt taksimi, por që vijojnë ta përdorin atë në praktikë. Duke aplikuar tarifën prej 700 lekë/ha të miratuar me paketën fiskale, vlera e të ardhurave të munguara nga kjo sipërfaqe përllogaritet në 287 mijë lekë në vit**.** Në mënyre të përmbledhur fondi i tokës bujqësore planifikimi dhe realizimi i taksës se tokës bujqësore dhe debia progresive për taksen e tokës bujqësore paraqitet në aneksin 2/15 dhe 2/16 dhe 2/17 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit

Gjithashtu, u konstatua se planifikimi nuk merr në konsideratë arkëtimin e detyrimeve progresive të trashëguara për këtë kategori, të cilat sipas evidencave paraqiten në vlerën 25,947,985 lekë në fillim të vitit 2025. Gjatë vitit janë arkëtuar 2,206 mijë lekë nga 1,482 familje, nga të cilat 1,544 mijë lekë për detyrimet e vitit korrent dhe 661 mijë lekë për pakësimin e debisë progresive. Krahasuar me vitin 2024, kanë paguar detyrimin për këtë taksë 134 familje më pak, ndërsa rritja e arkëtimeve është vetëm 132 mijë lekë. Kjo situatë tregon mungesë rakordimi ndërmjet sipërfaqes së tatueshme, bazës së familjeve përfituese sipas AMTP dhe bazës së përdorur për planifikimin e të ardhurave, duke ndikuar në nënvlerësimin e potencialit fiskal dhe në nivelin e ulët të realizimit të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi
Z. E. J, Drejtor i DATTV Bashkia Kolonjë,
Znj. L. K, z. F D, znj. E I; Specialistë
Z. J. Z, z. R H I; nspektorë

Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të kontratave të qirasë së tokës bujqësore;
Nga auditimi i kontratave të qirasë për tokën bujqësore u konstatua se Bashkia Kolonjë administron 22 kontrata aktive me sipërfaqe totale 129.54 ha. Për vitin 2025, të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet paraqiten në vlerën 637,939 lekë, ndërsa vlera totale vjetore e kontratave aktive arrin në 730,339 lekë. Në mënyre të përmbledhur kontratat e qirasë të tokës bujqësore paraqitet në aneksin 2/18 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga shqyrtimi i evidencës së pagesave u konstatua se në fund të vitit 2025 dy kontrata paraqiten debitorë në vlerën totale 92,400 lekë. Konkretisht, subjekti "G N", për kontratën e lidhur më datë 28.03.2019 për sipërfaqe 7.4 ha, rezulton me detyrim të papaguar në vlerën 44,610 lekë, ndërsa subjekti "B C ", për kontratën e lidhur më datë 05.11.2018 për sipërfaqe 7.965 ha, rezulton me detyrim të papaguar në vlerën 47,790 lekë.
Nga auditimi mbi strukturën e kontratave u konstatua se të ardhurat sigurohen kryesisht nga kontratat me sipërfaqe më të mëdha bujqësore. Kontrata me subjektin "A O F", për sipërfaqe 15.3 ha, gjenëron të ardhura vjetore në vlerën 91,800 lekë, kontrata me subjektin "G V" për sipërfaqe 14.7 ha gjenëron 88,608 lekë, ndërsa kontrata me subjektin "R N" për sipërfaqe 13.25 ha gjenëron 79,500 lekë në vit. Këto kontrata përfaqësojnë pjesën kryesore të të ardhurave të krijuara nga përdorimi me qira i tokës bujqësore.
Nga auditimi mbi arkëtimet u konstatua se pjesa dërrmuese e kontratave kanë përmbushur detyrimet kontraktore gjatë vitit 2025, ndërsa niveli i detyrimeve të papaguara përfaqëson rreth 12.7% të vlerës totale vjetore të kontratave. Kjo situatë tregon nevojën për forcimin e monitorimit të kontratave debitorë dhe ndjekjen në kohë të detyrimeve të papaguara, me qëllim garantimin e arkëtimit të plotë të të ardhurave që rrjedhin nga administrimi i tokës bujqësore në pronësi të bashkisë.

Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të kontratave të qirasë së fondit pyjor-kullosor;

Nga auditimi i kontratave të qirasë së fondit pyjor-kullosor u konstatua se Bashkia Kolonjë administron 21 kontrata aktive me sipërfaqe totale rreth 236.51 ha. Për vitin 2025, të ardhurat e

realizuara nga ky aktivitet paraqiten në vlerën 4,096,115 lekë, ndërsa deri më 31.12.2025 janë arkëtuar 3,907,255 lekë, duke mbetur të pa arkëtuara 142,916 lekë. Në mënyre të përmbledhur kontratat e qirasë fondit pyjor kullosor paraqitet në aneksin 2/19 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit

Nga auditimi mbi strukturën e të ardhurave u konstatua se ato janë të për qëndruara në një numër të kufizuar kontratash. Kontrata me subjektin "M&.", për sipërfaqe 102.0711 ha, gjenëron të ardhura vjetore në vlerën 2,755,919 lekë ose 67.3% të totalit, ndërsa kontrata me subjektin "M", për sipërfaqe 31.68 ha, gjenëron 775,526 lekë ose 18.9% të totalit. Së bashku, këto dy kontrata përfaqësojnë rreth 86.2% të të ardhurave të realizuara nga fondi pyjor-kullosor.

Gjatë vitit 2025 janë lidhur dy kontrata të reja, konkretisht me subjektin "B B", për sipërfaqe 0.2 ha dhe vlerë 22,000 lekë/vit, si dhe me subjektin "A G", për sipërfaqe 3.6 ha dhe vlerë 23,944 lekë/vit. Të ardhurat e gjenëruara nga këto kontrata përfaqësojnë më pak se 1.2% të totalit të të ardhurave vjetore nga fondi pyjor-kullosor.

Nga shqyrtimi i evidencës së pagesave u konstatua se në fund të vitit 2025 katër kontrata paraqiten debitorë në vlerën totale 142,916 lekë. Konkretisht, subjekti "6 K" rezulton me detyrim 25,000 lekë, subjekti "P B" me 60,000 lekë, subjekti "R A" me 48,200 lekë dhe subjekti "E Sh" me 9,716 lekë. Këto detyrime përfaqësojnë rreth 3.5% të të ardhurave vjetore të kontraktuara.

Nga auditimi u konstatua gjithashtu se për disa kontrata aktive, konkretisht "G G E", "S B K" dhe "L M", në evidencën përmbledhëse nuk pasqyrohet vlera vjetore e qirasë, por vetëm referimi "sipas nenit 3 të kontratës", duke mos mundësuar një pasqyrim të plotë të përfitimit ekonomik që rrjedh nga këto kontrata dhe duke kufizuar analizën e plotë të performancës së administrimit të fondit pyjor-kullosor.

Nga auditimi mbi administrimin e këtyre kontratave u konstatua se niveli i arkëtimit arrin rreth 95.4% të të ardhurave të kontraktuara, megjithatë për qëndrimi i të ardhurave në një numër të kufizuar kontratash, ekzistenca e kontratave debitorë dhe mungesa e informacionit të plotë financiar për disa kontrata aktive paraqesin elementë risku që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm nga strukturat përgjegjëse për administrimin e aseteve publike.

Konkluzion: Nga auditimi i organizimit dhe funksionimit të strukturave përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, cilësisë së të dhënave që shërbejnë për planifikimin, vlerësimin dhe arkëtimin e detyrimeve vendore, si dhe administrimit të bazës së tatueshme në Bashkinë Kolonjë, u konstatua se sistemi i administrimit të të ardhurave vendore nuk është mbështetur në një strukturë të plotë organizative, në procedura efektive kontrolli dhe në evidenca administrative të plota dhe të besueshme. Konkretisht, në strukturën e Drejtorisë së të Ardhurave mungojnë sektorë të specializuar si "Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor", *"Sektori i Regjistrimit të Subjekteve"* dhe *"Sektori i Kontrollit në terren"*, ndërsa në Paketën Fiskale të vitit 2025 janë miratuar 110 taksa dhe tarifa vendore, por evidencat e realizimit përfshijnë vetëm 29 prej tyre. Gjithashtu, nuk është përcaktuar në mënyrë të plotë ndarja e përgjegjësive ndërmjet strukturave që kryejnë përllogaritjen, faturimin dhe arkëtimin e disa taksave dhe tarifave vendore, ndërkohë që për kategori të caktuara i njëjti sektor kryen njëkohësisht përllogaritjen, faturimin dhe vjeljen e detyrimeve, duke krijuar mbivendosje funksionesh dhe dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi mbi cilësinë e të dhënave që shërbejnë për planifikimin dhe vlerësimin e detyrimeve vjetore për taksat dhe tarifat vendore u konstatua se administrimi i të dhënave kryhet në tabela Excel dhe jo në një sistem informatikë të licencuar, ndërsa mungon një sistem funksional

verifikimi dhe kontrolli mbi saktësinë dhe integritetin e të dhënave të regjistruara, si për kategorinë "Biznes", ashtu edhe për kategorinë "Familjar".
Për kategorinë e biznesit, Bashkia Kolonjë nuk ka kryer rakordime me qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe Degën Rajonale të Tatimeve (DRT) për regjistrimet, çregjistrimet, ndryshimet e statusit dhe të dhënave të subjekteve. Regjistri elektronik nuk përmban elementët e nevojshëm të gjurmës së auditimit dhe nuk mbështetet në procesverbale apo akt-konstatime periodike të kontrollit në terren. Për pasojë, konstatohet mungesë e gjurmueshmërisë për raste kur subjekte me status aktiv në QKB figurojnë të mbyllura ose pasive në regjistrat e bashkisë, duke ndërprerë faturimin dhe njoftimin e detyrimeve tatimore, si dhe për rastet kur subjekte me detyrime debitorë figurojnë të çregjistruara ose të pezulluara pa procedura të dokumentuara verifikimi.
Për kategorinë familjare, nga auditimi mbi bazën e tatueshme dhe planifikimin e të ardhurave u konstatua se procesi nuk është mbështetur në të dhëna të plota administrative dhe në analizë të plotë të potencialit fiskal. Në planifikimin e vitit 2025 janë marrë në konsideratë 4,596 familje, ndërkohë që sipas të dhënave të gjendjes civile rezultojnë 6,587 familje rezidente. Pas zbritjes së 728 familjeve të përjashtuara sipas paketës fiskale, rezultojnë 1,263 familje të pa përfshira në bazën e planifikimit. Gjithashtu, nga 7,279 ha tokë bujqësore të ndara me AMTP janë përfshirë në planifikim vetëm 6,709 ha, duke lënë jashtë planifikimit 570 ha sipërfaqe të tatueshme, ndërsa në regjistrat e përdorur për planifikim figurojnë vetëm 6,869 ha, ose 410 ha më pak se sipërfaqja e regjistruar sipas AMTP, me efekt financiar të munguar prej 287 mijë lekë në vit. Në të njëjtën kohë, nuk janë marrë në konsideratë në planifikimin e vitit 2025 detyrimet progresive të trashëguara. Po ashtu, nga auditimi mbi administrimin e kontratave të qirasë së tokës bujqësore dhe fondit pyjor-kullosor u konstatua se ekzistojnë mangësi në monitorimin periodik të kontratave, në ndjekjen e detyrimeve debitorë dhe në administrimin e evidencave kontraktore, duke mos siguruar informacion të plotë dhe të besueshëm mbi të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i aseteve publike. Për pasojë, mungesa e strukturave të specializuara, administrimi i të dhënave jashtë sistemeve të integruara informatike, mos rakordimi i bazave të të dhënave me institucionet përgjegjëse, mos përfshirja e plotë e bazës së tatueshme dhe mangësitë në administrimin e kontratave të qirasë kanë sjellë dobësi në planifikimin e të ardhurave, pasaktësi në vlerësimin e detyrimeve vendore, kufizim të potencialit fiskal të bashkisë, risk për mos arkëtimin e të ardhurave dhe ulje të besueshmërisë së të dhënave që shërbejnë për planifikimin financiar dhe administrimin e të ardhurave vendore.

Auditim mbi strukturën e detyrimeve të prapambetura deri me 31.12.2025.
Në tabelën më poshtë paraqitet struktura e detyrimeve të prapambetura progresive në Bashkinë Kolonjë sipas kategorive dhe nënkategorive.

Tabela 2/12: Struktura e detyrimeve të prapambetura progresive

Kategoritë		Vlera progresive e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2024	Pakësime për detyrime të prapambetura gjate vitit 2025	Shtesa për detyrime të prapambetura gjatë vitit 2025	Vlera progresive e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2025
A	Detyrime për taksa/tarifa Lokale kategoria Biznes Bashkia Kolonjë	**9,955,983**	**7,635,348**	**1,896,390**	**10,187,719**
A.1	**Detyrime Kategoria Biznes Bashkia Kolonjë**	**9,192,313**	**518,985**	**1,674,859**	**9,307,647**
A.2	Kamatëvonesat mbi Detyrimet kategoria Biznes	763,670	34,452	131,781	763,670
A.1.1	Detyrimet Kategoria Biznes juridik	5,715,556	1,246,345	993,462	5,502,986
A.2.1	Kamatëvonesat mbi Detyrimet kategoria Biznes juridik	690,141	30,600	89,750	776,062
A.1.2	Detyrimet Kategoria Biznes Fizik	3,476,757	310,620	681,397	3,804,661

A.2.2	Kamatëvonesat mbi Detyrimet kategoria Biznes Fizik	73,529	42,031	42,873	116,402
B	**Institucione**	**1,132,091**	**200,360**	**160,240**	**1,143,059**
C	**Detyrimet për taksa/tarifa lokale kategoria Familjare, Njësitë Administrative**	**46,930,373**	**3,491,348**	**4,344,767**	**51,889,298**
C.1	Detyrimet për taksa/tarifa Familjare, NjA qendër	12,557,741	1,723,573	2,206,421	13,024,519
C.2	Detyrimet për taksa/tarifa Familjare, NjA MOLLAS	11,622,136	1,063,038	193,7904	12,462,755
C.3	Detyrimet për taksa/tarifa Familjare, NjA Barmash	2,027,344	248,391	510,733	2,316,588
C.4	Detyrimet për taksa/tarifa Familjare, NjA Navosel	2,929,512	210,045	579,346	3,306,189
C.5	Detyrimet për taksa/tarifa Familjare, NjA Çlirim	5,234,355	268,096	576,533	5,536,611
C.6	Detyrimet për taksa/tarifa Familjare, Nja qendër Leskovik	857,441	479,821	394,981	772,601
C.7	Detyrimet për taksa/tarifa Familjare, NJA Qyteti Leskovik	2,985,107	434,178	494,357	3,045,286
C.8	Detyrimet për taksa/tarifa Familjare, NJA Qyteti Erseke	8,714,737	1,147,278	3,850,410	11,424,749
D	**Detyrimet për Taksë ndërtese NJA. Ersekë**	**2,222,957**	**301,351**	**1,137,078**	2,786,498
E	**Detyrimet për, Tokë bujqësore NJA. Ersekë**	**161,462**	**12,395**	**50,645**	199,843
F	**Detyrimet për shfrytëzim Hapësira publike për qëllime biznese**	**234,790**	**-**	**12,320**	247,110
G	Detyrime Gjobat për kundra vajtje administrative	258,000	-	-	
H	**Detyrime Kontrata Qiraje Bashkia Kolonjë**	**10,777,566**	**2,500,313**	**1,150,596**	9,434,947
H.1	Detyrime Kontrata Qiraje për kategorinë Toka me Qira	368,427	135,072	251,516	491,969
H	Detyrime Kontrata Qiraje për kategorinë Kullota	92,100			92,100
H.3	Detyrime Kontrata Qiraje për kategorinë HEC	7,797,964	2,365,241	899,080	6,331,803
H.4	Detyrime Kontrata Qiraje për kategorinë tëlekom kontrata	1,583,700	-	-	1,583,700
H.5	Detyrime Kontrata Qiraje për kategorinë Kompania Plus	535,375	-	-	535,375
H.4.1	Detyrime kamatëvonesa për kategorinë kontrate qiraje tëlkom	400,000	-	-	400,000
	Totali	**71,671,222**	**10,145,804**	**14,736,423**	**75,900,866**

Burimi i të dhënave Bashkia Kolonjë

Nga auditimi i strukturës së detyrimeve të prapambetura u konstatua se Bashkia Kolonjë paraqet në fund të vitit 2025 detyrime progresive në vlerën 75,900,866 lekë, kundrejt 71,671,222 lekë në fund të vitit 2024, duke rezultuar një rritje neto prej 4,229,644 **l**ekë ose 5.9%**.** Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar ose pakësuar detyrime në vlerën 10,145,804 lekë**,** ndërsa janë krijuar detyrime të reja në vlerën 14,736,423 lekë, çka tregon se detyrimet e reja të krijuara kanë tejkaluar me 4,590,619 lekë detyrimet e arkëtuara, duke sjellë rritjen e stokut të përgjithshëm të borxhit.

Nga auditimi sipas kategorive u konstatua se peshën më të madhe e zënë detyrimet për taksa dhe tarifa familjare, të cilat në fund të vitit 2025 paraqiten në vlerën 51,889,298 lekë, duke përfaqësuar rreth 68.4% të totalit të detyrimeve të prapambetura. Krahasuar me vitin 2024, kjo kategori është rritur me 4,958,925 lekë ose 10.6%**,** pavarësisht se gjatë vitit janë arkëtuar 3,491,348 lekë detyrime të vjetra. Rritja lidhet me krijimin e detyrimeve të reja në vlerën 4,344,767 lekë**,** të cilat nuk janë shoqëruar me ritëm proporcional të arkëtimit. Brenda kësaj kategorie, nivelin më të lartë të detyrimeve e paraqet Njësia Administrative Qyteti Ersekë, me 11,424,749 lekë, ose rreth 22% të totalit të detyrimeve familjare, e ndjekur nga Njësia Administrative qendër me 13,024,519 lekë dhe Njësia Administrative Mollas me 12,462,755 lekë. Këto tre njësi administrative përfaqësojnë së bashku rreth 71% të të gjithë stokut të detyrimeve familjare, duke identifikuar zonat me riskun më të lartë të mos arkëtimit.

Detyrimet për taksa dhe tarifa të biznesit paraqiten në vlerën 10,187,719 lekë**,** me një rritje prej 231,736 lekë krahasuar me fundin e vitit 2024. Brenda tyre, detyrimet e biznesit juridik vijojnë të mbeten problematika kryesore, me një stok prej 5,502,986 lekë, ndërsa detyrimet e biznesit fizik arrijnë në 3,804,661 lekë. Po ashtu, kamatëvonesat mbi detyrimet e biznesit janë rritur nga 763,670 lekë në 892,464 lekë (776,062 lekë për biznesin juridik dhe 116,402 lekë për biznesin fizik), duke reflektuar zgjatjen në kohë të mos likuidimit të detyrimeve.

Një tjetër kategori me peshë të konsiderueshme janë **detyrimet nga kontratat e qirasë**, të cilat paraqiten në vlerën 9,434,947 lekë, ose rreth 12.4% të totalit të detyrimeve të prapambetura. Megjithëse gjatë vitit janë arkëtuar 2,500,313 lekë, stoku i detyrimeve mbetet i lartë. Peshën

kryesore e zënë kontratat e qirasë për HEC-et, me 6,331,803 lekë ose rreth 67.1% të totalit të detyrimeve nga qiratë. Gjithashtu, rezultojnë të pa mbledhura **detyrime nga operatorët e telekomunikacionit** në vlerën 1,583,700 lekë, kamatëvonesa përkatëse në vlerën 400,000 lekë, si dhe detyrime ndaj kategorive të tjera të qirasë së tokave dhe kullotave.
Detyrimet për taksën e ndërtesës në Njësinë Administrative Ersekë paraqiten në vlerën 2,786,498 lekë, me rritje prej 563,541 lekë **o**se 25.3% krahasuar me vitin 2024. Po kështu, detyrimet për tokën bujqësore janë rritur nga 161,462 lekë në 199,843 lekë, ndërsa detyrimet për shfrytëzimin e hapësirave publike janë rritur në 247,110 lekë. Ndërkohë, detyrimet nga gjobat për kundërvajtje administrative, të cilat në fund të vitit 2024 paraqiteshin në vlerën 258,000 lekë, rezultojnë të mbyllura ose të çregjistruara në fund të vitit 2025.

Konkluzion: Nga auditimi e strukturës së detyrimeve të prapambetura tregon se Bashkia Kolonjë ka një nivel të lartë të detyrimeve të pa mbledhura, të për qëndruara kryesisht në kategorinë e familjarëve, biznesit dhe kontratave të qirasë. Fakti që gjatë vitit 2025 detyrimet e reja të krijuara kanë tejkaluar me 45.2% vlerën e detyrimeve të arkëtuara konstatohet se masat e ndërmarra për mbledhjen e të ardhurave nuk kanë qenë të mjaftueshme për të ulur stokun ekzistues të borxhit. Kjo situatë ndikon negativisht në likuiditetin financiar të bashkisë, kufizon kapacitetin e saj për financimin e shërbimeve publike dhe investimeve, si dhe rrit riskun e mos arkëtimit për një pjesë të konsiderueshme të detyrimeve të akumuluara ndër vite.

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
z. E. J, Drejtor i DATTV Bashkia Kolonjë,
znj. L. K, z. F D, znj. E. I; Specialistë
z. J. Z, z. R. H. Inspektorë

2.3. Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025
2.3.1. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit
2.3.2 Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
2.3.3. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.
Në zbatim të Pikës nr. 3, të Programit të Auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.
Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.
Dokumentacioni i mbajtur mbi përllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve.
Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.
Dokumentacioni i mbajtur mbi realizimin e procesit të inventarizimit.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:
Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar; Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar; Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme "* i ndryshuar, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese;

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:
Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash flow).
Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
Pasqyrat statistikore:
Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Bashkia Kolonje ka në varësi dy institucione Klubi Sportiv *"GRAMOZI"* Ersekë me NIPT K48220011N dhe qendra Kulturore *"F. S. Noli"* Ersekë me NIPT K48220012V. Hartimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Kolonje kryhet duke përshirë bilancet e këtyre dy institucioneve.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të konsoliduar Bashkia Kolonje janë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë z. E. I. (Nëpunësi Autorizues) si dhe hartuesi i llogarive znj. G. D. (Nëpunësi zbatues) me shkresën nr.2267.prot., date 08.04.2026 dhe konfirmuar nga thesari datë 08.04.2026. Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimit financiar janë Akt rakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Kolonje të konfirmuara dhe nënshkruara nga Nëpunësi Zbatues znj. G. D. si dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Kolonje.
Të dhënat në lidhje me hartimin dhe depozitimin e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe pasqyrat financiare të Njësive Shpenzuese Bashkia Kolonje paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Tabela nr. 2/13: Të dhëna në lidhje me hartimin e pasqyrave financiare.

Nr.	Njësia shpenzuese	Titullari I Nj. Shpenzuese Nëpunësi autorizues	Shkresa e depozitimit në Degën e Thesarit Kolonje		Hartuesi i PF 2024 (Nëpunësi Zbatues)
			Nr. Prot.	Datë	
1	Bashkia Kolonje(qendra)	E. I.	2267	08.04.2026	G. D.

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit/përpunoi grupi i auditimit.

Pasqyrat financiare janë hartuar jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* pika 118. *"Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të*

juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit".

Konkluzion :Nga auditimi u konstatua që Pasqyrat Financiare janë hartuar dhe dërguar në Degën e Thesarit Kolonje me shkresën nr.2267.prot., date 08.04.2026 dhe konfirmuar nga thesari datë 08.04.2026 jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, *"Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* pika 118.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:
Znj: G D Drejtor i Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit.

2.3.1. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit
Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, arkën, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj., të cilat mbahen dhe përpunohen në format Excel.
Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;
Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin e rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Qasja dhe metodologjia e auditimit.
Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2025 ka marrë në konsideratë vlerën e precizonit 10,588 mijë lekë për shpenzimet
Bazuar në vlerën e materialitetit të përllogaritur prej 10,588 mijë lekë nga ana e grupit të auditimit u krye verifikimi me zgjedhje për urdhër shpenzimet e periudhës 01.01.2025 deri në 31.12.2025.
Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik"* për regjistrimin e veprimeve ekonomike në

librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

2.3.3.Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2025:

A. AKTIVET

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nën zërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ,gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2025, të pozicionit financiar të Bashkisë Kolonje, formati nr. 1 është paraqitur më poshtë:

1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).
- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 3,044,988,672 lekë.
- Aktivet 3,174,454,803 lekë
- Detyrimet 129,466,131 lekë
- Aktivet Neto 3,044,988,672 lekë

Aktivet afatshkurtra:
Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën 247,335,825 lekë dhe përbëhen nga:
- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 59,951,463 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 68,937,585 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 118,446,777 lekë

Te dhënat në lidhje me paraqitjen e pasqyrës se pozicionit financiar paraqiten në mënyre të përmbledhur si me poshtë vijon:

Tabela 2/14:Aktivet e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar

Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Totali 2025	Ushtrimi I Mbyllur 2024
A	A K T I V E T	3,174,454,803	3,185,331,723
	I. Aktivet Afat shkurtra	247,335,825	226,665,999
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	59,951,463	41,439,132
531	Mjetë monetare në Arke		
512,56	Mjete monetare në Banke		
520	Disponibilitete në Thesar	59,349,003	40,719,292
50	Letra me vlere	602,460	719,840
532	Vlera të tjera		
54	Akreditiva dhe paradhënie		
59	Provigjonë zhvlerësimi letra me vlere (-)		
	2.Gjendje Inventari qarkullues	68,937,585	59,741,627
31	Materiale	5,401,968	5,317,216
32	Inventar I imët	63,535,617	54,424,411
33	Prodhim në proces		
34	Produkte		

35	Mallra		
36	Kafshe në rritje e majmëri		
37	Gjendje të pa mbërritura ose pranë të treteve		
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		
39	Provigjonë për zhvlerësimin e inventarit (-)		
	3.Llogari të Arketushme	118,446,777	125,485,240
411	Klientë e llogari të ngjashme	1,872	1,872
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	5,926,640	5,357,186
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqësi natyrore që mbulohen nga shteti		
435	Sigurime Shoqërore		
436	Sigurime Shëndetësorë		
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore		
44	Institucione të tjera publike		
465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitorë të ndryshëm	75,934,838	71,705,194
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	36,583,427	48,420,988
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes të marrëdhënieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime për t'u shpërndare në disa ushtrime		
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme		

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

1. Llogaritë e klasës 5 *"Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre"* paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën 59,951,463 lekë dhe përbëhen nga:

Tabela nr.2/15: Llogaritë e klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre". Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Ndryshimi
520	Disponibilitete në Thesar	59,349,003	40,719,292	18,629,711
50	Letra me vlere	602,460	719,840	-117,380

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar u konstatua që llogaria (520) "Disponibilitete në thesar" është paraqitur në fund të të vitit 2025 në shumën 59,349,003 lekë. .Teprica e llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar"* duhet të rakordoje me akt rakordimet me thesarin për gjendjen fondeve të pa përdorura që ndodhen në thesar si dhe gjendjen në thesar të llogarisë 466 *"Kreditorë në ruajtje"*. Nga auditimi i të dhënave të akt rakodimeve me thesarin u konstatua që fonde të pa përdorura sipas rakordimit me thesarin me date 31.12.2025 janë në vlerën 48,932,109 lekë dhe llogaria 466 *"Kreditorë në ruajtje"* sipas pasqyrës se pozicionit financiar është në vlerën 10,416,894 lekë. Totali i fondeve të pa përdorura plus llogaria 466 *"Kreditorë në ruajtje"* (48,932,109 lekë + 10,416,894 lekë) është e barabarte me llogarinë (520) *"Disponibilitete në thesar"* e cila paraqitet me 31.12.2025 në vlerën 59,349,003 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 u konstatua se "*Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor"* është paraqitur në vlerën 48,932,109 lekë vlere e cila nuk përputhet me llogarinë 520 *"Disponibilitete në thesar"* e cila është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar. në fund të të vitit 2025 në shumën 59,349,003 lekë .

"Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" në pasqyrën e aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 është paraqitur në mënyre të pa sakte për vlerën 10,416,894 lekë (59,349,003 lekë-48,932,109 lekë)
Nga auditimi i pasqyrës të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 u konstatua se *"Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente"* është paraqitur në vlerën 469,605,393 lekë ndërsa sipas situacionit të shpenzimeve të thesarit shpenzime korente janë në vlerën 486,299,848 lekë ose janë paraqitur në pasqyrën Cash flow 16,694,455 lekë me pak. të dhënat e situacionit të shpenzimeve sipas thesarit për "*Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente"* janë si me poshtë vijon:

Tabela 2/16:Shpeznimet buxhetore sipas akt rakordimit me thesarin

Llogaria ekonomike	Emërtimi i llogarisë	Buxheti faktik 2025
600	"Pagat dhe përfitimet e punonjësve".	245,745,991
601	"Kontribute për sigurimet shoqërore e shëndetësore"	40,491,486
602	"Blerje mallrash e shërbimesh të tjera"	105,787,498
604	"Transferime korrente të brendshme".	2,692,980
606	"Transferta për buxhetet familjare dhe individët"	90,456,893
466	Pagesa për mjete në ruajtje	1,125,000
Totali		486,299,848

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Konstatohet që pagesa të llogarisë 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* sipas pasqyrës të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 janë paraqitur në vlerën zero lekë ndërsa sipas situacionit të shpenzimeve të thesarit shpenzime për investime janë në vlerën 39,594,341 lekë ose janë paraqitur me pak në pasqyrën e flukseve monetare Cash flow në vlerën 39,594,341 lekë. Nga auditimi i akordimeve të fondeve buxhetore u konstatua që fonde të akordura për vitin 2025 dhe të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën 537,278,948 lekë nga të cilat taksa dhe tarifa vendore janë në vlerën 70,542,847 lekë. Konstatohet që në pasqyrën të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 janë paraqitur akordim fondesh në total 518,537,502 lekë ose 18,741,446 lekë me pak. Akordimi i fondeve për vitin 2025 paraqiten në Aneksin 3/1 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit :
Paraqitja në mënyre të pasakte i të dhënave të likuiditeteve për vitin 2025 sipas pasqyrës të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 nuk jep siguri për lëvizjen e likuiditeteve gjate vitit ushtrimor 2025..

Konkluzion: Nga auditimi i pasqyrës të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 u konstatua se *"Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor"* është paraqitur në vlerën 48,932,109 lekë vlere e cila nuk përputhet me llogarinë 520 *"Disponibilitete në thesar"* e cila është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të të vitit 2025 në shumën 59,349,003 lekë. Konstatohet që pagesa të llogarisë 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* sipas pasqyrës të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 janë paraqitur në vlerën zero lekë ndërsa sipas situacionit të shpenzimeve të thesarit shpenzime për investime janë në vlerën 39,594,341 lekë ose janë paraqitur me pak në pasqyrën e flukseve monetare Cash flow në vlerën 39,594,341 lekë. *"Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente"* është paraqitur në vlerën 469,605,393 lekë në pasqyrën Cash flow ndërsa sipas situacionit të shpenzimeve të thesarit shpenzime korente janë 486,299,848 lekë ose janë paraqitur në pasqyrën Cash flow 16,694,455 lekë me pak. Nga auditimi i akordimeve të fondeve buxhetore u konstatua që fonde të akordura

për vitin 2025 dhe të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën 537,278,948 lekë nga të cilat taksa dhe tarifa vendore janë në vlerën 70,542,847 lekë. Konstatohet që në pasqyrën të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 janë paraqitur akordim fondesh në total 518,537,502 lekë ose 18,741,446 lekë me pak. Paraqitja në mënyre të pasakte i të dhënave të likuiditeteve për vitin 2025 sipas pasqyrës të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 nuk jep siguri për lëvizjen e likuiditeteve gjate vitit ushtrimor 2025.
Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.
"Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: *Këto pasqyra iu dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*
Pika 50. "Tepricat e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt akordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt akordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës se të ardhurave të trashëguara (te ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)
Aneksi 2 pasqyra nr. 5. Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare vjetore të njësisë raportuese pika 14*."Shpjegimet për pasqyrat financiare duhet të përfshijnë përshkrime të shkurtra ose analiza më të detajuara për vlera të treguara në pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e flukseve monetare (Cash flow), pasqyrën e ndryshimeve në aktivet/fondet neto, ashtu si edhe informacion i detajuar për detyrimet financiare.*
Në vijim jepen zërat e pasqyrave financiare që duhet të jenë pjesë e shënimeve shpjeguese, por çdo njësi raportuese mund të përfshije informacion shtesë për zëra materiale që ndihmojnë përdoruesit në kuptimin e pasqyrave financiare.
Pika 26. "Konfirmoni që shumat e paraqitura në pasqyrën e flukseve monetare (CASH FLOW) dhe paragrafin 26 më poshtë, janë të rakorduara me situacionet e pagesave dhe arkëtimeve, si dhe me situacionet e zbatimit të buxhetit të Thesarit, gjeneruar në SIFQ".

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 50 *"Letra me vlere "* më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 602,460 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 620,460 lekë e pa ndryshuar nga viti i kaluar. Gjendja e kësaj llogarie përfaqëson letrat me vlerë të Gjendjes Civile dhe blloqe biletarie për ushtrim aktiviteti tregtar.

Llogaritë e klasës 3 *"Gjendje inventari qarkullues"* në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 68,937,585 lekë përbëhet nga:

Tabela nr.2/17: Llogaritë e klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues". Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi I llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Ndryshimi
31	Materiale	5,401,868	5,317,216	84,652
32	Inventar i imët	63,535,617	54,424,411	9,111,206
Totali		68,937,485	59,741,627	9,195,858

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2025, paraqitet në vlerën 68,937,485 lekë dhe përbëhen nga; llogaria kontabël 31 *"Materiale"* në vlerën 5,401,868 lekë; llogaria 32 "Inventar i imët" 63,535,617 lekë.

- Llogaria 31 "Materiale", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 5,401,968 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr.2/18: Llogaria 31 *"Materiale"* Lekë

Llogaria 31 "Materiale"	
Çelje e vitit 2025	5,317,216
Shtesa (D)	46,319,807
Pakësime (K)	46,235,055
Gjendja debitorë në 31.12.2025	5,401,968

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

- Llogaria 32 "Inventar i imët", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 63,535,617 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr.2/19: Llogaria 32 *"Inventar i imët"* /lekë

Llogaria 32 "Inventar i imët"	
Çelje e vitit 2025	54,424,411
Shtesa (D)	18,282,623
Pakësime (K)	9,171,417
Gjendja debitorë në 31.12.2025	63,535,617

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjeve të inventarit"* dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".*

Llogaritë e Klasës 4 *"Llogari të arkëtueshme"* në fund të vitit 2025 paraqiten në vlerën 118,446,777 lekë me një ndryshim në pakësim nga viti i kaluar në vlerën 7,083,463 lekë.

Tabela nr.2/20: Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme"

	Llogari të Arkëtushme	2025	2024	Ndryshimi
Llogaria	Emërtimi i llogarisë	118,446,777	125,485,240	7,038,463
411	Klientë e llogari të ngjashme	1,872	1,872	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	5,926,640	5,357,186	-569,454
468	Debitorë të ndryshëm	75,934,838	71,705,194	-4,229,644
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	36,583,427	48,420,988	11,837,561

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Llogaria 411 *"Klientë e llogari të ngjashme"* është në vlerën 1,872 lekë

Llogaria 423-429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën 5,926,640 lekë dhe është shtuar krahasuar me vitin 2024 në vlerën 569,454 lekë. Vlera prej 5,926,640 përfaqëson detyrime të 32 individëve dhe subjekteve për gjoba policie dhe gjoba IMT në vlerën 4,580,500 lekë detyrime të personelit të Bashkisë për gjoba dhe detyrime të KLSH për 18 punonjës në vlerën 1,187,986 lekë dhe detyrimet në vlerën 178,277 lekë të qendrës kulturore Fan Noli për 25 punonjës në vlerën 178,277 lekë. Detyrime të 32 individëve dhe subjekteve për gjoba policie dhe gjoba IMT në vlerën 4,580,500 lekë është keq klasifikuar në llogarinë 423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" pasi duhej të klasifikohej në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"*. të dhëna të përmbledhura për detyrimet e 32 individëve dhe subjekteve në vlerën 4,580,500 lekë paraqiten në mënyre të përmbledhur në Aneksin nr. 3/2 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit:

- Llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm"*, më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 75,934,838 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr.2/21: Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"/lekë

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2025	71,705,194
Shtesa (K)	4,229,644
Pakësime (D)	-
Gjendja debitorë në 31.12.2025	75,934,838

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Tabela nr.2/22: Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" sipas njësive /lekë

Debitorë subjekte dhe individë	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Debitorë Q. Kulturore "F.S.Noli"	20,123	-	-	20,123
Debitorë K.S Gramozi	13,849	-	-	13,849
Debitorë Bashkia Kolonjë	71,671,222	14,871,928	10,642,284	7,590,0866
Totali	71,705,194	14,871,928	10,642,284	75,934,838

. Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit.

Nga auditimi i llogarisë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* rezulton se:-Në fillim të vitit 2024 paraqitet në shumën 71,705,194 lekë, ndërsa në fund të vitit 2025 në shumën prej 75,934,838 lekë. Gjatë vitit 2025 shtesa prej 4,229,644 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Kolonje dhe Njësive vartëse.
Drejtoria e të Ardhurave ka dërguar për kontabilizim pranë Drejtorisë se Financës me shkresën nr.1227.prot., date 18.02.2026 listën e debitorëve për Taksat dhe Tarifat Vendore të periudhës 2011-2025,bashkengjitur shkresës Tabela analitike sipas njësive administrative në vlere debitorë në fund të vitit 2025 për shumen 75,900,866 lekë.
Nga sa trajtuam më sipër rezulton se llogaria 468 (debitorë të ndryshëm) në fund të vitit 2025 nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Bashkisë Kolonje. Detyrime të 32 individëve dhe subjekteve për gjoba policie dhe gjoba IMT në vlerën 4,580,500 lekë është keq klasifikuar në llogarinë 423-429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* dhe duhej të klasifikohej në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* Veprime në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë*

e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj,

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Llogaria 4342 *"Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"*, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 36,583,427 lekë dhe kuadro me Llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* të Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 36,583,427 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:
Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela nr.2/23 Detajet e nën rubrikës "Të tjera operacione me shtetin"/lekë

Emërtimi i llogarive	2025	2024
Furnitorë dhe llogari të lidhura me to (401-408)	7,326,934	11,679,257
Detyrime ndaj personelit për pagat dhjetor (42)	15,959,310	16,362,886
Detyrime ndaj shteti për tatim page (431)	1,658,136	1,608,414
Detyrime ndaj sigurimeve shoqërore për dhjetor (435)	4,932,470	4,983,681
Detyrime për sigurime shëndetësore (436)	677,879	695,992
Kreditore të ndryshëm (467)	6,028,698	13,090,758
Totali	36,583,427	48,420,988

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Nga të dhënat e vena në dispozicion nga Drejtoria e Financës gjendja e llogarisë në fillim të vitit është në vlerën 48,420,988 lekë është shtuar për vlerën 7,322,779 lekë dhe është pakësuar 19,160,340 lekë dhe ngelet me teprice në fund të vitit 2025 në vlerën 36,583,427 lekë. Paraqitja në mënyre të përmbledhur paraqitet si me poshtë vijon:

Tabela nr.2/24: Detajet e nën rubrikës "Të tjera operacione me shtetin" shtesa pakesime/lekë

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"	
Çelje e vitit 2025	48,420,988
Shtesa (K)	7,322,779
Pakësime (D)	19,160,340
Gjendja debitorë në 31.12.2025	36,583,427

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

II. AKTIVET AFAT GJATA

Aktivet afatgjata në fund të vitit 2025 paraqiten në vlerën 2,927,118,978 lekë dhe përbehen nga llogaritë e klasës 20 "Aktive afatgjata jo materiale" në vlerën 14,427,354 lekë ;llogaria 21 "Aktive afatgjata materiale" në vlerën 2,837,933,959 lekë, 25-26 "Aktive afatgjata financiare" zero lekë dhe 23 "Investime në proces" në vlerën 74,757,66 lekë. Në mënyre të përmbledhur paraqiten në Aneksin nr.3/3 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

1. Aktivet Afatgjata Jo materiale.

-Llogaria 202 *"Studime dhe kërkime"* më datë 01.01.2025, ka qenë në vlerën 15,871,693 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,730,000 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 3,174,339 dhe më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 14,427,354 lekë. Analiza e lëvizjes së llogarisë për periudhën në auditim paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.2/25: Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”. Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	35,427,606
	2	Amortizim i akumuluar	19,555,813
	3	Gjendja në 01.01.2025	15,871,693
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	1,730,000
	5	Amortizim shtesë	3,174,339
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	
	7	Amortizim nga pakësimet	
	4	Kosto historike	37,157,606
	5	Amortizim i akumuluar	22,730,252
	6	Gjendja më datë 31.12.2025	14,427,354

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Referuar regjistrit të aktiveve të Bashkisë Kolonjë në mbajtur në formatin Excel, llogaria 202 *“Studime dhe Kërkime”* nuk është mbajtur në mënyrë analitike për çdo projekt sipas vitit të hyrjes, vlerës së blerjes, por projektet e çdo viti janë bashkuar në një zë.
Regjistrimi i mësipërm i projekteve jo në mënyrë analitike do të ndikoj në kontabilizimin e AAGJM në momentin e përfundimit sepse aktivit të përfunduar i bashkëngjitet dhe vlera e projektit.
Konstatohet që janë 17 projekte investimesh në vlerën 37,157,606 lekë(kosto historike) që janë të përfshirë në llogarinë 202 *“Studime dhe kërkime”*. Duke qenë që shumica e tyre i përkasin periudhave të hershme para vitit 2025, nuk ka informacion të saktë nëse këto investime janë kryer, objektet kanë përfunduar ose jo. Vlera e mësipërme nuk duhej të paraqitej në llogaria 202 *“Studime dhe kërkime”* në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2025, por vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e investimit. Kjo ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, *“Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”* i ndryshuar, Kreu II “*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, Aneksi 1 *“Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”* pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5.
Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi:
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

3. Aktivet Afatgjata Materiale

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 3,330,850 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa/pakësime, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,330,850 lekë. Analiza e lëvizjes së llogarisë për periudhën në auditim paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.2/26: Llogaria 210 *"Toka, troje, terrene"*/ Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 210 "Toka, troje, terrene "Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	3,330,850
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2025	3,330,850
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0
	5	Amortizim shtesë	0
	6	Pakësimi gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	3,330,850
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	Gjendja më datë 31.12.2025	3,330,850

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2024 dhe për këtë llogari nuk disponohet inventar kontabël dhe inventar fizik. Vlera e paraqitur në bilanc nuk është e analizuar analitikisht, por mbartet vetëm si vlerë e trashëguar ndër vite. Nga auditimi i llogarisë 210 *"Toka, Troje, terrene"* ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë

Veprime këto në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu III, pika 30 *"Çdo njësi e qeverisjes se përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi ketë baze, në kontabilitet, behën veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet".*

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 25,909,872 lekë(vlera e mbetur). Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa as pakesime, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 25,909,872 lekë. Analiza e lëvizjes së llogarisë për periudhën në auditim paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.2/27: Llogaria 211 *"Pyje, kullota, plantacione"*/Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	25,909,872
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2025	25,909,872
	4	Shtesa gjatë vitit 2024	0
	5	Amortizim shtesë	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	25,909,872
	5	Amortizim i akumuluar	0

	6	Gjendja më datë 31.12.2025	25,909,872

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik. Vlera e paraqitur në bilanc nuk është e analizuar në mënyrë analitike por mbartet vetëm si vlerë e trashëguar ndër vite.
Nga auditimi i llogarisë 211 *"Pyje, Kullota, Plantacione"* ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Veprime këto në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu III, pika 30 *"Çdo njësi e qeverisjes se përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë baze, në kontabilitet, behën veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet".*

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në datë 01.01.2025, ka qenë në vlerën 526,824,605 lekë(vlera e mbetur) në pasqyrën e pozicionit financiar. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 9,255,766 lekë dhe pakesime 11,934,793 lekë dhe amortizim të vitit në vlerën 26,341,230 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 497,804,348 lekë. Analiza e lëvizjes së llogarisë për periudhën në auditim paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.2/28. Llogaria 212 *"Ndërtesa e konstruksione"*./Lekë

		Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"	
Referenca	Nr.	Objekte inventari	
	1	Kosto historike	770,421,644
	2	Amortizim i akumuluar	243,597,039
Ditari i veprimeve	3	Gjendja në 01.01.2025	526,824,605
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	9,255,766
	5	Amortizim shtesë	26,341,230
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	11,934,793
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	767,742,617
	5	Amortizim i akumuluar	269,938,269
	6	Gjendja më datë 31.12.2025	497,804,348

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

- Llogaria 212 *"Ndërtesa e konstruksione"*, më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 767,354,127 lekë me kosto historike . Nga të dhënat e vena në dispozicion nga Drejtoria e Financës analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në Aneksin nr.3/4 bashkëngjitur raportit përfundimtar te auditimit:

Nga të dhënat e regjistrit elektronik të aktiveve i paraqitur në tabelën në vijim u konstatua që të dhënat e aktive për ndërtesat nuk janë të plota sipas objekteve por me emërtime të përgjithshme ku një objekt përsëritet disa here me vlera të ndryshme në baze të vlerave të investimeve dhe nuk identifikohet si një objekt i tëre duke ju shtuar vlerat specifike të kryera për objektin. Konstatohet që regjistri i aktiveve për Llogaria 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* është i pa plote dhe i pa përditësuar. të dhënat e regjistrit të aktiveve të llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* paraqitet në Aneksin nr.3/5 bashkëngjitur raportit përfundimtar te auditimit:
Kapitalizimi për vitin 2025 në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* është në vlerën 9,255,766 lekë për objektet si më poshtë:
-Vendosje dyer-dritare Kopshti "Marie Gjergo" (shtesa 8,961,732 lekë)
-Mbikëqyrje kolaudim objektesh 294,034 lekë
Pakësimi për vitin 2025 në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* është në vlerën 11,934,793 i Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara që i përket keq klasifikimit të paraqitur në vitin 2024 për të cilën gjate vitit 2025 janë kryer veprimet rregulluese:

Llogaria 212 *" Ndërtesa dhe konstruksione"*. Referuar auditimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion për vitin 2025 Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë nuk disponon një regjistër të përditësuar të ndërtesave në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*,. Referuar udhëzimit nr. 30 pika 26 dhe 27 si më poshtë:

26.Cdo njësi publike duhet të krijoje dhe të përditësoje një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshire dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.
27.Nënpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit.
28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* në datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 2,262,377,103 lekë (vlerë e mbetur). Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 15,233,939 lekë. Llogaria 213 gjatë vitit 2025 është pakësuar vetëm nga amortizimi i vitit në vlerën 45,247,542 lekë. Gjendja e kësaj llogarie në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 2,232,363,500 lekë. Analiza e lëvizjes së llogarisë për periudhën në auditim paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.2/29: Llogaria 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"*./Lekë

		Llogaria 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"*	
Referenca	Nr.	Objekte inventari	
	1	Kosto historike	2,793,731,055
	2	Amortizim i akumuluar	531,353,952
Ditari i veprimeve	3	Gjendja në 01.01.2025	2,262,377,103
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	15,233,939
	5	Amortizim shtesë	45,247,542
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	

	7	Amortizim nga pakësimet	
	4	Kosto historike	2,808,964,994
	5	Amortizim i akumuluar	576,601,494
	6	Gjendja më datë 31.12.2025	2,232,363,500

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Nga auditimi i të dhënave të kontabilitetit dhe dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit u konstatua se për vlerën neto të kontabilizuar në llogarinë 213 "Rrugë , rrjete, vepra ujore" në shumën 2,262,377,103 lekë dhe vlerën historike prej 2,808,964,994 nuk disponohet nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit një regjistër të azhornuar për vlerat analitike sipas çdo aktivi nuk mund të japim një opinion për këtë vlerë. Të dhënat e regjistrit të llogarisë 213 *"Rrugë , rrjete, vepra ujore"* paraqiten në Aneksin nr.3/6 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga auditimi u konstatua që Llogaria 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* për 12 objekte në vlere 181,421,376 lekë është e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike se çfarë objekti i përkasin . Mungon informacioni për vlerën e objekteve 390,032,461 lekë për numrin e objekteve dhe detajimin përkatës të tyre. të analizuara pjesërisht paraqiten vlera prej 2,222,277,217 lekë pasi kontabilizimi në llogarinë 213 *"Rrugë, Rrjete, Vepra ujore"* mbikëqyrjet e punimeve dhe super vizimet e objekteve janë regjistruar në llogari analitike të ndara dhe jo duke ju bashkuar objektit të investimit (2,793,731,055 - 390,032,461-181,421,376)

Konkluzion: Nga auditimi i të dhënave për gjendjen e llogarisë 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* u konstatua që kjo llogari paraqitet në fund të vitit 2025 me vlere historike 2,793,731,055 lekë. Nga analiza e kryer për gjendjen e kësaj llogarie u konstatua që për vlerën prej 390,032,461 lekë nuk ka të dhëna në lidhje me identifikimin e objekteve në regjistër të aktiveve . Për 12 objekte me vlere 181,421,376 lekë është e pa analizuar në kontabilitet çfarë objektesh i përkasin. të analizuara pjesërisht paraqiten vlera prej 2,222,277,217 lekë (2,793,731,055 - 390,032,461-181,421,376) pasi kontabilizimi në llogarinë 213 *"Rrugë, Rrjete, Vepra ujore"* mbikëqyrjet e punimeve dhe super vizimet e objekteve janë regjistruar në llogari analitike të ndara dhe jo duke ju bashkuar objektit të investimit. Llogaria 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* është e pa analizuar si në kontabilitet ashtu edhe në gjendjen fizikë ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime në mos përputhje me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, pika 26 dhe 27 ,28 në të cilin citohet:

"26.Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në forme të sintetizuar.

27.Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës se institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit.28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital."

Shtesat e vitit 2024 në vlerën 15,233,939 lekë, sipas Njësive Shpenzuese dhe objekteve paraqiten në Aneksin nr.3/7 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga auditimi i llogarisë 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* konstatohet se, shuma e shtesës prej 15,233,939 lekë i përket objekteve të marra në dorëzim gjatë vitit 2025 të investimeve të mëparshme dhe investimeve të kryera gjatë vitit 2025,

Nga auditimi i llogarisë 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* konstatohet nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat për identifikimin e objekteve të ujësjellësve të cilët ndodhen në asetet e Bashkisë Kolonjë si dhe nuk janë marre masa për transferimin e Aseteve të ujësjellësit në *"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçe Sha"* me NIPT M24431001N në mospërputhje me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"* kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.
Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë"* në datën 01.01.2025, paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 45,617,720 lekë (vlerë e mbetur). Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 18,687,393 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 9,153,796 lekë, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 55,151,317 lekë vlere e mbetur në pasqyrën e pozicionit financiar. Analiza e lëvizjes së llogarisë për periudhën në auditim paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr:2/30: Llogaria *214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë".*/ Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë"*, Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	156,828,315
	2	Amortizim i akumuluar	111,210,595
	3	Gjendja në 01.01.2025	45,617,720
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	18,687,393
	5	Amortizim shtesë	9,153,796
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	
	7	Amortizim nga pakësimet	
	4	Kosto historike	175,515,708
	5	Amortizim i akumuluar	120,364,391
	6	Gjendja më datë 31.12.2025	55,151,317

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Shtesat dhe paksimet e vitit 2024 sipas njësive administrative, të detajuara, paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr.2/31: Llogaria 214 "*Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë"* shtesa pakesime/Lekë

Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë (kosto historike) / Objekte inventari	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Bashkia Ersekë	169,636,088	18,687,393		150,948,695
Nj.Adm Ersekë	55,644	-		55,644

Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë (kosto historike) Objekte inventari	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Nj.Adm.Çlirim	301,969	-		301,969
Nj.Adm Mollas	1,085,061	-		1,085,061
Nj.Adm.Novoselë	-	-		-
Nj.Adm Barmash	(10,500)	-		(10,500)
Nj. Qendër Leskovik	1,238,160	-		1,238,160
Nj.Adm Leskovik	19,841,763	-		19,841,763
Bordi i kullimit	1,317,330	-		1,317,330
PMNZH	176,555	-		176,555
Totali	156,769,284	18,687,393		175,456,677

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Nga të dhënat e vena në dispozicion nga Drejtoria e financës dhe Buxhetit u konstatua që regjistri i aktiveve për Llogarinë 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë"* në mënyre të përmbledhur makineri pajisje dhe vegla punë në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Kolonjë .Sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2025 paraqitet me vlerë neto kontabël 55,151,317 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar. Sipas të dhënave të regjistrit elektronik të aktiveve kjo llogari paraqitet në Aneksin nr:3/8 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.
Bashkia Kolonjë gjatë vitit 2025 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit materiale "Sistem sigurie dhe rrjeti I brendshëm kompjuterik" me vlere 456,000 lekë. Blerje pajisje kompjuterike në vlerën 2,490,025 lekë Blerje pa pagesë gjatë vitit 2024 janë në vlerën 15,741,368 lekë të përbëra nga Laboratorë nga Drejtoria Arsimore dhurate në vlerën 15,721,368 lekë dhe Piktura në vlere 20,000 lekë.

Tabela nr.2/32: Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë" shtesa pakesime /lekë

NR	EMERTIMI	Viti I hyrjes	Shtesa të dhuruara	Shtesa të blera	Totali I shtesës
1	Sistem sigurie dhe rrjeti I brendshëm kompjuterik	2,025		456,000	456,000
2	Blerje pajisje kompjuterike	2,025		2,490,025	2,490,025
3	Laboratorë Dr. Arsimore	2,025	15,721,368		15,721,368
4	Piktura	2,025	20,000		20,000
TOTALI			15,741,368	2,946,025	18,687,393

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Nga auditimi u konstatua që me shkresën nr.190.prot .,date 15.04.2025 protokolluar në Bashkinë Kolonje me nr.1971.prot., date 22.04.2025 Drejtoria e Rajonale e Arsimit para universitar Korçe ka transferuar Laboratorë shkollor me vlere totale sipas kartelave 15,721,368 lekë.
Nga auditimi i llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë"* u konstatua që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë kolonje nuk disponon të dhëna të sakta analitike të llogarisë për vitin e krijimit të shtesës se llogarisë si dhe ka ndryshim midis të dhënave sipas regjistrit me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b. Sipas regjistrit të aktiveve vlera e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë" në fund të vitit 2025 është në shumen 194,164,070 lekë (175,476,677 + 15,741,368 + 2,946,025) ndërsa sipas Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b vlera e llogarisë është 175,515,708 lekë ose me një ndryshim prej 18,648,362 lekësh pasqyruar me pak në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b.

Veprime në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 215 *"Mjete transporti"* më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 17,605,862 lekë(vlerë e mbetur) në pasqyrën e pozicionit financiar. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 522,083 lekë dhe amortizim vjetor në vlerën 2,640,879 lekë, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar paraqitet në vlerën 15,487,066 lekë. Analiza e lëvizjes së llogarisë për periudhën në auditim paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.2/33: Llogaria 215 *"Mjete transporti"*/ Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 215 "Mjete transporti"	
		Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	133,540,547
	2	Amortizim i akumuluar	115,934,685
	3	Gjendja në 01.01.2025	17,605,862
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	522,033
	5	Amortizim shtesë	2,640,879
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	
	7	Amortizim nga pakësimet	
	4	Kosto historike	134,062,630
	5	Amortizim i akumuluar	118,575,564
	6	Gjendja më datë 31.12.2025	15,487,066

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Shtesat dhe paksimet e vitit 2025 sipas njësive administrative , të detajuara, paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr.2/34: Llogaria 215 *"Mjete transporti*" shtesa pakesime/ Lekë

Mjete transporti (kosto historike) Objekte inventari	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Bashkia Ersekë	43,189,028	522,083	-	43,711,111
Nj.Adm Ersekë	27,702,352	-	-	27,702,352
Nj.Adm.Çlirim	-	-	-	-
Nj.Adm Mollas	1,300,000	-	-	1,300,000
Nj.Adm.Novoselë	395,000	-	-	395,000
Nj.Adm Barmash	399,000	-	-	399,000
Nj. Qendër Leskovik	26,245,182	-	-	26,245,182
Nj.Adm Leskovik	12,829,984	-	-	12,829,984
Makineri PMZHN	181,400	-	-	181,400
Makineri Ndër RR. Rurale	-	-	-	-
Totali	112,241,946	522,083	-	112,764,029

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Nga të dhënat e vena në dispozicion nga Drejtoria e financës dhe Buxhetit u konstatua që regjistri i aktiveve për llogarinë 215 *"Mjete transporti"* në mënyre të përmbledhur përmban mjetet e transportit të Bashkisë Kolonjë .Sipas pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë gjendja e llogarisë 215 "Mjete transporti" më datë 31.12.2025 paraqitet me vlerë neto kontabël 15,487,066 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar. Sipas të dhënave të regjistrit elektronik të aktiveve kjo llogari paraqitet në Aneksin nr.3/9 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga auditimi i llogarisë 215 *"Mjete transporti"* u konstatua që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë kolonje nuk disponon të dhëna të sakta analitike të llogarisë për vitin e krijimit të shtesës se llogarisë si dhe ka ndryshim midis të dhënave sipas regjistrit me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b. Sipas regjistrit të aktiveve vlera e llogarisë 215 *"Mjete transporti"* është në shumen 112,764,029 lekë (112,241,946 + 522,083) lekë ndërsa sipas Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b është 134,062,630 lekë ose me një ndryshim prej 21,298,601 lekësh e paraqitur me shume në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b rrjedhimisht për vlerën 21,298,601 lekësh nuk disponon informacion për gjendjen e saj kontabël analitike.
Për vitin 2025 shtesa në vlerën 522,083 lekë përbehet nga dhurimi i 2 mjeteve zjarrfikëse nga Bashkia Korçe me shkresën nr.7171.prot., date 22.07.2025 përkatësish të markës denis në vlere 276,997 lekë dhe Skoda 245,086 lekë.
Veprime në mospërputhje UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 218 *"Inventar ekonomik"* më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 8,858,758 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar. Gjatë vitit 2025 nuk ka pasur shtesa dhe pakesime . Amortizimi vjetor i llogaritur është në vlerën 1,971,751 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 7,887,006 lekë. Në mënyrë të përmbledhur, analiza e lëvizjes së llogarisë për periudhën në auditim paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.2/35: Llogaria 218 "Inventar ekonomik"/ Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 218 "Inventar ekonomik"	
		Objekte inventari	
	1	Kosto historike	65,171,094
	2	Amortizim i akumuluar	55,312,336
Ditari i veprimeve	3	Gjendja në 01.01.2025	9,858,758
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	
	5	Amortizim shtesë	1,971,751
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	
	7	Amortizim nga pakësimet	
	4	Kosto historike	65,171,094
	5	Amortizim i akumuluar	57,284,087
	6	Gjendja më datë 31.12.2025	7,887,008

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Gjendja kontabël sipas njësive administrative, të detajuara, paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr.2/36: Llogaria 218 "*Inventar ekonomik"* sipas njësive/ Lekë

NR	EMERTIMI	Vlera fillestare
1	Bashkia Ersekë	44,503,322
2	NJ.A. Qendër Ersekë	4,744,294
3	NJ.A. Çlirim	1,143,845
4	NJ.A. Mollas	3,337,854
5	NJ.A. Novoselë	713,861
6	NJ.A. Barmash	1,603,168
7	NJ.A. Qendër Leskovik	331,800
8	NJ.A. Leskovik	5,430,946
9	Inv Eko Nder.Rr.Rrurale	73,400
	TOTALI llogaria 218	61,882,490

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Nga auditimi i llogarisë 218 *"Inventar ekonomik"* u konstatua që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë kolonje nuk disponon të dhëna të sakta analitike të llogarisë për vitin e krijimit të shtesës se llogarisë si dhe ka ndryshim midis të dhënave sipas regjistrit me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b. Sipas regjistrit të aktiveve vlera e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" është në shumen 61,882,490 lekë ndërsa sipas Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b është 65,171,094 lekë ose me një ndryshim prej 3,288,604 lekësh e paraqitur me shume në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b, rrjedhimisht për vlerën 3,288,604 lekësh Drejtoria e Financës nuk disponon informacion për gjendjen e saj kontabël analitike.

Veprime në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

3. Aktive afatgjata financiare.
Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2024 dhe 2025 në vlerën Zero (0) lekë. Ky seksion i bilancit kontabël 2025 është paraqitur në vlerën zero siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.
Llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën zero lekë
-Bashkia Kolonjë, në qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 7% të aksioneve të "K" SH.A me NUIS "K" e cila është shoqëri aksionare me objekt "Mbledhja, transporti, administrimi, depozitimi i mbetjeve bashkiake dhe komunale". Numri i aksioneve është 226 me vlerë nominale 16,550 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,740,300 lekë. Nga këto Bashkisë Kolonjë i përkasin 15.82 aksione me kapital në vlerë monetare 261,821 lekë.
Bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2023 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"* dhe marrëveshjes

për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjellës Kanalizime Kolonje i është bashkëngjitur Sh R U K K" sha me NUIS"M...N".
-Bashkia Kolonjë në qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 3.64% të aksioneve të "*SH R U K K"* sha me NIPT "M...N" e cila është shoqëri aksionare me objekt, *"Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve"*.
Numri i aksioneve është 3,638 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 363,800 lekë.
Vlerat e mësipërme sipas qendrës Kombëtare të Biznesit në asnjë rast nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2025 ,më konkretisht në llogarinë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"*
Llogarinë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* është pasqyruar me pak me (kosto) 625,621 lekë (261,821 lekë + 363,800 lekë) në pasqyrën e pozicionit financiar.
Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në Pjesëmarrje me vlerë kontabël 625,621 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.
Konkluzion: Nga audimi i pasqyrës se pozicioni financiar u konstatua që llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën zero lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 625,621 lekë .Konstatohet që nuk është pasqyruar në ketë llogari pjesëmarrja në kapital në shoqërinë "K" SH.A me NUIS"K...O" e cila është shoqëri aksionare me objekt *"Mbledhja, transporti, administrimi, depozitimi i mbetjeve bashkiake dhe komunale"* për vlerën 261,821 lekë. Konstatohet që nuk është paraqitur në llogarinë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* në Sh R U K K" sha me NIPT "M...N" për vlerën 363,800 lekë.
Veprime në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"* kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.
-Llogaria 230 *"Për aktive afatgjata jo materiale"* më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 74,757,665 lekë.
-Llogaria 231"*Për aktive afatgjata materiale"* më datë 01.01.2025, ka qenë në vlerën 51,269,251 lekë. Sipas Pasqyrës se Aneksit statistikore *"Investimet dhe burimet e financimit"* gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa (debi) në vlerën 56,962,792 lekë dhe pakësim(kredi) në vlerën 33,474,388 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 74,757,665 lekë. Analiza e lëvizjes së llogarisë paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.2/37:Llogaria 231*"Për aktive afatgjata materiale"*/ Lekë

Llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale"	
Gjendje në 01.01.2025	51,269,261
Shtesa	56,962,792
Pakësime	33,474,388
Gjendja në 31.12.2025	74,757,665

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Llogaria 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* në fillim të vitit 2025 rezulton në vlerën 51,269,261 lekë dhe në fund të vitit 2025 rezulton në vlerën 74,757,665lekë ose me një shtese gjatë vitit 2025 për vlerën prej 23,488,404 lekë.
Nga auditimi i pasqyrës aneksit statistikore Formati nr.6, llogaria 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* është debituar për vitin 2025 në vlerën 56,962,792 lekë dhe është kredituar për vlerën 33,474,388 lekë. Për sa me sipër shtesa e llogarisë 230-231 "*Investime për aktive afatgjata materiale"* në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2024 është pasqyruar në vlerën 23,488,404 lekë (56,962,792 lekë – 33,474,388 lekë).
Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës *"Investimet dhe burimet e financimit"* Formati nr.6, llogaria 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale"* konstatohet që vlera kreditore e llogarisë 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* për vitin 2025 në vlerën 33,474,388 lekë nuk përputhet me shtesat e llogarisë 21 "*Aktive afat gjata materiale*" sipas pasqyrës se "*Gjendja dhe ndryshimet e aktive afatgjata me kosto historike*" formati 7/b ku blerje e krijuar me pagese është në vlerën 28,040,730 lekë. Mospërputhja midis shtesës se aktivit llogaria 21 "*Aktive afat gjata materiale*" vlerës debitorë të saj dhe pakësimit të llogarisë 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*" vlerës kreditore të saj është në vlerën 5,433,658 lekë (33,474,388 -28,040,730)

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i Llogarive të klasës 2. Germa b, germa d.
"Për konstatimin e shpenzimeve për blerjen apo krijimin e aktivit:
Debitohet Llogaria 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" në analizë shtate shifrorë;
Kreditohet Llogaria 404 "Furnitorë për investime".
Për kapitalizmin e aktivit (kur vihet në funksionim) bëhet hyrje:
Debitohet Llogaria 21 "Aktive afatgjata materiale"•
Kreditohet Llogaria 231 ' 'Investime për aktive afatgjata materiale" në analizë shtatë shifrore".
C)Llogaritë 105 mbeten me teprice në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pa marra në dorëzim) .Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e Llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.
C)Llogaritë 106 mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces për institucionin (të papërfunduara ose të pa marra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e Llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur Investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.
B)Llogaria 115 "Caktim fondi për investime nga rezultati i vitit". Krijimi i këtij burimi ka të bëjë me ato njësi (sidomos organet e pushtetit vendor), që të ardhurat e realizuara vitit ushtrimor i përdorin konform ligjit për seksionin e investimeve, pra për investime. Nga pikëpamja e funksionimit kontabël, ky burim krijohet nëpërmjet një transferimi nga seksioni i funksionimit në seksionin e investimeve për të mos dhënë efekte në rezultat.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kolonje më datën 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit Dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., Në mënyre të përmbledhur pasivet paraqiten si me poshtë vijon:

Tabela 2/38;Pasivet 2025 /lekë

Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Viti 2025	Viti 2024
B	PASIVET(DETYRIMET)	129,466,131	136,483,072
	I. Pasivet Afat shkurtra	129,466,131	136,483,072
	1. Llogari të Pagueshme	129,466,131	136,483,072
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	7,326,934	11,679,257
42	Detyrime ndaj personelit	15,959,310	16,362,886
16,17,18	Hua Afat shkurtra	0	0
460	Huadhënës		
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,658,136	1,608,414
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	602,460	719,840
435	Sigurime Shoqërore	4,932,470	4,983,681
436	Sigurime Shëndetësorë	677,879	695,992
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore		
44	Institucione të tjera publike		
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
464	Det. Për tu paguar për bl. letrave me vlere		
466	Kreditore për mjete në ruajtje	10,416,894	10,277,992
467	Kreditore të ndryshëm	6,028,698	13,090,758
4341	Operacione me shtetin(detyrime	81,863,350	77,064,252
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
419	Kreditore, Parapagime		
475	Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar		
487	Te ardhura të arkëtuara para nxjerrjes se titullit		
	II. Pasivet Afat Gjata	0	0
Klase 4	Llogari të pagueshme		
16.17,18	Huate Afat gjata		
	Provigjonët afatgjata		
Klasa 4	Te tjera		

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 401-408 *"Furnitorë e llogari të lidhura me to"* më datë 01.01.2025 paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 11,679,257 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 70,600,238 lekë dhe pakësime në vlerën 74,952,561 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën

7,236,934 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 *"Furnitorë e llogari të lidhura me to"*, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Tabela nr.2/39: Llogaria 401-408 *"Furnitorë e llogari të lidhura me to"*/ Lekë

Llogaria 401-408 *"Furnitorë e llogari të lidhura me to"*	
Çelje e vitit 2025	11,679,257
Shtesa (K)	70,600,238
Pakësime (D)	74,952,561
Gjendja debitorë në 31.12.2025	7,326,934

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

E analizuar gjendja e kësaj llogarie me date 31.12.2025 për periudhën në auditim paraqitet në pasqyrën në Aneksin nr.3/10 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.
-Llogaria 42 *"Detyrime ndaj personelit"* referuar pasqyrës se pozicionit financiar paraqitet në vlera 15,959,310 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2025 e cila mbetet për t'u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.

Tabela nr.2/40: Llogaria 42 *"Detyrime ndaj personelit"*./Lekë

Llogaria 42 *"Detyrime ndaj personelit"*	
Çelje e vitit 2025	16,362,886
Shtesa (K)	198,069,767
Pakësime (D)	198,473,343
Gjendja debitorë në 31.12.2025	15,959,310

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026,likujdimet paraqiten në Aneksin nr.3/11 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.
-Llogaria 431 "*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"*, paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar me 31.12.2025 në vlerën 1,658,136 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj Shtetit për muajin Dhjetor.

Tabela nr.2/41: Llogaria 431 *"Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"*/Lekë

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2025	1,608,414
Shtesa (K)	21,197,621
Pakësime (D)	21,147,899
Gjendja debitorë në 31.12.2025	1,658,136

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se janë paguar si me poshtë vijon:

Tabela nr.2/42: Llogaria 431 *"Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"*, e detajuar/ Lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	Datë	**Vlera**
02	07.01.2026	17,553
04	12.01.2026	30,600
02	07.01.2026	123,120
07	13.01.2026	78,060
05	06.01.2026	1,408,803
Totali		1,658,136

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 435 "*Sigurime shoqërore*" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore dhe për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin Janar 2026 të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 4,932,470 lekë.

Tabela nr.2/43: Llogaria 435 *"Sigurime shoqërore"*./ Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	4,983,681
Shtesa (K)	60,251,115
Pakësime (D)	60,302,326
Gjendja debitorë në 31.12.2025	4,932,470

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se janë paguar si me poshtë vijon:

Tabela nr.2/44: Llogaria 435 "Sigurime shoqërore" e detajuar/ Lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	Datë	**Vlera**
01	07.01.2026	359,433
01	07.01.2026	56,020
01	06.01.2026	2,720,089
03	06.01.2026	1,722,728
06	06.01.2026	74200
	Totali	4.932,470

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 436 *"Sigurime shëndetësore"* paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit Dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin Janar 2026 të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerën 677,879 lekë.

Tabela nr.2/45: Llogaria 436 "*Sigurime shëndetësore"*/ Lekë

Llogaria 435 "*Sigurime shoqërore*"	
Çelje e vitit 2025	695,992
Shtesa (K)	8,271,607
Pakësime (D)	8,289,720
Gjendja debitorë në 31.12.2025	677,879

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se janë paguar si me poshtë vijon:

Tabela nr.2/46: Llogaria 436 "*Sigurime shëndetësore*" e detajuar./ Lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	Datë	**Vlera**
01	07.01.2026	49,880
01	07.01.2026	7,775
02	06.01.2026	310,112
04	06.01.2026	310,112
Totali		677,879

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Kolonje në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 10,416,894 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Kolonje. Lëvizjet e llogarisë për periudhën objekt auditimi paraqiten në pasqyrën në vijim:

Tabela nr,2/47:Llogaria 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje"*/lekë

Llogaria 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*"	
Çelje e vitit 2025	10,277,992
Shtesa (K)	1,263,902
Pakësime (D)	1,125,000
Gjendja debitorë në 31.12.2025	10,416,894

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Analiza sipas subjekteve që kanë ngurtësuar fonde për objekte që kanë përfunduar paraqiten në Aneksin nr.3/12 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Kolonje në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 10,416,894 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Kolonje. Konstatohet që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka të detajuara për 30 projekte vlerën prej 8,937,618 lekë dhe për vlerën prej 1,479,276 lekë nuk disponon informacion të detajuar se kujt investimi i përket kjo vlere e ngurtësuara në llogarinë 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"*.

Veprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50

Pika 29. Me pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese.

Pika 30. Çdo njësi e qeverisjes se përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjorë, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë baze, në kontabilitet, behën veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet.

Pika 39. Këto pasqyra ju dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit, me qëllim përgatitjen dhe rakordimin e pasqyrave financiare të njësisë me informacionin që gjendet në SIFQ. Në këtë mënyrë, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, rakordojnë të dhënat e tyre në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor që kanë përgatitur me pasqyrat e mësipërme të gjenëruara nga SIFQ-i.

Pika 50. tepricat e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt akordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt akordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës se të ardhurave të trashëguara (te ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

UKM nr. 3, datë 15.02.2011, *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10, ku përcaktohet që:

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

- Llogaria 467 *"Kreditore të ndryshëm* " paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 31.12.2025, janë në vlerën 6,028,698 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në Aneksin nr.3/13 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.
Nga auditimi i llogarisë 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* konstatohet se, në këtë llogari janë klasifikuar detyrimet e prapambetura në vlerën 6,028,698 lekë. Me shkresën e dërguar në Ministrinë e Financave me nr.1460.prot., datë 27.02.2026 Bashkia Kolonje ka raportuar detyrime të prapambetura në vlerën 6,028,698 lekë nga të cilat, shërbime në vlerën 3,350,000 lekë, mirëmbajtje 120,915 lekë, mallra 2,557,783 lekë.
Llogaria 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"*, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 77,064,252 lekë ndërsa në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 81,863,350 lekë. Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Konkretisht, trajtimi kontabël është si më poshtë:
a) Pasi ka ndodhur situata dhe është bërë veprimi kontabël: • Debitohet Llogaria 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes (buxhet apo institucion);
• Kreditohen Llogarite respektive të klasës 7 për të ardhurën e konstatuar.
b) E ardhura në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi:
Debitohet Llogaria 8424 "Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm";
Kreditohet Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)".
c) Në momentin kur arkëtohet e ardhura bëhet veprimi:
Debitohet Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar";
Kreditohen Llogarite 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm.
d) Me qenë se e drejta u arkëtua dhe Llogaria 520 është e thesarit (të ardhurat u arkëtuan), në fund të periudhave përkatëse bëhet veprimi përkatës:
Debitohet Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)";
Kreditohet Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" (për mbylljen e kësaj pjese).

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në tabelën më poshtë vijon:

Tabela nr.2/48: Detajet e nën rubrikës *"Operacione me shtetin (detyrime)"*/lekë.

Emërtimi i llogarive	2025	2024
Klientë e llogari të ngjashme llogari. 411	1,872	1,872
Personeli, paradhënie, deficite, gjoba llogaria. 423,429	5,926,640	5,357,186
Debitorë të ndryshëm llogari. 468	75,934,838	71,705,194
Totali	81,863,350	77,064,252

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm"* për vitin 2025 është shtuar në vlerën 4,229,644 lekë (75,934,838 -71,705,194). Totali i llogarive 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë"* + 4341 *"Operacione me shtetin detyrime"* është në vlerën 81,863,350 lekë.
Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar konstatohet se, në pasiv të bilancit pasqyrohet llogaria 4341*"Operacionë me shtetin detyrime"* është në vlerën prej 81,863,350 lekë.
Llogaria 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"* është një Llogari që në Pasqyrat Financiare të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme.
Llogaria 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"* është regjistruar në kundërshtim me udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 "*Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*. Në rubrikën 2.3 *"Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik"*, paragrafi 21, shtohet pika (c) me përmbajtjen:
"c)Për njohjen (me konstatimin) e të drejtave për t'u arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:
Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16, administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njësive si më poshtë:
-Për konstatimin paraprak të të drejtave për t'u arkëtuar debitohen llogaritë përkatëse të klasës 4 (411/468) "Debitorë të ndryshëm" dhe kreditohet llogaria 470 "Llogari në pritjes të ardhura për tu marrë.
Për arkëtimin e të drejtave, në të njëjtën kohë me veprimet sipas pikës 16 (e) dhe 22, kryhet veprimi i kundërt: debitohet Llogaria 470 dhe kreditohet Llogaria përkatëse e të drejtave e debituar më parë (411/468)".
Nga auditimi i pasqyrimit të llogarisë 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë"* në pasqyrat e pozicionit financiar u konstatua se kjo llogari është në vlerën zero lekë .Kjo llogari edhe në rakordimin e pozicionit financiar me thesarin është në vlerën zero lekë.
Llogaria 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë"* duhet të ketë në kundër parti të sajë llogarinë 468 *"Debitor të ndryshëm"* për vlerën 4,229,644 lekë të shtese se debitorëve për vitin 2025 si dhe kundër parti e llogarinë 4341*"Operacionë me shtetin detyrime"* për vlerën 77,633,706 lekë (81,863,350-4,229,644).
Për vitin 2025 llogaria 4341*"Operacionë me shtetin detyrime"* është mbi vlerësuar për shtesën e shtese e debitorëve për vitin 2025 vlerën 4,229,644 lekë dhe llogaria 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë"* është nënvlerësuar për shtesën e shtese e debitorëve për vitin 2025 vlerën 4,229,644 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi i paraqitjes se llogarisë 4341*"Operacionë me shtetin detyrime"* në pasqyrën e pozicionit financiar u konstatua që kjo llogari është mbivlerësuar për shtesën e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 vlerën 4,229,644 lekë. Konstatohet që llogaria 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë"* është nënvlerësuar për shtesën e debitorëve për vitin 2025 vlerën 4,229,644 lekë.
Veprime në mospërputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese i ndryshuar me Udhëzimin nr.5. date 21.02.2022 Në rubrikën 2.3 *"Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik"*, paragrafi 21, shtohet pika

c , pika 3.2. "*Trajtimi kontabël dhe funksioni i Llogarive të të tretëve (klasa 4)"* Llogaria 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"* germat a, b ,c, d.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Paraqitja e Aktiveve neto dhe fondit të konsoliduar.
Të dhënat për këto llogari në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.2/49: Fondi i konsoliduar/Lekë

Nr. llogarive	E M E R T I M I	Viti 2024	Viti 2025
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	3,044,988,672	3,048,848,651
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,990,399,633	3,009,338,378
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	48,932,109	30,441,300
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta të investimeve	5,656,930	9,068,973
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime	0	
105	Teprica e Granteve kapitale të Brendshme	0	0
106	Teprica e Granteve kapitale të Huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim	0	0
109	Rezerva nga Rivlerësimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
	Te Tjera	0	0

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

.
-Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,990,399,663 lekë.
Udhëzimi i Ministrit së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar Kreu II *"Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* pika 17 citon: *"Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve që prekin llogaritë e pozicionit financiar (bilancit) ndiqet procedura e mëposhtme":*
a*)Llogaria 101 e klasës 1 funksionon si më poshtë:*
Kreditohet për shtesat në fondet bazë që vijnë nga:
Grantet kapitale për aktivet afatgjata të blera dhe të kapitalizuara;
Grantet kapitale që vijnë nga dhurimet në natyrë të aktiveve afatgjata;
Rivlerësimet në shtesë të aktiveve afatgjata;
Anulimet e detyrimeve për t'u paguar; si dhe
Të tjera.
Debitohet për pakësimet në fondet bazë që vijnë nga:
Shitja e aktiveve afatgjata, të vlerësuara me koston historike të blerjes së tyre;
Nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata;
Transferimet e dhurimet e aktiveve afatgjata;
Konsumi i aktiveve afatgjata;

Rivlerësimet në pakësim të aktiveve afatgjata; si dhe
Anulimet e të drejtave për t'u arkëtuar;
Të tjera."
Analiza e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* sipas pozicionit financiar individual paraqitet në pasqyrën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2/50: Llogaritja e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"*/lekë

Fondi i konsoliduar	Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"			
2,990,399,663	Mbyllje më datë 31.12.2025		Çelje më datë 01.01.2024	
	Debi		Kredi	
		Amortizimi i paksim sipas pasqyrës nr. 7/b	3,009,338,378	Çelja gjendja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" i datës 31.12.2023
	11,934,793	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	45,429,181	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	88,529,537	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	-9,195,958	Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"
Totali	100,464,330		3,045,571,601	
3,045,571,601-100,464,330=2,945,107,271				
2,990,399,663-2,945,107,271=45,292,392				

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit/përpunoi grupi i auditimit.

Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* më datë 31.12.2025, sipas pasqyrave individuale të pozicionit financiar paraqitet në vlerën 2,990,399,663 lekë.
Sipas informacionit kontabël llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* është paraqitur në vlerën 2,990,399,663 lekë. lekë në fund të vitit 2025 dhe duhej të paraqitej në vlerën 2,945,107,271 lekë ose është paraqitur 45,292,392 lekë më shume (2,990,399,663-2,945,107,271=45,292,392).Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* është mbivlerësuar për vlerën 45,292,392 lekë
Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 17.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj: G D Drejtor i Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit.

TË ARDHURAT

Te ardhurat në total për vitin 2025 janë në vlerën 532,241,163 lekë dhe përbehen nga Llogaria 70 *"Të ardhurat nga taksat e tatimet"* në vlerën 25,407,997 lekë , llogaria 71 *"Te ardhura jo tatimore"* në vlerën 34,533,797 lekë dhe llogaria 72 "Grande Korente" në vlerën 472,299,369 lekë.

Paraqitja e detajuar në lidhje me të ardhurat në pasqyrën e performancës financiare paraqitet në Aneksin nr.3/13 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 *"Të ardhurat nga taksat e tatimet",* në vlerën 25,407,997 lekë përbehet nga Tatim mbi Biznesin e vogël 5,000 lekë ,Taksa mbi pasurinë në vlerën 10,793,376 , Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit 14,602,223 lekë dhe të tjera tatime e taksa kombëtare 7,398 lekë. Analiza e detajuar e llogarive të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet si me poshtë vijon::

Taksa mbi pasurinë në vlerën 10,793,376 lekë përbehet nga Taksa mbi token bujqësore 7,478,203 lekë, Taksa mbi ndërtesën 3,312,089 lekë dhe Taksa mbi Truallin 3,084 lekë. Të përmbledhura janë në Aneksin nr.3/14 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Llogaria 703 *"Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit"* 14,602,223 lekë përbehet nga Takse therje bagëtie 4,600 lekë; Takse regjistrim biznesi 40,000 lekë; Takse tregu 709,790 lekë; Takse për ndërtimet e reja 1,200,923 lekë; Takse mbi xhiron 83,360 lekë; Takse fjetje në hotel 21,925 lekë; Takse tabele 522,297 lekë; Tarife drusore 3,021,026 lekë; Tarife ndriçimi 5,149,939 lekë; Tarife trualli 12,500 lekë; Tarifë uji 253,450 lekë ; Tarife kulture sport 107,550 lekë; Tarife hidrocentrali 3,474,962 lekë. Të përmbledhura janë në Aneksin nr.3/15 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Llogaria 708 të tjera tatime e taksa kombëtare në vlerën 7,398 lekë përbehet nga Taksa e pullës në vlerën 7,398 lekë.

Të ardhurat jo tatimore:
Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", për vitin 2025 janë në vlerën 34,533,797 lekë dhe përbehen nga Llogaria 710 Nga ndërmarrjet dhe pronësia në vlerën 19,268,367 lekë dhe llogaria 711 Shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare në vlerën 15,265,430 lekë
Llogaria 710 Nga ndërmarrjet dhe pronësia në vlerën 19,268,367 lekë përbehet nga Qira troje në vlerën 19,100,721 lekë dhe Qira ndërtese në vlerën 167,646 lekë. të përmbledhura janë në Aneksin nr.3/16 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.
Llogaria 711 Shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare në vlerën 15,265,430 lekë përbehet nga Tarife pastrimi 9,979,984 lekë; Administrimi 3,239,882 lekë; Tarife çerdhe 850,850 lekë; Tarife parkimi 113,850 lekë; Shërbim MNZ 20,000 lekë; Gjoba të tjera 17,000 lekë; Kamatëvonesa 828,164 lekë; Zhdëmtime 60,000 lekë. të përmbledhura janë në tabelën në Aneksin nr.3/17 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Grante korente:
-Llogaria *72 "Grante korente"* për vitin 2025 paraqitet në vlerën 472,299,369 lekë. Kjo llogari përbehet nga llogarite 7200 "*Grant korent nga Buxheti për NJQP(qendrore)"* në vlerën 425,314,839 lekë nga llogaria 7204 *"Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale"* në vlerën 10,401,053 lekë dhe nga llogaria 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* në vlerën 36,583,427 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.2/51: Llogaria 72 *"Grante korente"*./ Lekë

72	V.GRANTE KORENTE	472,299,369
720	1.Grant korent I Brendshëm	472,299,369
7200	Nga Buxheti për NJQP(qendrore)	425,314,889
7201	Nga Buxheti për NJQP(Vendore)	0
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH	
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)	
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	10,401,053
7205	Financim shtese për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	36,583,427
7207	Sponsorizime të brendshme(nga të trete)	

Burimi: Drejtoria e Ekonomike e Financës dhe Buxhetit

Analiza e llogarive të të ardhurave

Auditimi në lidhje me të ardhurat tatimore u fokusua në drejtim të rakordimit të të ardhurave sipas llojeve të tyre midis thesarit sektorit të taksave dhe tarifave vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. U kryen rakordimet e të ardhurave me thesarin sipas llojeve të tyre dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrën e performancës financiare të bashkisë Kolonje në Pasqyrat financiare të konsoliduar.

Nga auditimi i ushtruar për të dhënat e të ardhurave sipas kodit të të ardhurave për taksat dhe tarifat vendore dhe të ardhurave jo tatimore sipas thesarit me të ardhurat e raportuara në pasqyrën e performancës financiare u konstatua që të ardhurat në total sipas rakordimit të thesarit janë në vlerën prej 70,542,847 lekë për taksat dhe tarifat vendore si dhe të ardhurat nga pjesëmarrja në taksat nacionale dhe grand nga Njësite vendore e cila është në vlerën 200,000 lekë. Totali sipas akt rakordimit me thesarin është në vlerën 70,542,847 lekë të ardhura të realizuara ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar janë paraqitur në vlerën 70,342,847 lekë. Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka pasqyruar sakte të dhënat në lidhje me taksat dhe tarifat vendore dhe të ardhurat jo tatimore sipas klasave të tyre që përputhen me të dhënat e thesarit sipas kodeve përkatëse. Konstatohet se nga vlera e rakordimit me thesarin prej 70,542,847 lekë nuk është pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare llogaria me kod 7200102 "*Grande të njësisë vendore"* në vlerën 200,000 lekë por është paraqitur në llogarinë 7200 *"Grande nga Buxheti për NJQP(qendrore)"* .Vlera prej 10,401,053 lekë është paraqitur në llogarinë 7204 *"Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale".*

Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion për fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2025 u konstatua që fonde të akorduara janë në total 466,736,101 lekë. Nga këto fonde që akordohen për Bashkinë në thesar për disa prej tyre nuk disponohet shkrese akordim fondi dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit të dhënat për transferimin e fondit i merr nga Dega e thesarit Kolonje. Në mënyre të përmbledhur të dhënat për fondet e akorduara për vitin 2025 paraqiten në të përmbledhura në Aneksin nr.3/18 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion për fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2025 u konstatua që fonde të akorduara janë në total 466,736,101 lekë. Konstatohet që fakti i investimeve sipas akt rakordimit me thesarin nga grandet është 33,937,411 lekë dhe nga të ardhurat e veta të bashkisë 5,656,930 lekë.

Referuar Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme i ndryshuar* Pika 2.3 Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik nënpika 15 pasqyrimi i llogarisë 720 *"Grant korrent i brendshëm"* në pasqyrat financiare kryhet për vlerën e grandeve të akordura nga buxheti duke zbritur faktin e investimeve nga grandet sipas rakordimit me thesarin. Për sa me sipër pasqyrimi i llogarisë 720 *"Grant korrent i brendshëm"* në pasqyrën e performancës financiare

duhej të paraqitej në vlerën 432,798,690 lekë (466,736,101-33,937,411) dhe është paraqitur 425,314,889 ose është paraqitur 7,438,801 lekë me pak.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion për fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2025 u konstatua që fonde të akorduara janë në total 466,736,101 lekë. Konstatohet që fakti i investimeve sipas akt rakordimit me thesarin nga grandet është 33,937,411 lekë dhe nga të ardhurat e veta të bashkisë 5,656,930 lekë.
Nga auditimi u konstatua që ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave 720 *"Grant korrent i brendshëm"* në pasqyrën e performancës financiare duhej të paraqitej në vlerën 432,798,690 lekë (466,736,101-33,937,411) dhe është paraqitur 425,314,889 ose është paraqitur 7,483,801 lekë me pak.
Veprime në kundërshtim me Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar Pika 2.3 Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik nënpika 15 . *Në fillim të vitit ushtrimor, për fondet buxhetore të akorduara nga buxheti (për shpenzime korrente dhe kapitale) bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë*:
Debitohet llogaria 520 "Disponibilitete në thesar"; dhe
Kreditohet llogaria 476 "Të ardhura të caktuara për t'u përdorur".
Në fund të Vitit Ushtrimor, sipas situacionit të rakorduar me sistemin e thesarit, për përdorimin e fondeve buxhetore korrente dhe kapitale, bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:
Debitohet llogaria 476 "Të ardhura të caktuara për t'u përdorur" (për totalin e fondeve buxhetore të përdorura);
Kreditohet llogaria 720 "Grant korrent i brendshëm" (për fondet buxhetore të përdorura për shpenzimet korrente të shfrytëzimit);
Kreditohet llogaria 105 "Teprica e granteve kapitale të brendshme" (për fondet buxhetore të përdorura për shpenzime kapitale);
Kreditohet llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" (për pjesën e fondeve të përdorura gjate vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues).
Në fund të vitit ushtrimor, për fondet buxhetore (për shpenzime korrente dhe kapitale), të papërdorura gjatë vitit ushtrimor, bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:
Debitohet, për mbyllje, llogaria 476 "Të ardhura të caktuara për t'u përdorur"; dhe
Kreditohet llogaria 520 "Disponibilitete në thesari"

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

SHPENZIMET
1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:
-Llogaria 600 *"Pagat dhe përfitimet e punonjësve"* për vitin 2025 është pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare në vlerën 249,711,246 lekë. Llogaria 6001 "*Paga, personel i përhershëm"* për vitin 2025 është pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare në vlerën 247,675,842 lekë. Nga auditimi i të dhënave të borderove përmbledhëse të raportuara në sistemin CATS u konstatua që për vitin 2025 pagat bruto për Bashkinë janë në vlerën 224,973,011 lekë, për njësinë vartëse "Sportin" janë 2,348,390 lekë dhe për njësinë vartëse "Kulturën" janë 15,960,652 lekë. Në total pagat bruto sipas borderove të tre njësive janë në vlerën 243,282,053 lekë (224,973,011 +

2,348,390 + 15,960,652). Nga auditimi u konstatua që pasqyrimi i pagave 6001 *"Paga, personel i përhershëm"* në pasqyrën e performancës financiare është pasqyruar në vlerën 247,675,842 lekë ose është pasqyruar 4,393,789 lekë me shume (247,675,842 - 243,282,053) në pasqyrën e performancës financiare duke ndikuar negativisht në rezultatin e vitit ushtrimor për vlerën 4,393,789 lekë.
Veprime në kundërshtim me Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar pika 4.1: *"Shpenzimet në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe operacionet që lidhen me to"*.
Llogaria 600 *"Pagat dhe përfitimet e punonjësve"*. Në këtë llogari përfshihen të gjitha shpenzimet për personelin e njësisë: paga bruto, kompensime, shpërblime e të tjera sipas legjislacionit në fuqi.
Funksionimi kontabël i llogarisë 600 *"Pagat dhe përfitimet e punonjësve"* është si më poshtë:
a*) Për konstatimin e pagave bruto, borderotë e muajit përkatës:*
Debi llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve" në nivele shtate shifrore;
Kreditohet llogaria 421 "Detyrime ndaj personelit";
Kreditohet llogaria 425 "Personeli, shpërblime për t'u paguar";
Kreditohet llogaria 425 "Personeli detyrime të tjera për tu paguar".

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :
Znj. G. D /nëpunës zbatues Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Llogaria 85 *"Teprica ose deficiti i periudhës"* është pasqyruar 48,932,109 lekë në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2025. Konstatohet që si pasoje e pasqyrimit të pasakte të llogarisë 720 *"Grant korrent i brendshëm"* në pasqyrën e performancës financiare për vlerën 7,483,801 lekë dhe llogarisë 6001 "*Paga, personel i përhershëm"* 4,393,789 lekë ,llogaria 85 *"Teprica ose deficiti i periudhës"* është nënvlerësuar për vlerën 11,877,590 lekë (7,483,801 + 4,393,789).
Pasqyra e shpenzimeve paraqitet në Aneksin nr.3/19 bashkëngjitur Raportit përfundimtar te auditimit.

3.3. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar

Procesi i inventarizimit:
Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se;
Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore*", ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë me nr.609 date 11.12.2025 me nr.7096.prot., date 11/12/2025 dhe Drejtuesve të 2(dy) Njësive Shpenzuese të Bashkisë Kolonje "Për ngritjen e Komisioneve të inventarizimin e aktiveve", në secilën njësi administrative është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve në përdorim, si dhe për të krahasuar gjendjen konkrete të aktiveve me gjendjen kontabël, me anëtarë për Bashkinë Kolonje dhe Njësitë e varësisë.

Nga auditimi i proces verbaleve të mbajtura për inventarizimin e aktive u konstatua që nuk janë hartuar në mënyre të plote dhe të sakte duke evidentuara llogarite kontabël të inventarizuara Llogaria 31 *"Materiale"* Llogaria 32 *"Inventar i imët"* llogaria 218 *"Inventar ekonomik"* rrjedhimisht inventarizimi në proces verbale përfshin vlera të grupuara të llogarive dhe jo identifikim të vlerave sipas kartelave të llogarive 31 *"Materiale"*, Llogaria 32 *"Inventar i imët"*, llogaria 218 *"Inventar ekonomik"*. Për sa me sipër kryerja e inventarizimit për këto llogari është i pa plote dhe i pasakte pasi nuk pasqyron një pamje të drejte të gjendjes se këtyre llogarive.

Nga auditimi i dokumentacionit të kryerjes se procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Kolonje (qendër)u konstatua se procesi i inventarizimit të aktiveve është kryer me proces verbale të gjendjeve të aktiveve dhe vlerësimit të tyre me shkresa të pa protokolluar në zyrën e protokoll arshivës. Këto shkresa nuk kanë tërësinë e elementeve të përcaktuara ligjërisht në nenet 11-20 të "*Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*. *"Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"* në Nenin 17 përcakton "*Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod.. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod.. 1). Kategori të caktuara dokumentesh, përcaktuar me urdhër të brendshëm të titullarit, mund t'u kalohen direkt sektorëve."*

Veprime në mos përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, *"Për arkivat"* i ndryshuar, neni 22 dhe nenet 11-20 të *"Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*.

Nga auditimi i procedurave të kryerjes se inventarit u konstatua që nuk është kryer inventarizimi i llogarive

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës. Nga auditimi konstatohet se nga nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s 'kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia si dhe nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot respektivisht; 202- *"Studime dhe kërkime"*, 210- *"Toka, Troje, terrene"*, 211 – *"Pyje, Plantacione"* 212- "*Ndërtesa e Konstruksione"*, 213- *"Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore"*, 214 – *"Instalime teknike, makineri e pajisje"*. Veprimet dhe mosveprimet janë në mos përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *" Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, neni 2, neni 4 ,pika 9; Neni 12 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues"* Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *" Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, pika 36, pika 52, pika 73, pika 85.

Konkluzion : Nga auditimi i dokumentacionit të kryerjes se procesit të inventarizimit të aktiveve u konstatua që nuk proces verbalet e inventarizimit janë hartuar në mënyre të plote dhe të sakte

duke evidentuara llogarite kontabël të inventarizuara Llogaria 31 *"Materiale"* Llogaria 32 *"Inventar i imët"* llogaria 218 *"Inventar ekonomik"*. Inventarizimi në proces verbale përfshin vlera të grupuara të llogarive dhe jo identifikim të vlerave sipas kartelave të llogarive 31 "Materiale" Llogaria 32 *"Inventar i imët"* llogaria 218 *"Inventar ekonomik"*. Nga auditimi u konstatua se procesi i inventarizimit të aktiveve është kryer me proces verbale të gjendjeve të aktiveve dhe vlerësimit të tyre me shkresa të pa protokolluar në zyrën e protokoll arshivës. Nga auditimi konstatohet se nga nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s 'kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia si dhe nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot respektivisht; 202- *"Studime dhe kërkime"*, 210- *"Toka, Troje, terrene"*, 211 – *"Pyje, Plantacione"* 212- *"Ndërtesa e Konstruksione"*, 213- *"Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore"*, 214 – *"Instalime teknike, makineri e pajisje"*. Veprime në mos përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, *"Për arkivat"* i ndryshuar, neni 22 dhe nenet 11-20 të "*Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*.
Udhëzimin e Ministrisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* kreu 3.1.Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme: pika 30.
Veprimet dhe mosveprimet janë në mos përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *" Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, neni 2, neni 4 ,pika 9 " përgjegjshmëria menaxheriale", Neni 12 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues"* Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *" Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, pika 36, pika 52, pika 73, pika 85.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
Znj: G D Drejtor i Drejtorisë Ekonomike të Financës dhe Buxhetit

2.4.1.Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
Mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Kolonjë, në bazë të programit të auditimit nr. 383/1, datë 08.04.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, nr. 319/14.Prot, datë 20.10.2025
- Korrespodenca shkresore e ndjekur nga Bashkia Kolonjë dhe KLSH.
- Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur nga Këshilli Drejtues për këtë qëllim, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Bashkia Kolonjë ka dërguar brenda afatit 20 ditor, kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa "j", të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për*

organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", sipas shkresës përcjellë në KLSH me nr. 3549.Prot, datë 03.10.2025.
Bashkia Kolonjë, ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Kolonjë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "*Mbi auditimin e përputhshmërisë*" trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin **nr.176, datë 09.10.2025**, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 319/14.Prot, datë 20.10.2025 verifikohet se:

Bashkia Kolonjë, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka nxjerrë plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 6287.Prot, datë 06.11.2025 dhe me shkresën nr.5888/1.Prot, datë 11.11.2025 "*Program Punë, për zbatimin e detyrave të lëna të nga KLSH*" ka dërguar pranë KLSH-së kthimin e përgjigjes mbi zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin *15 germa "j", të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH paraqitet:

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë gjithsej 37 gjetje me 50 masa organizative (rekomandime) gjithsej, nga të cilat 31 gjetje me 34 Masa Organizative, (rekomandime) 5 gjetje me 6 masa (Rekomandime) për uljen e borxhit si dhe 1 gjetje me 10 masa (rekomandime) disiplinore.
Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga 34 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga këto është zbatuar 1 masë, janë pjesërisht të zbatuara 10 masa dhe 23 masa janë pazbatuar..
- Nga 6 masa për uljen e borxhit tatimor, janë pranuar 100% nga subjekti, të gjitha rezultojnë të pa zbatuara.
- 10 Masat disiplinore, nuk janë dhënë nga titullari i institucionit, rezultojnë të pazbatuara.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

I. Mbi respektimin e afatit 20 ditor:
Bashkia Kolonjë ka dërguar brenda afatit 20 ditor, kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa "j", të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, sipas shkresës përcjellë në KLSH me nr. 5888/1.Prot, datë 11.11.2025.
II. Mbi respektimin e afatit 20 ditor:
Bashkia Kolonjë, ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr.2498, datë 20.04.2026, në zbatim të neni 30, pika 2, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*.

III. Mbi raportimin në Këshillin Bashkiak Kolonjë të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Bashkia Kolonjë ka hartuar planin e veprimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 6287.Prot, datë 06.11.2025 *"Plan veprimi, për zbatimin e detyrave të lëna*", por nuk ka raportuar rregullisht pranë Këshillit Bashkiak. Sa më sipër nuk është në përputhje me: *Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017,"Për financat e vetëqeverisjes vendore",* neni 50, pika 5.

IV. Rekomandimet e KLSH-së:
Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Kolonjë, janë rekomanduar gjithsej **50** masa konkretisht si më poshtë:

- **34** masa organizative,
- **6** masa për uljen e borxhit.
- **10** masë disiplinore.

V. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Kolonjë, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	**Rekomanduar**	**Pranuar**
Masa organizative	**34**	**34**
Masa për eliminimin e efekteve negative	**0**	**0**
Masa për uljen e borxhit tatimor	**6**	**6**
Masa disiplinore	**10**	**10**
Totali	**50**	**50**

VI. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga Bashkia Kolonjë:

Emërtimi	**Rekomanduar**	**Zbatuar**	**Pa zbatuar**	**Në proces**	**Pjesërisht të zbatuar**
Masa Organizative	34	1	23		10
Masa për EEE	0	0	0		0
Masa për Uljen e Borxhit	6	0	6		0
Masa Disiplinore	10	0	10		0
Total	**50**	**1**	**39**		**10**

Nga verifikimi i dokumentacionit, në lidhje me *zbatimin e rekomandimeve të ri kërkuara* konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:
Nga **34 masa organizative** të rekomanduara, pranuar 100% nga subjekti. Nga këto është **zbatuar 1 masë**, janë pjesërisht të zbatuara 10 masa dhe pa zbatuar 23 masa.
Nga **6 masa për uljen e borxhit tatimor,** pranuar 100% nga subjekti, 6 **rezultojnë të pazbatuara.**
Nga **10 masa Disiplinore,** pranuar 100% nga subjekti, 10 **rezultojnë të pazbatuara**

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të marrë masa të hartojë strukturën e re organizative, duke përfshirë pozicionin e përgjegjësit në

sektorët përkatës, në të cilët nuk është miratuar ky pozicion. Struktura e re organizative të dorëzohet në Këshillin Bashkiak për të marrë miratimin përfundimtar.
Drejtori i Burimeve Njerëzore të hartojë planin vjetor të trajnimeve për personelin e Bashkisë Kolonjë. Të dokumentohen takimet vjetore të GMS.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka hartuar dhe miratuar planin vjetor të trajnimeve për personelin me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë me nr.681, datë 23.12.2024 me shkresën nr.6089.prot, datë 27.12.2024 "Plani i trajnimeve të brendshme periudha janar – dhjetor 2025".
Nga auditimi i strukturës organizative u konstatua se Drejtoria e Burimeve Njerëzore deri më 29.05.2026 nuk ka në strukturën organizative pozicionin e përgjegjësit në drejtoritë dhe sektorët përkatës. Sipas DBNJ brenda vitit 2026 ky institucion do të hartojë strukturë e re organizative duke përfshirë pozicionin e përgjegjësit në drejtoritë dhe sektorët përkatës, të cilën do e miratoj me Vendim nga Këshilli Bashkiak.
Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar. Ky rekomandim nuk ri kërkohet pasi rekomandimi është** evidentuar edhe në auditimin financiar aktual te ushtruar sipas programit të auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e vakancës në Njësinë e Auditit të Brendshëm. Punonjësit e NJAB të marrin masa për t'u certifikuar me certifikatën e audituesit të brendshëm. Përgjegjësi i NJAB të planifikojë dhe të realizojë auditimet në sektorët dhe drejtoritë me risk në Bashkinë Kolonjë. Dosjet e procedurave të auditimit të arkivohen në përfundim të procesit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime për zbatimin e rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se me Vendimin nr. 28, datë 13.08.2025, protokolluar me nr. 4225, është rishikuar Plani Vjetor i Pranimeve në Shërbimin Civil për vitin 2025, duke parashikuar plotësimin e 1 pozicioni përgjegjës dhe 2 pozicioneve specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm. Në vijim janë kryer procedurat e shpalljes pranë AKPA-së dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Kolonjë, ku janë shpallur fitues 1 kandidat për pozicionin e përgjegjësit dhe 1 kandidat për pozicionin specialist, *duke realizuar pjesërisht plotësimin e vakancave* të Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Gjithashtu, *është parashikuar* edhe plotësimi i një pozicioni tjetër specialist në Planin e Rekrutimit për vitin 2026. Për sa i përket certifikimit të audituesve të brendshëm, në zbatim të Urdhrit nr. 159, datë 22.12.2025, të Ministrit të Financave, punonjësit e NJAB kanë paraqitur dokumentacionin për certifikim me shkresën nr. 504, datë 20.01.2026, janë përfshirë në listën paraprake të kandidatëve të miratuar me Vendimin nr. 3, datë 16.02.2026, të Komisionit të Kualifikimit dhe kanë ndjekur Modulin I të trajnimit në datat 04–06.05.2026. Megjithatë, *procesi i certifikimit nuk rezulton i përfunduar dhe nuk është administruar dokumentacion që vërteton pajisjen e tyre me certifikatën e audituesit të brendshëm*. Lidhur me planifikimin dhe realizimin e auditimeve në subjektet me risk, me Vendimin nr. 48, datë 23.12.2025, është miratuar Plani Vjetor i rishikuar i NJAB për vitin 2026, ku janë reflektuar auditime në subjekte të vlerësuara me risk të lartë. Gjithashtu, me Urdhrin nr. 100, datë 04.03.2026

dhe Autorizimin nr. 1584.Prot., datë 05.03.2026, ka filluar auditimi i sistemit të prokurimeve publike. Deri më 29.05.2026, *nuk është administruar dokumentacion që të provojë përfundimin e auditimeve të planifikuara në subjektet me risk të lartë dhe nxjerrjen e rezultateve përkatëse*.
Sa i takon arkivimit të dosjeve të auditimit, rezulton se dosjet e procedurave të auditimit janë dorëzuar dhe marrë në arkiv sipas Procesverbalit nr. 26, datë 26.06.2025, në përputhje me afatet ligjore të parashikuara nga legjislacioni për arkivat.
Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar. Ky rekomandim nuk ri kërkohet pasi rekomandimi është** evidentuar edhe në auditimin financiar përkatës te ushtruar sipas programit të auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026.

3.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30-ditor, nga momenti i prerjes së faturës. Gjithashtu, të marrin masa për të hartuar një planifikim të detajuar të grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, duke siguruar zbatimin e tij gjatë realizimit të buxhetit, në përputhje me burimet financiare të disponueshme për likuidimin e këtyre detyrimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime për zbatimin e rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues kanë ndërmarrë veprime për zbatimin e rekomandimit, duke likuiduar detyrimet e prapambetura të trashëguara nga viti paraardhës. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nga ana e Nëpunësit Zbatues monitorohen procedurat dhe detyrimet financiare në përputhje me regjistrin e planifikimit dhe fondet buxhetore të disponueshme.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të provojë hartimin dhe zbatimin e një plani të detajuar të grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe monitorimin e realizimit të tij gjatë ekzekutimit të buxhetit. Në mungesë të këtij dokumentacioni, nuk mund të vërtetohet plotësisht zbatimi i pjesës së dytë të rekomandimit. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar.**

4.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për të përmirësuar procesin e planifikimit të të ardhurave bazuar në analizë reale të performancës historike dhe të dhëna të verifikueshme. Po ashtu, të hartojë dhe të mbajë një listë analitike të saktë për të ardhurat e trashëguara nga burimet e veta, për të garantuar transparencë dhe kontroll mbi burimin dhe përdorimin e tyre.

Në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime për zbatimin e rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë deklaron se ka marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit të të ardhurave, duke u bazuar në analiza më të detajuara të performancës historike dhe në të dhëna të verifikueshme, si dhe për hartimin dhe përditësimin e një liste analitike të të ardhurave të trashëguara nga burimet e veta. Gjithashtu, sipas shpjegimeve të subjektit, strukturat

përgjegjëse janë ngarkuar me detyra për monitorimin periodik dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të vërtetojë realizimin e këtyre veprimeve, si analiza të planifikimit të të ardhurave, lista analitike të hartuara dhe të miratuara për të ardhurat e trashëguara, raporte monitorimi apo dokumente të tjera që provojnë zbatimin faktik të rekomandimit. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**

5.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për ristrukturimin e drejtorisë së të ardhurave, duke krijuar sektorët për menaxhimin e borxhit tatimor, regjistrimin e subjekteve dhe kontrollin në terren. Të sigurojë përmirësimin e regjistrave elektronikë të tatimpaguesve dhe të vendosë në funksion një adresar të unifikuar për individë dhe biznese, për të mundësuar planifikimin, vlerësimin dhe njoftimin në kohë të detyrimeve tatimore. Të kryejë rakordime të rregullta ndërmjet strukturave të përfshira në mbledhjen e të ardhurave për të siguruar një proces të koordinuar dhe të dokumentuar të administrimit të të ardhurave. Të sigurohet që për çdo taksë/tarifë të përcaktohet struktura përgjegjëse për përllogaritjen dhe vjeljen dhe të hartohet një evidencë e përbashkët për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave.

Në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë disa veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht,
Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore deklaron se struktura aktuale e Drejtorisë së të Ardhurave përbëhet nga Sektori i Vlerësimit dhe Regjistrimit Tatimor dhe Sektori i Inspektimit dhe Mbledhjes së të Ardhurave, ndërsa krijimi i Sektorit të Menaxhimit të Borxhit Tatimor është planifikuar të realizohet gjatë vitit 2026. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se është punuar për përmirësimin e regjistrave të tatimpaguesve, vendosjen graduale të një sistemi adresimi të unifikuar për individë dhe biznese, kryerjen e rakordimeve periodike ndërmjet strukturave përgjegjëse dhe përcaktimin e strukturave përgjegjëse për përllogaritjen dhe vjeljen e taksave dhe tarifave vendore. Megjithatë, nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të provojë funksionimin e plotë të adresarit të unifikuar, kryerjen e rakordimeve periodike të dokumentuara, si dhe hartimin dhe përdorimin e evidencës së përbashkët për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, e cila sipas informacionit të paraqitur rezulton ende në proces përditësimi.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të provojë funksionimin e plotë të adresarit të unifikuar, kryerjen e rakordimeve periodike të dokumentuara, si dhe hartimin dhe përdorimin e evidencës së përbashkët për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, e cila sipas informacionit të paraqitur rezulton ende në proces përditësimi. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar. Ky rekomandim nuk ri kërkohet pasi rekomandimi është** evidentuar edhe në auditimin financiar aktual te ushtruar sipas programit të auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, drejtoritë e ngarkuara për administrimin e taksave dhe tarifave lokale sipas paketës fiskale, të marrin masa për krijimin e mekanizmave efektivë të kontrollit mbi cilësinë dhe përditësimin e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve, duke garantuar rakordim të rregullt dhe periodik me qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Degën Rajonale të Tatimeve mbi statusin dhe aktivitetin e bizneseve. Të ndërtohet një sistem i integruar me

elementë të verifikueshëm dhe të dokumentuar të veprimtarive për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, të mbështetur në dokumentacion verifikues të sektorit të kontrollit në terren.

Në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë disa veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht,
Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë, Drejtoria e të ardhurave ka deklaruar marrjen e masave për përmirësimin e administrimit të taksave dhe tarifave vendore, forcimin e mekanizmave të kontrollit mbi regjistrin elektronik të subjekteve, realizimin e rakordimeve me qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, si dhe ngritjen e një sistemi të integruar për administrimin e taksave vendore dhe rritjen e kontrollit në terren.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të provojë krijimin dhe funksionimin e mekanizmave efektivë të kontrollit mbi regjistrin elektronik të subjekteve, kryerjen e rakordimeve periodike me institucionet përkatëse, ndërtimin dhe vënien në funksion të sistemit të integruar të administrimit të taksave dhe tarifave vendore, si dhe dokumentimin e veprimtarive të kontrollit në terren.. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar. Ky rekomandim nuk ri kërkohet pasi rekomandimi është** evidentuar edhe në auditimin financiar aktual te ushtruar sipas programit të auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar" për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë disa veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht,
Përgjigja e subjektit: Janë marre masa për kryerjen e saktë të kontabilizimit të llogarisë 101 "Teprica (fond i akumuluar)/ deficit i akumuluar "në mbyllje të pasqyrave financiare 2025.
Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar. Ky rekomandim nuk ri kërkohet pasi rekomandimi është** evidentuar edhe në auditimin financiar aktual te ushtruar sipas programit të auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të hartojë regjistrin e aktiveve afatgjata jo materiale sipas udhëzimeve përkatëse dhe të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime" për të dhënë informacion kontabël të saktë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht,
Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Financës deklaron se ka ndërmarrë veprime për përditësimin e regjistrit të aktiveve afatgjata, por procesi nuk ka përfunduar. Saktësimi i regjistrit nuk është realizuar ende për shkak të mungesës së specialistëve të inventarizimit të aseteve, ndërsa pozicionet vakante përkatëse janë shpallur disa herë pa u plotësuar. Gjithashtu, subjekti deklaron se puna për saktësimin e plotë të regjistrit vijon ende.

Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion që të vërtetojë hartimin e regjistrit të aktiveve afatgjata jo materiale sipas kërkesave të akteve rregullatorë në fuqi, si dhe nuk është paraqitur dokumentacion që provon kryerjen e kontabilizimit të saktë të llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime", në përputhje me rekomandimin e lenë. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar. Ky rekomandim nuk ri kërkohet pasi rekomandimi është** evidentuar edhe në auditimin financiar përkatës te ushtruar sipas programit të auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë të hartojë regjistrin e aktiveve afatgjata materiale sipas udhëzimeve përkatëse për llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, Kullota, Plantacione", 212 'Ndërtesa" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" për të dhënë informacion kontabël të saktë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht,
Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Financës deklaron se ka ndërmarrë veprime për përditësimin dhe saktësimin e regjistrit të aktiveve afatgjata materiale, por procesi nuk ka përfunduar. Sipas shpjegimeve të subjektit, regjistri nuk është saktësuar ende për shkak të mungesës së specialistëve të inventarizimit të aseteve, ndërsa pozicionet vakante përkatëse janë shpallur disa herë pa u plotësuar. Gjithashtu, është deklaruar se puna për saktësimin e plotë të këtij regjistri vijon ende.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të vërtetojë hartimin dhe përfundimin e regjistrit të aktiveve afatgjata materiale sipas kërkesave të akteve rregullatorë në fuqi për llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, kullota, plantacione", 212 "Ndërtesa" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", me qëllim paraqitjen e informacionit kontabël të saktë në pasqyrat financiare. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar. Ky rekomandim nuk ri kërkohet pasi rekomandimi është** evidentuar edhe në auditimin financiar aktual te ushtruar sipas programit të auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë të kryejë kontabilizimet në llogarinë 212 "Ndërtesa" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", në përputhje me legjislacioni në fuqi dhe standardet kontabël, për të pasur informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht,
Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Financës ka deklaruar se po punon për saktësimin e regjistrit të aktiveve afatgjata, por ky proces nuk ka përfunduar ende për shkak të mungesës së specialistëve të inventarizimit të aseteve, ndërsa pozicionet vakante përkatëse rezultojnë të paplotësuara..
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të vërtetojë korrigjimin e trajtimeve kontabël të konstatuara gjatë auditimit, konkretisht ri klasifikimin e investimeve të kontabilizuara gabimisht në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" dhe llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", si dhe sistemimin e aktiveve që nuk plotësojnë kushtet e njohjes si aktive afatgjata ose të investimeve në proces që duhej të evidentoheshin në llogarinë 231 "Investime", në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë

09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme". Për sa më sipër, duke qenë se nuk provohet realizimi i korrigjimeve kontabël të rekomanduara dhe vetë subjekti deklaron se procesi vijon ende, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar. Ky rekomandim nuk ri kërkohet pasi rekomandimi është** evidentuar edhe në auditimin financiar aktual te ushtruar sipas programit të auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026.

11.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Financës ka deklaruar se po punon për saktësimin e regjistrit të aktiveve afatgjata, por procesi nuk ka përfunduar ende për shkak të mungesës së specialistëve të inventarizimit të aseteve. Sipas subjektit, pozicionet vakante përkatëse janë shpallur disa herë, ndërsa puna për saktësimin e plotë të regjistrit vijon ende
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të vërtetojë kryerjen e veprimeve kontabël të rekomanduara për njohjen dhe pasqyrimin në kontabilitet të pjesëmarrjeve në kapitalin e vet të Bashkisë Kolonjë në shoqëritë "KRWM" sha. dhe "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" sha., nëpërmjet debitimit të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" dhe kreditimit të llogarive financiare përkatëse, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018. Për sa më sipër, duke qenë se nuk provohet kryerja e regjistrimeve kontabël të rekomanduara dhe vetë subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që lidhet me zbatimin e rekomandimit, rekomandimi konsiderohet **i pazbatuar**. **Ky rekomandim nuk ri kërkohet pasi rekomandimi është** evidentuar edhe në auditimin financiar aktual te ushtruar sipas programit të auditimit nr. 383/1.prot., datë 09.04.2026.

12.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim, Kontroll territorit (Sektori i Menaxhimit të Kontratave), Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm, për likuidimin e garancisë së punimeve, të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të territorit dhe Mjedisit ka deklaruar se ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Financës duke vënë në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm për likuidimin e garancive të punimeve të kontratave të investimeve. Gjithashtu, Drejtoria e Financës ka deklaruar se ka ndërmarrë veprime për sistemimin e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", ka filluar procesin e likuidimit të garancive të punimeve dhe ka punuar për hartimin dhe përditësimin e listës analitike të kësaj llogarie.

Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion i plotë që të provojë sistemimin përfundimtar të llogarisë 466, kryerjen e rakordimeve mujore ndërmjet Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të territorit dhe Mjedisit, si dhe likuidimin e plotë të garancive për të gjitha kontratat e investimeve për të cilat kishte përfunduar afati i garancisë. Për rrjedhojë, nuk mund të vërtetohet përmbushja e plotë e objektivit të rekomandimit. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kolonjë të marrë masa në vijimësi, që kontabilizimet në llogaritë kontabël ti kryej në përputhje me dokumentacioni ligjor në dispozicion.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë, Drejtoria e Financës ka deklaruar se janë marrë masa për kryerjen e saktë të kontabilizimeve në llogaritë kontabël në përputhje me dokumentacionin ligjor në dispozicion, në kuadër të përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2025..
Komenti i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës vënë dispozicion dhe verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2025 u konstatua se janë kryer veprime konkrete kontabël për sistemimin e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm", korrigjimin e regjistrimeve të konstatuara gjatë auditimit për vlerën prej 5,235,200 lekë, për të cilën ishte konstatuar mungesë informacioni analitik dhe justifikues. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është i zbatuar.**

14.1. Rekomandimi: Sektori i Prokurimit Publik (Nj. P përkatëse) në Bashkinë Kolonjë, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të marrë masa t'i argumentojë teknikisht dhe ligjërisht ato duke pasur gjithmonë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, grafikun e punimeve, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, harmonizimin me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike, me qëllim për të garantuar trajtim të barabartë të OE, duke nxitur gjithashtu konkurrencën midis tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht
Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se janë marrë masa që për çdo procedurë prokurimi kërkesat dhe kriteret për kualifikim të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht, duke marrë në konsideratë tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit, grafikun e punimeve, preventivin dhe rekomandimet e APP-së
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të provojë zbatimin konkret të rekomandimit në procedurat e prokurimit të zhvilluara pas auditimit, si dokumente standarde të tenderit, argumentime teknike të kritereve të kualifikimit apo evidenca të tjera që të dëshmojnë korrigjimin e mangësive të konstatuara nga auditimi. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**

14.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë, të marrë masa, të analizojë me grup punë të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e B/OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST-ve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht
Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se janë marrë masa që Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të kryejnë kualifikimin vetëm të operatorëve ekonomikë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është vënë në dispozicion dokumentacion që të provojë krijimin e grupit të punës së kërkuar nga rekomandimi, analizimin e rasteve të konstatuara nga auditimi, evidentimin e përgjegjësive individuale apo marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës për kualifikimin e operatorëve ekonomikë që nuk plotësonin kriteret kualifikuese. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**

15.1. Rekomandimi:
-Personi përgjegjës për prokurimet të hartojë regjistrin e realizimit të prokurimeve me vlerë të vogël, duke mos iu shmangur rregullave të prokurimit publik. Të marrë masa për administrimin e relacioneve teknike ku të argumentohen sasitë e mallrave objekt prokurimit.
-Zyrtarët e përfshirë në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të hartojnë kritere që lidhen ngushtë me natyrën dhe objektin e zbatimit të kontratës, të kualifikojnë operatorë ekonomikë, që plotësojnë kërkesat e ftesës për ofertë DST dhe të hartojnë fondin limit të procedurave të prokurimit në bazë të metodave të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht
Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se janë marrë masa për hartimin e regjistrit të realizimit të prokurimeve me vlerë të vogël sipas kërkesave të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Gjithashtu, është deklaruar se janë marrë masa për hartimin e kritereve që lidhen me natyrën dhe objektin e kontratës, për kualifikimin e operatorëve ekonomikë që plotësojnë kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe për përllogaritjen e fondit limit sipas metodave të përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik..
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të provojë korrigjimin e mangësive të konstatuara gjatë auditimit, si: shmangien e praktikave të copëzimit të fondeve, administrimin e relacioneve teknike për argumentimin e sasive të mallrave objekt prokurimi, hartimin e kritereve të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, kualifikimin e operatorëve ekonomikë në përputhje me kërkesat e ftesës për ofertë, si dhe dokumentimin e metodave të përdorura për përllogaritjen e fondit limit. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**

16.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një drejtorie apo sektori të posaçëm për administrimin e aseteve publike, në përputhje me rregulloren e miratuar

dhe funksionet ligjore, me qëllim garantimin e organizimit institucional dhe koordinimit të proceseve të regjistrimit, inventarizimit dhe shfrytëzimit të pronave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht
Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë deklaron se ka parashikuar në strukturën organizative të viteve 2025 dhe 2026 dy pozicione specialistësh për menaxhimin e aseteve në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit të territorit dhe Mjedisit. Gjithashtu, rezulton se në muajin tetor 2025 këto pozicione janë shpallur vakante pranë AKPA-së dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Kolonjë, por nuk ka pasur aplikime nga kandidatë të interesuar, duke bërë që pozicionet të mbeten ende të paplotësuara..
Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi kërkonte ngritjen e një drejtorie apo sektori të posaçëm për administrimin e aseteve publike, me funksione të qarta për regjistrimin, inventarizimin dhe administrimin e pronave publike. Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton të jetë krijuar dhe funksionalizuar një strukturë e tillë organizative, por vetëm janë parashikuar dy pozicione specialistësh, të cilat vazhdojnë të jenë vakante. Pra nuk është realizuar objekti i tij kryesor, që lidhet me ngritjen dhe funksionimin e një strukture të posaçme për administrimin e aseteve publike. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**

16.2. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa të krijojë grupe punë të përhershme me përfaqësues teknike, juridikë dhe financiarë, për të kryer verifikimin fizik dhe juridik të pronave të paluajtshme (toka, ndërtesa, pyje, kullota), për përgatitjen e dokumentacionit të regjistrimit në ASHK dhe për hartimin e regjistrit kontabël të aseteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht
Përgjigja e subjektit: DPZHTM e ka vlerësuar të drejtë dhe në punën e saj në vazhdim do merren masa në vazhdimësi për ngritjen e një grupi punë të përhershëm me përfaqësues teknike, juridikë dhe financiarë, për të kryer verifikimin fizik dhe juridik të pronave të paluajtshme (toka, ndërtesa, pyje, kullota), për përgatitjen e dokumentacionit të regjistrimit në ASHK dhe për hartimin e regjistrit kontabël të aseteve**.**
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar asnjë dokumentacion mbështetës që të vërtetojë ngritjen e grupit të punës, miratimin e tij me akt administrativ, kryerjen e verifikimeve në terren, përgatitjen e dokumentacionit për regjistrim në ASHK apo hartimin e regjistrit kontabël të aseteve. Përgjigjja e subjektit përbën vetëm një deklarim për masa që do të ndërmerren në të ardhmen. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**

16.3. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa të përfundojë procesin e hartimit dhe miratimit të listave përfundimtare të pasurive për njësitë administrative që ende nuk e kanë këtë dokument, si dhe të identifikohen sipërfaqet e pashpërndara të tokës bujqësore dhe fondit pyjor/kullosor, për t'i regjistruar dhe përfshirë në menaxhim të rregullt ekonomik dhe financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka deklaruar se është në proces identifikimi të sipërfaqeve të pashpërndara të tokës bujqësore, si dhe të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, me qëllim regjistrimin dhe menaxhimin e tyre. Gjithashtu, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të territorit dhe Mjedisit ka deklaruar se do të marrë masa në vijimësi për përfundimin e procesit të hartimit dhe miratimit të listave përfundimtare të pasurive për njësitë administrative ku këto lista mungojnë, në bashkëpunim me ASHK-në dhe strukturat e tjera përkatëse.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion mbështetës që të vërtetojë përfundimin e procesit të hartimit dhe miratimit të listave përfundimtare të pasurive për njësitë administrative përkatëse, identifikimin e plotë të sipërfaqeve të pashpërndara të tokës bujqësore dhe fondit pyjor/kullosor, si dhe regjistrimin apo përfshirjen e tyre në administrim të rregullt ekonomik dhe financiar. Veprimet e raportuara nga subjekti përbëjnë masa në proces dhe jo rezultate të realizuara. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**

17.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa që të plotësojë me dokumentacionin e nevojshëm të gjitha dosjet e kontratave për dhënien me qira të aseteve që administron dhe kontratat që do të lidhen në të ardhmen, konkretisht: mbi procesin e regjistrimit të aseteve; procesin e dorëzimit të asetit; monitorimit mbi zbatueshmërinë e kushteve të kontratës dhe marrjes në dorëzim të asetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht
Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet shkresave nr. 6465.Prot., datë 13.11.2025 dhe nr. 642.Prot., datë 26.01.2026, me lëndë "Relacion mbi aktivitetin e subjekteve të tokave bujqësore të dhëna me qira nga Bashkia Kolonjë", ka hartuar dhe përcjellë informacion për subjektet që kanë lidhur kontrata qiraje për tokat bujqësore. Gjithashtu, është deklaruar se po punohet për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm të kontratave ekzistuese dhe të atyre që do të lidhen në të ardhmen, si dhe janë administruar procesverbalet e dorëzimit të pasurive për subjektet që kanë përfituar toka bujqësore të pandara.
Po ashtu, Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit ka raportuar se, në zbatim të urdhrave të Kryetarit të Bashkisë, ka kryer monitorimin e zbatimit të kushteve kontraktuale, si dhe procedurat e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të aseteve për kontratat në fondin pyjor dhe kullosor, duke raportuar periodikisht pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk është administruar dokumentacion i plotë që të provojë se të gjitha dosjet e kontratave të qirasë janë plotësuar me dokumentacionin e kërkuar nga rekomandimi, përfshirë dokumentacionin mbi regjistrimin e aseteve, dokumentimin e gjendjes fizike të tyre, procesverbalet e marrjes në dorëzim në përfundim të kontratave dhe monitorimin e plotë për të gjitha asetet e dhëna me qira. Pra janë ndërmarrë veprime konkrete në drejtim të zbatimit të tij, por nuk provohet përmbushja e plotë e të gjitha kërkesave të rekomandimit. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**

18.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të territorit, Bashkia Kolonjë, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi:
- Të kërkojnë ngarkimin e plotë të dokumentacionit të detyrueshëm gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, siç janë: licenca për ushtrimin e aktivitetit, polica e sigurimit e përgjegjësisë profesionale, certifikata e regjistrimit në qendrën Kombëtare të Biznesit për hartuesit e projekteve ndërtimore, etj.
- Të shqyrtojë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;
- Të sigurohet që gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi, dokumentacioni i pronësisë të jetë i rifreskuar brenda një periudhe jo më të gjatë se tre muaj nga data e aplikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht
Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të territorit dhe Mjedisit (DPZHTM) ka deklaruar se ka marrë masa për të siguruar ngarkimin e plotë të dokumentacionit të detyrueshëm në aplikimet për leje ndërtimi, respektimin e afateve ligjore për shqyrtimin e aplikimeve dhe nxjerrjen e vendimeve, si dhe administrimin e dokumentacionit të pronësisë të rifreskuar brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk u administrua dokumentacion mbështetës që të provojë zbatimin efektiv të këtyre masave, si dosje aplikimesh të shqyrtuara pas lënies së rekomandimit, evidenca mbi verifikimin e dokumentacionit të detyrueshëm, respektimin e afateve ligjore të trajtimit të aplikimeve apo dokumente pronësie të rifreskuara sipas kërkesave ligjore. Pra, subjekti ka paraqitur vetëm deklarime mbi masat e marra, pa dokumentacion provues që të vërtetojë zbatimin konkret të rekomandimit. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është pjesërisht i zbatuar.**
19.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të territorit, Bashkia Kolonjë, në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, të merren të gjitha masat për të kërkuar mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, informacion i cili përcillet nëpërmjet sistemit "e-lejet", në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Gjithashtu, të respektohet në çdo rast mendimi i autoriteteve kompetente, të cilat shprehen brenda fushës së kompetencave që u njeh ligji, në lidhje me aplikimet për leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të territorit dhe Mjedisit (DPZHTM) ka deklaruar se, në rastet e miratimit në heshtje nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ka kërkuar me shkresë zyrtare mendim dhënien për aplikimet për leje ndërtimi dhe se ka respektuar mendimet e autoriteteve të tjera përgjegjëse të shprehura nëpërmjet sistemit "e-Leje".
Komenti i grupit të auditimit: Nuk u administrua dokumentacion mbështetës që të provojë zbatimin konkret të rekomandimit, si dosje aplikimesh të trajtuara pas lënies së rekomandimit, korrespondencë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, mendime të administruara në sistemin "e-Leje" apo evidenca që vërtetojnë respektimin e mendimeve të autoriteteve kompetente gjatë procesit të shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit. Pra subjekti ka paraqitur vetëm

deklarime mbi masat e marra, pa dokumentacion provues që të vërtetojë zbatimin efektiv të rekomandimit. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe nuk **është i zbatuar.**

20.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për rekrutimin dhe plotësimin e strukturës së IMTV-së me punonjës me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:

Përgjigja e subjektit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka deklaruar se do të marrë masa për rekrutimin dhe plotësimin e strukturës së IMTV-së me punonjës me formim profesional të fushës, duke argumentuar se mungesa e burimeve njerëzore ka ndikuar në mosplotësimin e strukturës. Gjithashtu është deklaruar se brenda vitit 2026 do të shpallet vendi vakant për pozicionin e inspektorit.

Komenti i grupit të auditimit: Nuk u administrua dokumentacion që të provojë plotësimin efektiv të strukturës së IMTV-së, emërimin e punonjësve me formimin profesional të kërkuar nga legjislacioni në fuqi apo realizimin e procedurave të rekrutimit që do të çonin në zbatimin e rekomandimit. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**

21.1. Rekomandimi: Struktura e IMTV-së pranë Bashkisë Kolonjë të marrë masa për përgatitjen e raportimeve periodike mbi ecurinë e veprimtarisë së saj dhe t'i paraqesë ato pranë titullarit të institucionit. Gjithashtu, Kryeinspektori i IMTV-së duhet të hartojë dhe dorëzojë në mënyrë të rregullt raportet tremujore dhe vjetore pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së territorit (IKMT), në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë, Kryeinspektori deklaron se ka përgatitur raportimet periodike mbi ecurinë e veprimtarisë e IMTV-së dhe i ka paraqitur ato pranë Kryetarit të Bashkisë. Gjithashtu deklaron se, Kryeinspektori i IMTV-së do të mare masat për vitin 2026 të hartojë dhe dorëzojë në mënyrë të rregullt raportet tremujore dhe vjetore pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së territorit (IKMT), në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Komenti i grupit të auditimit: Nuk u administrua asnjë dokumentacion mbështetës që të provojë përgatitjen dhe paraqitjen e raporteve periodike mbi ecurinë e veprimtarisë së IMTV-së pranë Kryetarit të Bashkisë, si dhe hartimin dhe dërgimin e raporteve tremujore apo vjetore pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së territorit (IKMT).Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është pjesërisht i zbatuar.**

22.1. Rekomandimi: IMTV Bashkia Kolonjë, të marrë masa të sigurojë dokumentimin e detajuar, me foto ose video, të të gjitha procedurave të konstatimit të kundërvajtjeve dhe të prishjes së ndërtimeve pa leje. Gjithashtu, Kryeinspektori të vijojë me nxjerrjen e Urdhrave të Ekzekutimit për rastet me vendim për prishje objekti të kundërligjshëm dhe në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme në hapësira publike, të kryejë përllogaritjen e dëmit dhe të njoftojë subjektin për detyrimin e rikthimit të territorit në gjendjen e mëparshme, në natyrë ose në vlerë monetare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: IMTV Bashkia Kolonjë ka deklaruar se janë nxjerrë urdhrat e ekzekutimit për rastet e prishjes së objekteve dhe se puna vijon
Komenti i grupit të auditimit: Nuk u administrua dokumentacion mbështetës që të provojë zbatimin e rekomandimit lidhur me dokumentimin fotografik ose me video të procedurave të konstatimit të kundërvajtjeve dhe të prishjes së ndërtimeve pa leje, nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit për të gjitha rastet me vendim prishjeje, si dhe kryerjen e përllogaritjes së dëmit dhe njoftimin e subjekteve për rikthimin e territorit në gjendjen e mëparshme. Pra nuk ka paraqitur dokumentacion provues, si urdhra ekzekutimi, procesverbale të prishjes, dokumentim fotografik ose filmik, evidenca të përllogaritjes së dëmit apo njoftime drejtuar subjekteve përkatës. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti **dhe nuk është i zbatuar.**
23.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV-së Bashkia Kolonjë, të vijojë procedurën për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë", për subjektet që janë me procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi të mbajtura nga inspektorët.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Subjekti ka deklaruar se janë nxjerrë vendime nga Kryeinspektori i IMTV-së dhe se procedura për nxjerrjen e vendimeve të dënimit me gjobë vijon për subjektet e tjera.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk u administrua dokumentacion mbështetës që të provojë vijimin e procedurës administrative për nxjerrjen e vendimeve të dënimit me gjobë ndaj subjekteve për të cilat janë mbajtur procesverbale konstatimi për ndërtime pa leje nga inspektorët e IMTV-së. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është i zbatuar.**
24.1. Rekomandimi: IMTV Kolonjë, gjatë arkëtimit, për të gjithë "Vendimet me Gjobë" që do të mbajë në vazhdim, të kërkojë edhe kamatë vonese bazuar në llogaritjen e masës së gjobës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: IMTV Bashkia Kolonjë deklaron se lidhur me një rast konkret kundërvajtjeje administrative për subjektin E B, janë mbajtur Procesverbali Nr. 22, datë 25.07.2025 "Për konstatimin e kundërvajtjes", Procesverbali Nr. 15, datë 06.08.2025 "Për dënimin me gjobë", si dhe është dërguar akti administrativ "Njoftim për ekzekutim" i masës së gjobës. Subjekti i ka ankimuar pranë Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë, jemi akoma në proces.
Komenti i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton që të jetë kryer përllogaritja dhe kërkimi i kamatëvonesës mbi masën e gjobës, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se masa administrative është ankimuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe çështja vijon të jetë në proces shqyrtimi. Për sa më sipër, **rekomandimi konsiderohet i pazbatuar**, pasi nuk u administrua dokumentacion që të vërtetojë llogaritjen dhe

aplikimin e kamatëvonesës gjatë arkëtimit të gjobave, sipas kërkesave të rekomandimit dhe legjislacionit në fuqi.

25.1. Rekomandimi: IMTV Bashkia Kolonjë, për të gjitha rastet në vijim, kur vendos masën administrative "dënim me gjobë", në akt-konstatim të referojë të dhëna të mjaftueshme, si: materialet e përdorura, përmasat, etj., në mënyrë që të bëhet e mundur kryerja e përllogaritjes së saktë të vlerës së masës administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës.

Komenti i grupit të auditimit: Nuk u administrua dokumentacion mbështetës që të provojë zbatimin e rekomandimit në praktikë, si akt-konstatime të hartuara pas lënies së rekomandimit, në të cilat të jenë pasqyruar të dhëna të plota dhe të mjaftueshme mbi karakteristikat e ndërhyrjes së kundërligjshme, materialet e përdorura, përmasat, sipërfaqet apo elementë të tjerë teknike, të nevojshëm për përllogaritjen e saktë të vlerës së masës administrative "dënim me gjobë". Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**, pasi subjekti ka deklaruar marrjen e masave, por nuk ka paraqitur evidenca dhe dokumentacion konkret që të vërtetojë zbatimin efektiv të tij në rastet e trajtuara pas auditimit.

26.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV-së të marrë masa në vijimësi, që me nxjerrjen e vendimeve të mëtejshme brenda afatit 10-ditor për të gjitha rastet ku Inspektorët në terren kanë mbajtur akt-konstatime për ndërtime pa leje, duke respektuar procedurat e parashikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit lidhur me respektimin e afateve ligjore për nxjerrjen e vendimeve nga Kryeinspektori i IMTV-së.

Komenti i grupit të auditimit: IMTV Bashkia Kolonjë nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës që të provojë zbatimin efektiv të rekomandimit, si raste konkrete të trajtuara pas lënies së rekomandimit, ku të evidentohet se vendimet përkatëse janë nxjerrë brenda afatit 10-ditor nga data e mbajtjes së akt-konstatimit për ndërtimet pa leje. Në mungesë të evidencave dokumentare që vërtetojnë respektimin e afateve procedurale të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, grupi i auditimit nuk mund të krijojë siguri të arsyeshme mbi zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është pjesërisht i zbatuar.**, pasi janë deklaruar masa administrative për zbatimin e tij, por nuk është paraqitur dokumentacion provues që të vërtetojë respektimin në praktikë të afatit ligjor 10-ditor për nxjerrjen e vendimeve nga Kryeinspektori i IMTV-së.

27.1. Rekomandimi: Në të gjitha rastet, kur nga struktura e IMTV Kolonjë konstatohen punime pa leje ndërtimi, të referohen me kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:

Përgjigja e subjektit: IMTV, Bashkia Kolonjë ka deklaruar se janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit lidhur me respektimin e kritereve ligjore.
Komenti i grupit të auditimit: IMTV, Bashkia Kolonjë nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës që të provojë se, në rastet e konstatuara pas lënies së rekomandimit, struktura e IMTV-së ka referuar me kallëzim penal pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë rastet e ndërtimeve pa leje, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Nuk u administruan shkresa kallëzimi penal, prova të depozitimit të tyre pranë organit të prokurorisë apo evidenca të tjera që të vërtetojnë ndjekjen e procedurës së rekomanduar. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**, pasi subjekti ka deklaruar marrjen e masave, por nuk ka paraqitur dokumentacion provues që të vërtetojë referimin me kallëzim penal të rasteve të konstatuara me ndërtime pa leje.

28.1. Rekomandimi: IMTV të marrë masa të ndjekë procedurat ligjore për ekzekutimin e masave administrative, duke dërguar fillimisht "Njoftimit për shlyerje vullnetare të detyrimit" ndaj kundërvajtësve. Gjithashtu, të intensifikojë bashkëpunimin dhe koordinimin me Sektorin Juridik të Bashkisë Kolonjë për ndjekjen e mëtejshme të procedurave ligjore dhe paraqitjen në gjykatë të kërkesave për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit. Në rastet kur detyrimet nuk shlyhen në mënyrë vullnetare, çështjet të referohen pranë Zyrës së Përmbarimit Shtetëror, me qëllim rritjen e të ardhurave nga veprimtaria inspektuese.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: IMTV, Bashkia Kolonjë ka deklaruar se çështjet paraprake po ndiqen në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë Juridike të Bashkisë Kolonjë.
Komenti i grupit të auditimit: Nuk u administrua dokumentacion mbështetës që të provojë zbatimin e rekomandimit, si njoftime për shlyerje vullnetare të detyrimeve të dërguara ndaj kundërvajtësve, kërkesa të depozituara në gjykatë për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit apo dokumentacion që vërteton referimin e rasteve pranë Zyrës së Përmbarimit Shtetëror për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve të pashlyera. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është pjesërisht i zbatuar**, pasi subjekti ka deklaruar ndjekjen e çështjeve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, por nuk ka paraqitur evidenca dhe dokumentacion konkret që të vërtetojë ndjekjen e procedurave ligjore të rekomanduara për ekzekutimin e masave administrative dhe arkëtimin e detyrimeve përkatëse.
29.1. Rekomandimi: Zyra e kontrollit të territorit, Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, për kryerjen e inspektimeve duke përdorur dokumentet standard të procedurës së inspektimit. Gjithashtu të hartojë dhe përcjellë për miratim pranë Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, planin vjetor të aktivitetit. Drejtoria e Urbanistikës dhe Zyra e Kontrollit Bashkia Kolonjë të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe Zyra e Kontrollit, me qëllim miratimin e akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Kolonjë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se po merren masa për unifikimin e procedurave dhe bashkërendimin e punës ndërmjet strukturave përkatëse.
Komenti i grupit të auditimit: Bashkia Kolonjë nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës që të vërtetojë zbatimin e rekomandimit, si dokumente standarde të procedurave të inspektimit të përdorura në praktikë, plan vjetor aktiviteti të hartuar dhe miratuar, evidenca të shkëmbimit të informacionit ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe strukturës së kontrollit të territorit, apo dokumentacion që provon informimin sistematik të kësaj strukture për lejet e ndërtimit dhe deklaratat paraprake të miratuara.
Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është pjesërisht i zbatuar**.

30.1. Rekomandimi: Struktura e IMTV-së, të marrë masa, që në të ardhmen të administrojë në çdo dosje, ecurinë e procedurave të ndjekura rast pas rasti, në mënyrë që të lihet edhe gjurma e auditimit. Në vijim, procesverbalet (PVK, vendim gjobe, vendim pezullimi, vendim prishje), të firmosen nga inspektorët e pranishëm (apo kryeinspektori). Procesverbali të mbahet në vendin e kryerjes së kundërvajtjes dhe në kohën e konstatimit të saj, si rregull, në prani të kundërvajtësit dhe të dëshmitarëve të pranishëm dhe nënshkruhet nga përpiluesi, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se janë marrë masa për administrimin dhe nënshkrimin e rregullt të procesverbaleve lidhur me veprimtarinë e IMTV-së, përfshirë vendimet e gjobës, pezullimit, prishjes dhe kallëzimet penale.
Komenti i grupit të auditimit: Bashkia Kolonjë nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës që të vërtetojë zbatimin e rekomandimit, si dosje të plota administrative për rastet e trajtuara pas lënies së rekomandimit, evidenca mbi administrimin e dokumentacionit sipas kërkesave të legjislacionit arkivor, apo procesverbale të hartuara dhe nënshkruara rregullisht nga të gjithë personat e përcaktuar në legjislacionin përkatës. Gjithashtu, nuk u administruan prova që të vërtetojnë se procesverbalet mbahen në vendin dhe kohën e konstatimit të kundërvajtjes, si dhe se ato nënshkruhen nga përpiluesi, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, sipas kërkesave ligjore.
Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është pjesërisht i zbatuar**, pasi subjekti ka deklaruar marrjen e masave, por nuk ka paraqitur evidenca dhe dokumentacion konkret që të provojë administrimin e plotë të dosjeve të procedurave dhe respektimin e kërkesave ligjore për hartimin dhe nënshkrimin e dokumentacionit inspektues.

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:
- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 23 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 23 masa. Nga masat e pranuara janë zbatuar pjesërisht 5 masa,, zbatuar 3 masa dhe pa zbatuar 15 masa. *Nga 20 masa organizative të cilësuara si të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht 20 prej tyre nuk ri kërkohen pasi janë* pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual.
- Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 4 masa me vlerë 20,969,993 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga masat e pranuara 3 masa nuk janë zbatuar dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht.

- Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhura të munguara janë rekomanduar 2 masa, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 2 masat e pranuara rezulton 1 masë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë pa zbatuar. *Nga 2 masa organizative të cilësuara si të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht 2 prej tyre nuk ri kërkohen pasi janë* pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual respektivisht rekomandimet:
- Janë rekomanduar 3 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet si më poshtë;
Sipas "Ligjit për Nëpunësin Civil" i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Kolonjë që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për 3 punonjës. *Nga 3 masa disiplinore të cilësuara si të pa zbatuara 3 prej tyre nuk ri kërkohen pasi janë* pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual.
Nga verifikimi rezulton se nuk janë marrë masa disiplinore ndaj punonjësve. Statusi i këtij rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.
-Për marrjen e 4 masave administrative nga IMT Bashkia Kolonjë, ndaj 4 subjekteve, nuk është zbatuar asnjë prej tyre.
Nisur nga sa më sipër, *veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15, "Të drejtat e KLSH" të ligjit Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe (150-186) të Raportit të Auditimit).*

31.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë

Masa për shpërblimin e dëmit të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.683/26.prot, datë 23.05.2022

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **942,303 lekë pa TVSH** nga shoqëria BOE "A. "& "4." ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 2104.Prot., datë 08.06.2020 me objekt "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut" Bashkia Kolonjë.

1.2. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup punë të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe grupin e kolaudimit të punimeve si dhe Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizime Sha Kolonjë në cilësinë e administrimit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pa vendosura në objekt.
-Gjithashtu të marrë masa për vendosjen e pajisjeve dhe funksionimin e scadës, në të kundërt arkëtimin e vlerës **4,390,946 lekë.**

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup punë të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera, me qëllim arkëtimin e vlerës **1,264,272 lekë.**

3.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **1,323,023 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE "A K" ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 1022.Prot., datë 25.02.2021 me objekt "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës" Bashkia Kolonjë.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **290,800 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE "A." ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 5151.Prot., datë 29.10.2020 me objekt "Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit" Bashkia Kolonjë.

Masa për shpërblimin e dëmit ekonomik të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.1025/9, datë 22.05.2023.

Rekomandimi 2.1: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **732,989** lekë pa TVSh nga BOE "A." SHPK & "E. K" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2626.Prot, datë 07.08.2019, me objekt "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", Ersekë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Rekomandimi 3.1: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **218,243** lekë pa TVSh nga BOE "Z." SHPK & "K." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5318.Prot, datë 05.11.2020, me objekt "Rikonstruksion i pjesshëm i godinës së Bashkisë Ersekë", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Rekomandimi 4.1: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së territorit të Bashkisë Kolonjë të marren masa të menjëhershme për vendosjen e masës së gjobës si dhe nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit të merren masa të menjëhershme duke nxjerrë aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total **523,391** lekësh.

Rekomandimi 5.1: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit të merren masa të menjëhershme për ndjekjen e procedurave për vjeljen e detyrimit që ka lindur nga keq llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **428,264** lekë ndaj subjektit me NIPT K..K "A K U-K".

Masa për shpërblimin e dëmit ekonomik të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.186/19, datë 25.07.2024.

Rekomandimi 1.1: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,939 mijë lekë pa TVSH** nga BOE "R." SHPK & "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5885.prot., datë 06.12.2023, me objekt "Rehabilitimi i digës së rezervuarit Gjonçit, Bashkia Ersekë".

Rekomandimi 2.1: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë/Sektorin Juridik, Bashkia Kolonjë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **1,515,106 lekë pa TVSH** nga kontraktori OE "Z.", për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Rekomandimi 3.1: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë/Sektorin Juridik, Bashkia Kolonjë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **1,574,784 lekë pa TVSh** nga kontraktori BOE "Z." & "K.", për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Rekomandimi 4.1: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë/Sektorin Juridik, Bashkia Kolonjë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **331,000 lekë pa TVSH** nga kontraktori OE "Z.", për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Masa administrative për Inspektoratin e Mbrojtjes territorit, (IMT), të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.186/19, datë 25.07.2024.

1. Subjekti **OE "V E" shpk,** përfaqësuar nga administrator z. M. Sh, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën me objekt: "*Rikonstruksioni i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtimi prita malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë"*, datë 06.12.2023, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **21,058,924 lekë me TVSH**.
2. Subjekti **OE "T H C" shpk**, përfaqësuar nga administrator z. E. C, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën me objekt: "*Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë "Porta e Rehovës",* datë 27.07.2022, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **1,818,127 lekë me TVSH**.
3. Subjekti **OE "L C" ShPK**, përfaqësuar nga administrator z. A. K, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën me objekt: "*Rikualifikim i rrugës "Pali Prifti" Qyteti Ersekë"*, datë 12.07.2021, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **1,898,740 lekë me TVSH**.
4. Subjekti **OE "S." ShPK**, përfaqësuar nga administrator z. E. L, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën me objekt: "*Rikonstruksioni i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë"*, datë 15.09.2022, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **397,200 lekë me TVSH**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë këto veprime në drejtim të zbatimit të rekomandimit. Konkretisht:
Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë një sërë veprimesh administrative dhe ligjore në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të ri kërkuara nga auditimet e mëparshëm. Konkretisht, me urdhrat nr. 562, 563, 564, 565, 566 dhe 567, datë 10.11.2025, të Kryetarit të Bashkisë, janë ngritur komisione për ndjekjen e procedurave të arkëtimit të dëmit ekonomik dhe janë iniciuar procedurat përkatëse administrative dhe gjyqësore. Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike ka depozituar kërkesë-padi pranë gjykatave kompetente ndaj operatorëve ekonomikë dhe subjekteve përfitues të fondeve publike, ndërsa Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e të Ardhurave kanë kryer veprime për lëshimin e faturave për arkëtim dhe dërgimin e njoftimeve për ekzekutim vullnetar.
Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me:
Për Përmirësimin e gjendjes: 23 masave organizative të rekomanduara për përmirësimin e gjendjes, nga të cilat janë pranuar plotësisht 23 masa. Nga masat e pranuara janë zbatuar pjesërisht 5 masa,, zbatuar 3 masa dhe pa zbatuar 15 masa. *Nga 20 masa organizative të cilësuara si të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht 20 prej tyre nuk ri kërkohen pasi janë* pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual.
Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 4 masa me vlerë 20,969,993 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga masat e pranuara 3 masa nuk janë zbatuar dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht.
Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencës dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhura të munguara janë rekomanduar 2 masa, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 2 masat e pranuara rezulton 1 masë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë pa zbatuar. *Nga 2 masa organizative të cilësuara si*

të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht 2 prej tyre nuk ri kërkohen pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual respektivisht rekomandimet:
Janë rekomanduar 3 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet si më poshtë;
Sipas "Ligjit për Nëpunësin Civil" i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Kolonjë që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për 3 punonjës. *Nga 3 masa disiplinore të cilësuara si të pa zbatuara 3 prej tyre nuk ri kërkohen pasi janë* pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual.
Nga verifikimi rezulton se nuk janë marrë masa disiplinore ndaj punonjësve. Statusi i këtij rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.
Për marrjen e 4 masave administrative nga IMT Bashkia Kolonjë, ndaj 4 subjekteve, nuk është zbatuar asnjë prej tyre.
u konstatua se gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë veprime konkrete për ndjekjen e procedurave të rikuperimit të dëmit ekonomik dhe ekzekutimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Megjithatë, nuk rezulton që detyrimet objekt rekomandimi të jenë arkëtuar përfundimisht në favor të Bashkisë Kolonjë, ndërsa një pjesë e çështjeve vijojnë të jenë në proces administrativ ose gjyqësor. Për sa më sipër, rekomandimet konsiderohen të pranuara dhe **pjesërisht të zbatuara**, pasi janë ndërmarrë veprime konkrete dhe të dokumentuara për zbatimin e tij, por nuk është arritur ende rezultati përfundimtar i rikuperimit të plotë të vlerave të rekomanduara dhe përmbyllja e të gjitha procedurave përkatëse.

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa të menjëhershme për verifikimin dhe përditësimin e sipërfaqeve reale të ndërtesave për të gjitha subjektet aktive, bazuar në inspektime në terren dhe dokumentacion zyrtar. Për subjektet J H me NIPT L..L; A 91 me NIPT L...J; 6 K me NIPT K...T të kryej përditësimin e të dhënave mbi sipërfaqen e ndërtesës dhe të arkëtojë vlerën përkatëse. Gjithashtu, të nisë procesin e regjistrimit dhe detyrimit për pagesë të të gjitha subjekteve që kanë kontrata qiraje mbi pasuri të bashkisë, pavarësisht nëse kanë apo jo NIPT, duke përfshirë edhe ato me NIPT aktiv të cilat deri më sot nuk janë përfshirë në regjistrin tatimor vendor. Po ashtu, të marrë masa për rakordime ndërinstitucionale midis QKB dhe DRT për të garantuar që çdo subjekt aktiv në territorin e Bashkisë Kolonjë të jetë i regjistruar, i vlerësuar dhe i faturuar sipas ligjit për detyrimet vendore.

Brenda datës 31.12.2025

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se nuk është marrë asnjë masë.
Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nuk rezultoi të jetë paraqitur dokumentacion mbështetës që të provojë ndërmarrjen e veprimeve konkrete për zbatimin e rekomandimit. Konkretisht, nuk rezulton të jenë kryer verifikime dhe përditësime të sipërfaqeve reale të ndërtesave për subjektet J H me NIPT L..L, A 91 me NIPT L...J dhe 6 K me NIPT K...T, nuk evidentohet arkëtimi i detyrimeve përkatëse, si dhe nuk është paraqitur dokumentacion që të provojë regjistrimin në sistemin/regjistrin format Excel apo fizik tatimor vendor të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në pasuri të marra me qira apo kryerjen e rakordimeve me qendrën Kombëtare të Biznesit.

dhe Drejtorinë Rajonale të Tatimeve. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**, pasi subjekti nuk ka paraqitur prova dokumentare që vërtetojnë marrjen e masave dhe realizimin e veprimeve të kërkuara në rekomandim.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave dhe strukturave të tjera përgjegjëse, të marrë masa për të përditësuar dhe përmirësuar regjistrin e familjeve tatimpaguese në përputhje me të dhënat e gjendjes civile dhe të përjashtimeve të miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak. Të rishikojë metodologjinë e planifikimit të të ardhurave për këtë kategori në mënyrë që të bazohet në të dhëna reale dhe të verifikueshme, si dhe të ndërtojë një sistem evidentimi që mundëson ndarjen e detyrimeve të vitit aktual nga detyrimet e mbartura. Të përfshihen në planifikim të gjitha familjet rezidente që nuk përfitojnë përjashtime ligjore dhe të rishikohet sistemi i përllogaritjes së tarifave në mënyrë që të pasqyrojë saktë ngarkesën fiskale. Po ashtu, të merren masa për përmirësimin e menaxhimit të regjistrit elektronik në përputhje me kuadrin rregullator për të garantuar transparencë, kontroll dhe përputhshmëri me kuadrin ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se nuk është marrë asnjë masë.

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nuk rezultoi të jetë paraqitur dokumentacion mbështetës që të provojë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit. Konkretisht, nuk rezulton të jetë kryer përditësimi i regjistrit të familjeve tatimpaguese në përputhje me të dhënat e gjendjes civile dhe përjashtimet e miratuara nga Këshilli Bashkiak, nuk evidentohet rishikimi i metodologjisë së planifikimit të të ardhurave për kategorinë "Familjarë", si dhe nuk është paraqitur dokumentacion që të provojë ngritjen e një sistemi evidentimi për ndarjen e detyrimeve të vitit ushtrimor nga detyrimet e mbartura. Gjithashtu, nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprime për përfshirjen në planifikim të të gjitha familjeve rezidente që nuk përfitojnë përjashtime ligjore dhe as për përmirësimin e regjistrit elektronik në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**, pasi subjekti nuk ka paraqitur prova dokumentare që vërtetojnë marrjen e masave dhe realizimin e veprimeve të kërkuara në rekomandim.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, strukturat përgjegjëse të marrin masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, duke evidentuar saktësisht të gjithë sipërfaqen e tokës në përdorim dhe duke identifikuar përdoruesit aktualë, përfshirë ato familje që kanë hequr dorë për efekt taksimi, por vijojnë të përfitojnë nga shfrytëzimi i tokës. Të përditësohet regjistri i AMTP-ve, të kryhet rakordimi midis të dhënave të drejtorisë së bujqësisë, drejtoria e të ardhurave dhe strukturat në terren, dhe të përfshihen në planifikim detyrimet e pa mbledhura për periudhën e mëparshme si dhe sipërfaqet shtesë të shpërndara. Po ashtu, të merren masa për analizën e trendit të arkëtimeve dhe përmirësimin e nivelit të mbledhjes së taksave për këtë zë, veçanërisht në njësitë administrative me debitë më të larta.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se do të ndërmarrë masa për evidentimin dhe përditësimin e sipërfaqeve të tokës bujqësore në përdorim, identifikimin e përdoruesve aktualë, përditësimin e regjistrit të AMTP-ve, kryerjen e rakordimeve ndërmjet strukturave përgjegjëse, përfshirjen në planifikim të detyrimeve të pa mbledhura dhe monitorimin e njësive administrative me nivel të lartë debie.

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka paraqitur vetëm deklarime dhe masa të planifikuara për përmirësimin e procesit të administrimit të taksës së tokës bujqësore, pa shoqëruar këto deklarime me dokumentacion mbështetës që të provojë se këto veprime janë realizuar në praktikë. Nuk rezultojnë evidenca mbi përditësimin e regjistrave, procesverbalet e verifikimeve në terren, rakordimet e kryera ndërmjet drejtorive përkatëse, identifikimin e përdoruesve realë të tokës, përfshirjen e sipërfaqeve shtesë dhe detyrimeve të prapambetura në planifikim apo analiza konkrete mbi përmirësimin e nivelit të arkëtimit të kësaj takse. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**, pasi subjekti nuk ka paraqitur prova dokumentare që vërtetojnë realizimin e masave të kërkuara dhe arritjen e rezultateve konkrete në zbatim të rekomandimit.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për ndërtimin dhe zbatimin e një strategjie të posaçme për administrimin dhe uljen e detyrimeve të prapambetura, përmes analizës individuale të detyrimeve të prapambetura për çdo tatimpagues, evidentimit të shkaqeve të mospagimit, dhe përdorimit të mjeteve ligjore dhe administrative për rikuperimin e borxheve. Të hartohen planë vjetore dhe mujore për ndjekjen e arkëtimeve, të intensifikohet komunikimi me debitorët dhe të aplikohen penalitete ligjore kur është e nevojshme, përfshirë ndërprerjen e marrëdhënieve kontraktuale për shfrytëzimin e aseteve publike. Po ashtu, të përmirësohet raportimi dhe monitorimi i ecurisë së borxhit për të siguruar transparencë dhe kontroll efektiv mbi të ardhurat vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se janë marrë masa dhe veprime që lidhen me evidentimin, planifikimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.
Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka deklaruar se janë marrë masa dhe veprime që lidhen me evidentimin, planifikimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, por ato nuk adresojnë problematikat e evidentuara në rekomandim lidhur me analizën e debitorëve, administrimin e borxhit tatimor dhe ndjekjen e detyrimeve të prapambetura. Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton të jetë hartuar një strategji për administrimin e borxhit, nuk evidentohet kryerja e analizave individuale për secilin debitor, identifikimi i shkaqeve të mos pagesës, hartimi i planeve mujore dhe vjetore për arkëtimin e detyrimeve, aplikimi i masave administrative dhe ligjore për rikuperimin e borxhit apo monitorimi periodik i ecurisë së detyrimeve të prapambetura. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**, pasi veprimet e deklaruara nga subjekti nuk lidhen me objektin e rekomandimit dhe nuk është paraqitur dokumentacion provues që të vërtetojë marrjen dhe zbatimin e masave të kërkuara.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, strukturat përgjegjëse për përmirësimin e ndjekjes së kontratave dhe uljes së borxhit të marrin masa për forcimin e ndjekjes së zbatimit të kontratave të qirasë nëpërmjet krijimit të një mekanizmi të efikas për kontrollin periodik të shlyerjes së detyrimeve, përditësimin në kohë reale të regjistrave kontabël si dhe evidentimin e subjekteve debitorë. Duhet të hartohen planë-veprimesh për uljen graduale të debitit dhe të merren masa konkrete administrative dhe/ose ligjore për rikuperimin e të ardhurave të munguara nga subjektet qiramarrëse, përfshirë edhe aplikimin e penaliteteve për vonesa sipas përcaktimeve kontraktuale respektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë ka deklaruar se ka marrë masa për përmirësimin, ndjekjen dhe administrimit e kontratave të qirasë, evidentimin e kontratave aktive, përditësimin e regjistrave financiarë dhe ndjekjen e subjekteve debitorë. Në vijim, Bashkia Kolonjë do të forcojë mekanizmat e kontrollit dhe verifikimit të kontratave të qirasë, me qëllim administrimin sa më efektiv të aseteve publike dhe shmangien e krijimit të detyrimeve të reja debitorë.
Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka paraqitur vetëm deklarime mbi marrjen e masave për përmirësimin e ndjekjes dhe administrimit të kontratave të qirasë, evidentimin e kontratave aktive, përditësimin e regjistrave financiarë dhe ndjekjen e subjekteve debitorë. Megjithatë, nuk u administrua dokumentacion mbështetës që të vërtetojë funksionimin e një mekanizmi efektiv për kontrollin periodik të kontratave të qirasë, hartimin e planeve të veprimit për uljen e debisë, aplikimin e masave administrative ose ligjore ndaj subjekteve debitorë, aplikimin e penaliteteve kontraktuale apo rikuperimin e detyrimeve të prapambetura. Gjithashtu, nuk u paraqitën evidenca që të provojnë uljen e nivelit të debisë së konstatuar në auditim në vlerën 10,978,973 lekë apo arkëtimin e të ardhurave të munguara nga kontratat e qirasë. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**, pasi masat e deklaruara nuk janë mbështetur me dokumentacion provues dhe nuk evidentohet realizimi konkret i kërkesave të përcaktuara në rekomandim.

5.2 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë strukturat përgjegjëse të rishikojë praktikat aktuale për lidhjen e kontratave të reja të qirasë, ku në to të përfshijë klauzola me afate të qarta për fillimin e shfrytëzimit dhe arkëtimin e të ardhurave. Në kontratat e reja të qirasë, duhet të shmangen periudhat pasive nga hartimi i kontratës deri në fillimin e punimeve, ku prona është e dhënë me qira por nuk krijon të ardhura. Gjithashtu, çdo ndryshim i destinacionit të pasurisë duhet të kryhet me procedura dhe dokumentacion përkatës që justifikon kalimin e pasurisë nga pyll/kullotë në truall, në përputhje me kuadrin ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë nuk ka paraqitur asnjë informacion, dokumentacion mbështetës apo evidencë që të provojë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit.
Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë nuk ka paraqitur asnjë informacion, dokumentacion mbështetës apo evidencë që të provojë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit. Konkretisht, nuk u administrua dokumentacion që të vërtetojë rishikimin e praktikave për lidhjen e kontratave të reja të qirasë, përfshirjen e klauzolave me afate të përcaktuara për fillimin e shfrytëzimit të pasurisë dhe arkëtimin e të ardhurave, eliminimin e periudhave pasive ndërmjet lidhjes së kontratës dhe fillimit të aktivitetit, apo kryerjen e procedurave ligjore për ndryshimin e destinacionit të pasurive nga fond pyjor/kullosor në truall. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**, pasi nuk është paraqitur asnjë provë dokumentare që të vërtetojë ndërmarrjen apo realizimin e veprimeve të kërkuara në rekomandim.

D. MASA DISIPLINORE Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e*

Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kolonjë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a -"Vërejtje" neni 58 shkronja (a), për 10 punonjës si më poshtë:

1. Znj. G. D, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar. *Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (59-76) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.
2. Z. G. E, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për mangësitë e konstatuara në dhënien me qira të tokave bujqësore.
***3.* Z. O. L,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, për mangësitë e konstatuara në arkëtimin e të ardhurave nga qiratë e tokave pyjore dhe bujqësore.
4. **Z. Sh. L,** në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:
Për mos zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara" i ndryshuar.
5. Znj. D. T, me detyrë Kryeinspektor i IMT-së Bashkia Kolonjë nga periudha 24.01.2024-09.11.2024, për mos përgatitjen e raportimit periodik 3 mujor për masat e marra, në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16/07/2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f).
-Në 13 raste nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Vendimit për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm", në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe me nenin 52 pika 6 të Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit" i ndryshuar.
6. **Z. P. L,** në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, Bashkia Kolonjë,
Për mangësitë e konstatuara në lidhje me mos ushtrimin e aktivitetit inspektues, si dhe për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara.
7. **Znj. E. D,** në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit pasi në 3 raste u konstatuar probleme në kriteret e veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar, përkatësisht "Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara, Bashkia Kolonjë"; "Rikonstruksion i terreneve sportive të shkollës së mesme të Bashkuar Jani Vreto Leskovik" dhe "Blerje materiale ndërtimi, hidraulike, elektrike, dekori, etj., Bashkia Kolonjë".
8. **Znj. A. K,** në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, pasi në 1 rast u konstatuar probleme në kriteret e veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar, përkatësisht "Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara, Bashkia Kolonjë".
9. **Z. P. R,** në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 3 procedura, "Blerje Karburanti për nevojat e Bashkisë Kolonjë"; "Rikonstruksion i terreneve sportive të

shkollës së mesme të Bashkuar Jani Vreto Leskovik"; "Blerje materiale ndërtimi, hidraulike, elektrike, dekori etj., Bashkia Kolonjë", vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;
10. **Z. E. Z,** në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 3 procedura, "Blerje Karburanti për nevojat e Bashkisë Kolonjë"; "Rikonstruksion i terreneve sportive të shkollës së mesme të Bashkuar Jani Vreto Leskovik"; "Blerje materiale ndërtimi, hidraulike, elektrike, dekori etj., Bashkia Kolonjë", vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

D. 2. ***Për punonjësit e larguar:***

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të rezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie punë me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

1. **Z. A. T,** në cilësinë e personit përgjegjës për procedurat e prokurimit, në 4 procedura "Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara, Bashkia Kolonjë"; "Blerje Karburanti për nevojat e Bashkisë Kolonjë"; "Rikonstruksion i terreneve sportive të shkollës së mesme të Bashkuar Jani Vreto Leskovik"; "Blerje materiale ndërtimi, hidraulike, elektrike, dekori etj., Bashkia Kolonjë" janë konstatuar problematika në kriteret e veçanta në kundërshtim me kërkesat e nenit 78, pika 2, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar.

Përgjigja e subjektit: Bashkia Kolonjë nuk ka paraqitur asnjë informacion, dokumentacion mbështetës apo evidencë që të provojë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit.

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Bashkia Kolonjë nuk ka paraqitur asnjë përgjigje, dokumentacion mbështetës apo evidencë që të provojë shqyrtimin e rekomandimeve të KLSH-së për fillimin e procedurave disiplinore ndaj punonjësve të identifikuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Konkretisht, nuk u administruan urdhra, vendime, procesverbale, materiale analitike apo dokumente të tjera që të vërtetojnë ngritjen e procedurave administrative për shqyrtimin e përgjegjësive individuale, analizimin e shkeljeve të konstatuara apo marrjen e një vendimmarrjeje nga titullari i institucionit lidhur me rekomandimet për masat disiplinore të propozuara nga KLSH. Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**, pasi nuk është paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë marrjen në shqyrtim apo zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për përgjegjësitë administrative të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për sa trajtuar më sipër ngarkohen me përgjegjësi:
Z. P. R, Nënkryetar
Znj. G. D, Drejtore e Financës
Z. P. L, kryeinspektor i IMTV
Z. E. J, Drejtor i të Ardhurave
Z. M. T, Drejtor i Urbanistikes
Znj. D. T, Drejtor DBNJ
Znj. L. S, Përgjegjëse e NJAB

IV. REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative rezultoi se janë 44 pozicione pune vakante, fenomen i cili ndikon në uljen e performancës e Bashkisë Kolonjë si dhe në realizimin e objektivave të kësaj Bashkie.
- Bashkia Kolonjë nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni dhe për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës;
-Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Gjithashtu, u evidentua se njësia publike nuk ka hartuar planë vjetore punë për të gjitha drejtoritë.
- Mungojnë manualet e proceseve të punës, fenomen i cili ka sjellë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive.
- Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.
Këto veprime janë jo në përputhje me përcaktimet ligjore të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit";* Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike";* Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1 faqe.16-31 të Raportit përfundimtar te auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, grupi i menaxhimit strategjik, si dhe Drejtoria Burimeve Njerëzore të marrë masa për:
- Plotësimin e strukturës organizative të Bashkisë Kolonjë. Struktura e re organizative të dorëzohet në Këshillin Bashkiak për të marrë miratimin përfundimtar.
- Rishikimin e rregullores së brendshme të Bashkisë Kolonjë, të manualeve të proceseve të punës dhe të përshkrimeve të vendeve të punës, në përputhje me ristrukturimin, riorganizimin dhe ndryshimet strukturore apo menaxheriale të ndërmarra nga institucioni.
- Hartimin e gjurmës së auditimit të miratuara për proceset kryesore të punës.

Brenda vitit 2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë, gjatë vitit 2025, ka funksionuar me 2 (dy) auditues. Gjithashtu, u konstatua se përgjegjësi i sektorit/njësisë së auditimit të brendshëm nuk plotëson kriterin e vjetërsisë në punë prej mbi dy vitesh në fushën e auditimit dhe nuk është i certifikuar në fushën e auditimit të brendshëm, kjo në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 11, pika 2, germa "b", si dhe me kërkesat e VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", pika 3.
Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të hartimit të **Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm 2025–2027**, u konstatua se Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka zbatuar në mënyrë

të plotë kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm lidhur me vlerësimin dhe prioritizimin e riskut. Konkretisht, nuk rezultoi të jenë planifikuar me një frekuencë më të lartë angazhimet e auditimit për sektorë/procese me nivel të lartë risku, ndër të cilët sistemi i pagave dhe procesi i prokurimeve publike.
Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme profesionale dhe e përmbushjes së kritereve të kualifikimit, e kombinuar me mangësitë në planifikimin e auditimeve mbi bazën e riskut, cenon efektivitetin e veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe aftësinë e saj për të ofruar siguri të arsyeshme mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut.
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, neni 11, pika 2, germa "b"; VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", pika 3; Manuali i Auditimit të Brendshëm, lidhur me procesin e vlerësimit të riskut, prioritizimin e fushave me risk të lartë dhe hartimin e Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1 faqe.31-36 të Raportit përfundimtar te auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për rishikimin dhe plotësimin e strukturës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm, në përputhje me kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke siguruar që drejtimi dhe stafi i njësisë të plotësojnë kriteret e përcaktuara për përvojën profesionale dhe certifikimin në fushën e auditimit të brendshëm. Gjithashtu, të vlerësojë nevojën për sigurimin e numrit dhe kapaciteteve të nevojshme të audituesve, me qëllim garantimin e ushtrimit efektiv të funksionit të auditimit të brendshëm.

Brenda vitit 2026

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të rishikojë metodologjinë e hartimit të Planit Strategjik të Auditimit dhe planeve vjetore të auditimit, duke siguruar që planifikimi të bazohet në një vlerësim të dokumentuar dhe të përditësuar të riskut dhe që fushat/proceset me nivel të lartë risku, përfshirë sistemin e pagave dhe prokurimet publike, të prioritizohen dhe të auditohen me frekuencë të përshtatshme në raport me nivelin e riskut. Rezultatet e vlerësimit të riskut të dokumentohen dhe të përdoren si bazë për përcaktimin e prioriteteve, shtrirjes dhe frekuencës së angazhimeve të auditimit.

Brenda vitit 2026

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të programimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe buxhetit vjetor 2025 u konstatua se, megjithëse janë ndjekur procedurat formale të parashikuara në kuadrin rregullator për hartimin dhe miratimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor, treguesit e planifikimit nuk kanë reflektuar në mënyrë të plotë nevojat reale financiare të institucionit. Konkretisht, ndërmjet Fazës së Dytë të PBA-së dhe Projekt-Buxhetit 2025 rezultoi një diferencë prej 54,799 mijë lekë, pasi totali i shpenzimeve është rritur nga 401,130 mijë lekë në 455,929 mijë lekë. Gjithashtu, fondi për paga dhe sigurime shoqërore është rritur me 62,101 mijë lekë ose 26%, nga 238,423 mijë lekë në 300,524 mijë lekë, ndërsa gjatë vitit buxheti fillestar është shtuar me 32,301 mijë lekë, duke arritur nga 455,929 mijë lekë në 488,230 mijë lekë. Për pasojë, janë evidentuar mangësi në realizmin dhe saktësinë e parashikimeve fillestare buxhetore, të cilat kanë kufizuar funksionin e PBA-së si instrument planifikimi afatmesëm, ndërkohë që buxheti vendor vijon të mbështetet në masën 78.3% nga transfertat e buxhetit të shtetit. Situata ka ardhur si rezultat i parashikimit jo plotësisht real të burimeve financiare kryesisht të të ardhurave të veta

dhe të nevojave për shpenzime gjatë hartimit të PBA-së, si dhe mos reflektimit të plotë të nevojave për fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore në dokumentet fillestare të planifikimit buxhetor. Veprime në kundërshtim me nenet 22, 32, 36 dhe 41 të ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetë qeverisjes vendore*", si dhe me Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 dhe Udhëzimin nr. 03, datë 28.02.2024 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025–2027. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1 faqe.36-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe strukturave përgjegjëse për planifikimin financiar, të marrë masa për përmirësimin e metodologjisë së parashikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë hartimit të PBA-së, me qëllim që treguesit e Fazës së Dytë dhe dokumentet përfundimtare buxhetore të reflektojnë në mënyrë sa më reale nevojat financiare të institucionit, duke minimizuar diferencat ndërmjet planifikimit afatmesëm dhe buxhetit vjetor dhe duke rritur besueshmërinë e procesit të planifikimit buxhetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimit të tyre në raportet e monitorimit u konstatua se Bashkia Kolonjë ka realizuar shpenzime në vlerën 525,894 mijë lekë kundrejt planit përfundimtar prej 601,284 mijë lekë, me nivel realizimi 87.46%, duke mbetur të parealizuara fonde në vlerën 75,390 mijë lekë. Mosrealizimi më i lartë u evidentua në shpenzimet kapitale, ku artikujt 230 dhe 231 janë realizuar vetëm në masën 50.3%, me diferencë 40,241 mijë lekë nga fondet e planifikuara, ndërsa artikulli 230 "Kapitale të patrupëzuara" është realizuar në masën 36.57% dhe fondi rezervë prej 2,090 mijë lekë nuk është përdorur. Njëkohësisht, institucioni ka trashëguar detyrime të prapambetura në vlerën 13,090,758 lekë, nga të cilat gjatë vitit 2025 janë likuiduar vetëm 8,362,060 lekë, ndërsa 4,728,698 lekë vijojnë të mbeten të papaguara. Gjithashtu, nga auditimi i investimeve të financuara nga fondet e Pushtetit qendror rezultoi se nga vlera totale kontraktore prej 120,551 mijë lekë janë likuiduar vetëm 78,693 mijë lekë, ndërsa vlera 41,858 mijë lekë mbeten të pa likuiduara. Objekti "Rikonstruksion i terreneve sportive të shkollës së mesme të bashkuar 'Jani Vreto' Leskovik" me vlerë 22,419 mijë lekë, kontrate e lidhur ne mars 2025 rezultoi ne proces realizimi. Ky objekt nuk rezulton te jete ne detyrimet e prapambetura qe ka Bashkia ndaj te treteve ne fund te vitit 2025 dhe është plotësisht i pa likuiduar. Situata e konstatuar tregon mangësi në planifikimin dhe ekzekutimin e shpenzimeve buxhetore, ritme të ulëta të realizimit të investimeve dhe krijim të detyrimeve të pambyllura, duke ndikuar në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike dhe në realizimin e objektivave të planifikuara buxhetore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: nenet 22, 40 dhe 41 të ligjit nr. 68/2017 *"Për financat e vetë qeverisjes vendore"* dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 dhe 2.2.4 faqe.42-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtuesit e programeve buxhetore të marrin masa për forcimin e sistemit të planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit, duke hartuar plane periodike monitorimi për realizimin e investimeve dhe programeve buxhetore, me përcaktim të qartë të përgjegjësive, afateve dhe treguesve të performancës. Drejtoria e Financës të kryejë analiza periodike mbi ecurinë e realizimit të fondeve, veçanërisht për shpenzimet kapitale, dhe t'i raportojë titullarit rastet e vonesave apo mosrealizimit të projekteve, për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi me qëllim marrjen në kohë të masave korrigjuese dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i organizimit të strukturave përgjegjëse për administrimin e të ardhurave vendore, cilësisë së të dhënave fiskale dhe administrimit të bazës së tatueshme në Bashkinë Kolonjë, u konstatua se sistemi i administrimit të të ardhurave nuk mbështetet në një strukturë të plotë organizative dhe në evidenca të besueshme administrative. Në strukturën e Drejtorisë së të Ardhurave mungojnë "Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor", "Sektori i Regjistrimit të Subjekteve" dhe "Sektori i Kontrollit në terren", ndërsa nga 110 taksa dhe tarifa të miratuara në Paketën Fiskale 2025, evidencat e realizimit administrohen vetëm për 29 prej tyre. Gjithashtu, nuk është përcaktuar qartë ndarja e përgjegjësive për përllogaritjen, faturimin dhe arkëtimin e disa taksave e tarifave, duke krijuar mbivendosje funksionesh dhe dobësi në kontrollin e brendshëm.
Nga auditimi mbi cilësinë e të dhënave u konstatua se regjistrat e taksapaguesve administrohen në tabela Excel dhe jo në sistem informatikë të licencuar, ndërsa mungojnë procedurat e rakordimit me QKB dhe DRT për regjistrimet, çregjistrimet dhe ndryshimet e statusit të subjekteve. Regjistri elektronik nuk përmban gjurmë auditimi dhe nuk mbështetet në kontrolle periodike në terren, duke krijuar pasaktësi në identifikimin, vlerësimin dhe faturimin e detyrimeve.
Për kategorinë familjare u konstatua se në planifikimin e vitit 2025 janë marrë në konsideratë 4,596 familje, ndërkohë që sipas gjendjes civile rezultojnë 6,587 familje rezidente; pas përjashtimit të 728 familjeve, mbeten 1,263 familje të pa përfshira në bazën e planifikimit. Gjithashtu, nga 7,279 ha tokë bujqësore të ndara me AMTP janë përfshirë në planifikim vetëm 6,709 ha, duke lënë jashtë 570 ha sipërfaqe të tatueshme, ndërsa 410 ha nuk figurojnë në regjistrat e përdorur për planifikim, me efekt financiar të munguar prej 287 mijë lekë në vit. Në të njëjtën kohë nuk janë marrë në konsideratë detyrimet progresive të trashëguara. Po ashtu, u konstatua se administrimi i kontratave të qirasë së tokës bujqësore dhe fondit pyjor-kullosor shoqërohet me mangësi në monitorimin e kontratave, ndjekjen e debitorëve dhe administrimin e evidencave kontraktore.
Për pasojë, mungesa e strukturave të specializuara, administrimi i të dhënave jashtë sistemeve të integruara, mos rakordimi i bazave të të dhënave dhe mos përfshirja e plotë e bazës së tatueshme kanë sjellë pasaktësi në vlerësimin e detyrimeve, kufizim të potencialit fiskal të bashkisë dhe risk për mos arkëtimin e plotë të të ardhurave vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligjin nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*"; Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "*Për regjistrimin e biznesit*" i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e Vetë qeverisjes Vendore*"; Ligjin nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; Ligjin nr. 13/2016, "*Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportele*", Ligjin nr. 119/2014, "*Për të drejtën e informimit*"; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Udhëzimin nr. 26, datë 16.12. 2014 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*"; Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007, "*Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5 faqe.46-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për rishikimin e strukturës organizative dhe të akteve të brendshme rregullatorë, me qëllim ngritjen ose përcaktimin e funksioneve për menaxhimin e borxhit tatimor, regjistrimin e subjekteve dhe

kontrollin në terren. Te merren masa per ndarjen e qartë të përgjegjësive ndërmjet strukturave që kryejnë identifikimin e bazës së tatueshme, përllogaritjen, faturimin, arkëtimin dhe monitorimin e detyrimeve vendore. Të eliminohen rastet e mbivendosjes së funksioneve dhe të sigurohet zbatimi i parimit të ndarjes së detyrave, në mënyrë që çdo taksë dhe tarifë e miratuar në Paketën Fiskale të ketë strukturë përgjegjëse të përcaktuar për administrimin dhe raportimin e saj.

Deri më 31.12.2026.

5.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e të Ardhurave te marrin masa për hartimin dhe zbatimin e procedurave periodike për rakordimin dhe verifikimin e të dhënave me QKB, DRT, Gjendjen Civile, AMTP-të dhe regjistrat e kontratave të qirasë, duke siguruar që të gjitha taksat dhe tarifat e miratuara në Paketën Fiskale të pasqyrohen në mënyrë të plotë dhe të njëtrajtshme në evidencat e planifikimit, vlerësimit, faturimit, arkëtimit dhe raportimit financiar. Të eliminohen mbivendosjet e funksioneve dhe diferencat ndërmjet paketës fiskale, regjistrave administrativë dhe raporteve të realizimit, në zbatim të parimit të ndarjes së detyrave.

Menjëherë.

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin, vlerësimin dhe realizimin e të ardhurave vendore në Bashkinë Kolonjë u konstatua se në nivel të përgjithshëm, për vitin 2025 të ardhurat nga burimet e veta janë planifikuar në vlerën 100,117 mijë lekë, ose 37,674 mijë lekë më shumë se mesatarja e realizimit faktik të viteve 2023–2024 dhe 16,795 mijë lekë më shumë se mesatarja e planifikimit të së njëjtës periudhë, ndërsa realizimi faktik ka qenë 70,336 mijë lekë ose 70.3% e planit. Mosrealizimi më i lartë konstatohet tek tarifat vendore, ku nga plani prej 71,372 mijë lekë janë arkëtuar vetëm 45,219 mijë lekë, me diferencë negative prej 26,153 mijë lekë. Po kështu, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është realizuar në masën 30.7%, tarifa e mirëmbajtjes së varrezave në 37.7% dhe tarifa e tregut në 44.4%. Procesi i planifikimit nuk është mbështetur në analiza të plota të bazës së tatueshme, performancës historike të arkëtimeve dhe potencialit real fiskal të bashkisë, duke sjellë diferenca të konsiderueshme ndërmjet planifikimit, vlerësimit dhe realizimit të të ardhurave. Planifikimi i të ardhurave në nivele më të larta se kapaciteti real i arkëtimit ndikon në përcaktimin e objektivave buxhetore, duke vendosur objektiva më të larta për të ardhurat dhe duke krijuar mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe kapaciteteve reale të realizimit të tyre. Kjo mund të ndikojë më tej në realizimin e treguesve të parashikuar në buxhet dhe në vlerësimin e performancës financiare të Bashkisë.
*Për kategorinë "Biznes"***,** u konstatua se planifikimi i të ardhurave nuk është mbështetur në një bazë të plotë dhe të verifikuar të tatimpaguesve, për shkak të mungesës së rakordimeve me QKB dhe DRT, administrimit të të dhënave në regjistra Excel dhe mungesës së një sistemi të plotë kontrolli mbi regjistrimet, çregjistrimet dhe ndryshimet e statusit të subjekteve. Kjo situatë ka ndikuar në pasaktësi në vlerësimin e detyrimeve dhe në kufizimin e potencialit real të të ardhurave nga kjo kategori tatimpaguesish.
*Për kategorinë "Familjar"***,** u konstatua se për vitin 2025 të ardhurat nga taksat dhe tarifat familjare janë planifikuar në vlerën 7,517 mijë lekë, ndërsa janë realizuar 4,937 mijë lekë ose 65.7% e planit, duke mos u realizuar 2,580 mijë lekë. Planifikimi është ndërtuar 40.75% mbi realizimin e vitit paraardhës, ndërkohë që rritja faktike e arkëtimeve ishte vetëm 10.85%. Gjithashtu, tarifat familjare janë planifikuar në vlerën 12,000 mijë lekë, në të njëjtin nivel me vitin 2024, megjithëse realizimi faktik ka rënë nga 7,899 mijë lekë në 7,454 mijë lekë. Nga auditimi i bazës së tatueshme u konstatua se në planifikimin e vitit 2025 janë përfshirë më pak familje nga sa rezultojnë sipas të

dhënave të gjendjes civile, duke *mbetur jashtë planifikimit 1,263 familje në vlerë 6,340 mijë lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë.*

*Për kategorinë "Taksa mbi Tokën Bujqësore"***,** u konstatua se planifikimi nuk është mbështetur në sipërfaqen reale të tatueshme. Nga 7,279 ha tokë bujqësore të regjistruara sipas AMTP, në regjistrat e përdorur për planifikim figurojnë vetëm 6,869 ha, ose 410 ha më pak, me efekt financiar të munguar prej 287 mijë lekë në vit. Për vitin 2025 taksa mbi tokën bujqësore është planifikuar në vlerën 5,400 mijë lekë, ndërsa është realizuar vetëm 2,206 mijë lekë ose 40.9% e planit. Gjithashtu, në planifikim nuk janë marrë në konsideratë detyrimet progresive të trashëguara për taksën e tokës bujqësore në vlerën 25.9 milionë lekë, ndërkohë që gjatë vitit janë arkëtuar vetëm 661 mijë lekë për pakësimin e tyre.

*Për kategorinë e kontratave të qirasë dhe tarifave të lidhura me fondin pyjor***,** u konstatua se planifikimi i të ardhurave nuk është mbështetur në analiza reale të kapacitetit arkëtues. Konkretisht, tarifa "*Fond pyjor me qira*" është planifikuar në vlerën 15,348 mijë lekë, por rezultoi me realizim 0%, ndërsa tarifa e druve të zjarrit është realizuar në vlerën 3,017 mijë lekë kundrejt planit 12,000 mijë lekë, me mungesë arkëtimi prej 8,983 mijë lekë. Gjithashtu, u konstatuan mangësi në monitorimin e kontratave të qirasë dhe në administrimin e evidencave kontraktore, duke ndikuar në saktësinë e vlerësimit dhe realizimit të të ardhurave nga kjo kategori.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me: nenet 22, 32 dhe 41 të Ligjit nr. 68/2017 *"Për financat e vetë qeverisjes vendore"*, nenet 4, 16 dhe 20 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, të ndryshuar, si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetë qeverisjes Vendore"*, të ndryshuar. *((Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5 faqe.51-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e të Ardhurave dhe strukturat përgjegjëse për administrimin e taksave, tarifave dhe kontratave të qirasë të marrin masa për hartimin dhe zbatimin e një metodologjie të unifikuar dhe të dokumentuar për planifikimin e të ardhurave vendore, të mbështetur në analizën e realizimeve historike, bazën reale të tatueshme, detyrimet progresive të trashëguara dhe kapacitetin real arkëtues për çdo kategori të ardhure.

Deri më 31.12.2026

6.2.Rekomandimi: : Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e të Ardhurave dhe strukturat përgjegjëse te marrin masa për kryerjen e identifikimit verifikimit dhe përfshirjen në bazën e planifikimit dhe vlerësimit të të gjitha kategorive të tatueshme. Te merren masa për te përfshirë 1,263 familjet e pa përfshira në planifikim me efekt financiar 6,340 mijë lekë, 410 ha tokë bujqësore të paregjistruara në bazën e planifikimit me efekt financiar 287 mijë lekë, si dhe detyrimet progresive të trashëguara për taksën e tokës bujqësore në vlerën 25.9 milionë lekë, si dhe të reflektohen të dhënat e plota për bizneset, familjet, sipërfaqet reale të tokës bujqësore sipas AMTP-ve, kontratat aktive të qirasë dhe detyrimet e prapambetura. Gjithashtu, të hartohen dhe zbatohen plane veprimi për rritjen e arkëtimeve nga kategoritë me potencial të paidentifikuar ose të pa arkëtuar dhe të kryhen analiza periodike të diferencave ndërmjet planifikimit dhe realizimit, me qëllim korrigjimin e devijimeve, rritjen e të ardhurave të realizuara dhe sigurimin e një planifikimi realist, të qëndrueshëm dhe të mbështetur në bazën faktike të të ardhurave vendore.

Deri më 31.12.2026.

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 520 *"Disponibilitete në thesar"* është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2025 në shumën 59,349,003 lekë vlere, e cila nuk përputhet me pasqyrën e aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 "*Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" e cila është* paraqitur në vlerën 48,932,109 lekë. Mos përputhja është për vlerën 10,416,894 lekë e cila konstatohet që është vlera e llogarisë 466 "*Kreditorë në ruajtje".* Konstatohet që pagesa të llogarisë 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* sipas pasqyrës të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 janë paraqitur në vlerën zero lekë, ndërsa sipas situacionit të shpenzimeve të thesarit shpenzime për investime janë në vlerën 39,594,341 lekë ose janë paraqitur me pak në pasqyrën e flukseve monetare Cash flow në vlerën 39,594,341 lekë. *"Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente"* është paraqitur në vlerën 469,605,393 lekë në pasqyrën Cash flow ndërsa sipas situacionit të shpenzimeve të thesarit shpenzime korente janë 486,299,848 lekë ose janë paraqitur në pasqyrën Cash flow 16,694,455 lekë me pak. Nga auditimi i akordimeve të fondeve buxhetore u konstatua që fonde të akorduara për vitin 2025 dhe të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën 537,278,948 lekë nga të cilat taksa dhe tarifa vendore janë në vlerën 70,542,847 lekë. Konstatohet që në pasqyrën të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 janë paraqitur akordim fondesh në total 518,537,502 lekë ose 18,741,446 lekë me pak. Paraqitja në mënyre të pasakte i të dhënave të likuiditeteve për vitin 2025 sipas pasqyrës të aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 nuk jep siguri për lëvizjen e likuiditeteve gjate vitit ushtrimor 2025.
Veprime në mospërputhje me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 *''Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme''* pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.Pika 50. Aneksi 2 pasqyra nr. 5. pika 14 pika 26.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.63-65 të Raportit përfundimtar te auditimit).

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje të marrë masa për saktësimin e mospërputhjes midis llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* me gjendjen e likuiditeteve në pasqyrën e aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3 për vlerën 10,416,894 lekë, si dhe të marre masa të pasqyroje sakte lëvizjen e likuiditeteve sipas akordimit të fondeve buxhetore dhe kryerjes se shpenzimeve buxhetore në pasqyrën e aneksit statistikor të flukseve monetare Cash flow Formati nr.3.

Me mbylljen pasqyrave financiare të vitit 2026

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*" paraqitet në fund të vitit 2025 në shumën prej 75,934,838 lekë.
Konstatohet që llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*" nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Bashkisë Kolonje. Detyrimet e 32 individëve dhe subjekteve për gjoba policie dhe gjoba IMT në vlerën 4,580,500 lekë janë keq klasifikuar në llogarinë 423-429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* dhe duhej të klasifikohej në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm".*
Llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*" është nënvlerësuar në vlerën 4,580,500 lekë dhe llogaria 423-429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* është mbivlerësuar në vlerën 4,580,500 lekë.
Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.67-68 të Raportit përfundimtar te auditimit).

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje të marre masa për paraqitjen e sakte të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" duke kontabilizuar sakte shtesën për vlerën 4,580,500 lekë dhe pakësimin e llogarisë 423-429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* për vlerën 4,580,500 lekë

Me mbylljen pasqyrave financiare të vitit 2026

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 202 "*Studime dhe kërkime"* paraqitet në vlere neto 14,427,354 Lekë. Llogaria 202 *"Studime dhe Kërkime"* në regjistrin e aktiveve nuk është mbajtur në mënyrë analitike për çdo projekt sipas vitit të hyrjes, vlerës së blerjes, por projektet e çdo viti janë bashkuar në një zë.
Konstatohet që janë 17 projekte investimesh në vlerën 37,157,606 lekë (kosto historike) që janë të përfshirë në llogarinë 202 "*Studime dhe kërkime"* dhe nuk ka informacion të saktë nëse këto investime janë kryer, objektet kanë përfunduar ose jo duke qenë që shumica e tyre i përkasin periudhave të hershme para vitit 2025. Vlera e mësipërme nuk duhej të paraqitej në llogaria 202 "*Studime dhe kërkime"* në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2025, por vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e investimit. Kjo ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
Veprime në mos përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu II ,Aneksi 1 pika 2, klasa 2, pika 5. Në mos përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.69-69 të Raportit përfundimtar te auditimit).*

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje të marrë masa që të saktësoje gjendjen e llogarisë 202 "*Studime dhe kërkime"* duke verifikuar përfundimin e 17 projekteve të investimeve me kosto historike në vlerën 37,157,606 lekë dhe paraqitjen e drejte të llogarisë 202 "*Studime dhe kërkime"* për objektet e përfunduara.

Me mbylljen pasqyrave financiare të vitit 2026

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe i regjistrave kontabël të aktiveve afatgjata materiale, për vitin ushtrimor 2025, u konstatuan mangësi në dokumentimin e të drejtave të pronësisë, evidentimin analitik, identifikimin fizik dhe përditësimin e regjistrit të aktiveve për llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, kullota, plantacione", 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore".
Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën neto **3,330,850 lekë**. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se objektet e përfshira në këtë llogari nuk janë të pajisura me dokumentacion të plotë që provon të drejtën e pronësisë dhe nuk rezultojnë të jenë në proces regjistrimi pranë institucioneve kompetente. Për rrjedhojë, vlerat e pasqyruara në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare për këto aktive nuk mbështetet në dokumentacion të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm që provon të drejtën reale të pronësisë së Bashkisë mbi pasuritë përkatëse. Kjo situatë krijon risk lidhur me ekzistencën, të drejtat mbi aktivet dhe paraqitjen e saktë të tyre në pasqyrat financiare.

Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën neto **25,909,872 lekë**. Nga auditimi rezultoi se kjo vlerë nuk është e mbështetur në një regjistër analitik të detajuar sipas objekteve dhe në pjesën përkatëse është mbartur ndër vite si vlerë e trashëguar. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se pasuritë e përfshira në këtë llogari nuk janë të pajisura me dokumentacion të plotë që provon të drejtën e pronësisë dhe nuk rezultojnë në proces regjistrimi. Për pasojë, mungesa e dokumentacionit juridik dhe e analizës analitike sipas objekteve kufizon mundësinë për të verifikuar ekzistencën, pronësinë, vendndodhjen, vlerën dhe gjendjen e këtyre aktiveve dhe ndikon në besueshmërinë e informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare.
Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën neto **497,804,348 lekë**. Nga shqyrtimi i regjistrit elektronik të aktiveve rezultoi se evidentimi i ndërtesave nuk është kryer në mënyrë të plotë dhe të individualizuar sipas çdo objekti. Në disa raste, i njëjti objekt paraqitet në regjistër në mënyrë të përsëritur, me vlera të ndryshme, të lidhura me investime të kryera në periudha të ndryshme, pa u integruar këto vlera në një regjistrim të unifikuar për objektin përkatës. Për rrjedhojë, regjistri analitik i aktiveve për llogarinë 212 nuk paraqet një pasqyrim të plotë, të qartë dhe të përditësuar të gjendjes së aktiveve, duke krijuar risk për mbivlerësim ose nënvlerësim të aktiveve, vështirësi në rakordimin e tyre me dokumentacionin e investimeve dhe në përcaktimin e saktë të bazës mbi të cilën llogaritet amortizimi.
Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në fund të vitit 2025 me vlerë historike **2,793,731,055 lekë** dhe vlerë neto **2,232,363,500 lekë**. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se:
- për vlerën **390,032,461 lekë** nuk disponohen të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e objekteve përkatëse në regjistrin e aktiveve;
- për **12 objekte**, me vlerë totale **181,421,376 lekë**, nuk është kryer analizimi i plotë në kontabilitet për të përcaktuar objektet konkrete të cilave u përkasin këto vlera;
Vlera prej **2,222,277,217 lekë**, ndonëse pjesërisht e analizuar, nuk paraqitet në mënyrë të integruar sipas objektit të investimit, pasi shpenzime të lidhura me mbikëqyrjen e punimeve, super vizimet dhe elementë të tjerë të kostos së investimit janë evidentuar në llogari analitike të veçanta, në vend që të identifikoheshin dhe t'i shtoheshin kostos së objektit përkatës, sipas natyrës së tyre dhe dokumentacionit justifikues.
Nga auditimi rezultoi gjithashtu se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka marrë masa të mjaftueshme për identifikimin, inventarizimin dhe përcaktimin e statusit juridik të objekteve të infrastrukturës së ujësjellësit që rezultojnë të evidentuara në aktivet e Bashkisë Kolonjë.
Në veçanti, nuk rezultoi të jenë përfunduar procedurat e nevojshme për identifikimin e plotë të aseteve të ujësjellësit, përcaktimin e pasurive që i përkasin këtij shërbimi, dokumentimin e statusit të tyre juridik dhe marrjen e masave për transferimin e aseteve përkatëse te **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sha.**, sipas kuadrit ligjor dhe institucional në fuqi.
Mangësitë e konstatuara në dokumentimin juridik, evidentimin analitik, identifikimin fizik dhe përditësimin e regjistrit të aktiveve afatgjata materiale krijojnë risk që vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare të mos pasqyrojnë në mënyrë të plotë dhe të besueshme gjendjen reale të aktiveve të Bashkisë.
Veprime në mospërputhje Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së Përgjithshme”* i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. Në mospërputhje me VKM nr.302, datë 11.05.2022 *“Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura”* kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.69-74 të Raportit përfundimtar te auditimit).

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marrë masa për inventarizimin, identifikimin dhe analizimin e plotë të aktiveve afatgjata materiale, duke përfshirë llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, kullota, plantacione", 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", dhe të përditësojë regjistrin analitik të aktiveve në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe udhëzimeve përkatëse të kontabilitetit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

10.2.Rekomandimi. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marrë masa që për aktivet e infrastrukturës së ujësjellësit që rezultojnë të përfshira në aktivet e Bashkisë Kolonjë, të kryhet identifikimi dhe inventarizimi i plotë i tyre, përcaktimi i statusit juridik dhe administrativ dhe, mbi bazën e këtij verifikimi, të ndiqen procedurat ligjore dhe administrative për transferimin e aseteve te "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A", sipas legjislacionit në fuqi**.**

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë" paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitin 2025 në vlerën 55,151,317 lekë vlere e mbetur.

Nga të dhënat e vena në dispozicion nga Drejtoria e financës dhe Buxhetit u konstatua që regjistri i aktiveve për Llogarinë 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë"* paraqitet në mënyre të përmbledhur makineri pajisje dhe vegla punë në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Kolonjë.

Nga auditimi i llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë"* u konstatua që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë kolonje nuk disponon të dhëna të sakta analitike të llogarisë për vitin e krijimit të shtesës se llogarisë si dhe ka ndryshim midis të dhënave sipas regjistrit me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b. Sipas regjistrit të aktiveve vlera e llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri pajisje, vegla punë"* në fund të vitit 2025 është në shumen 194,164,070 lekë me kosto historike, ndërsa sipas Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b vlera e llogarisë është 175,515,708 lekë ose me një ndryshim prej 18,648,362 lekësh pasqyruar me pak në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b.

- Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 215 *"Mjete transporti"* paraqitet në vlerën neto 15,487,066 lekë.

Nga auditimi i llogarisë 215 *"Mjete transporti"* u konstatua që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë kolonje nuk disponon të dhëna të sakta analitike të llogarisë për vitin e krijimit të shtesës se llogarisë .Konstatohet që ka ndryshim midis të dhënave sipas regjistrit të aktiveve me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b. Sipas regjistrit të aktiveve vlera e llogarisë 215 *"Mjete transporti"* është në shumen 112,764,029 lekë me kosto historike , ndërsa sipas Pasqyrës se Aneksit statistikor 7/b është 134,062,630 lekë ose me një ndryshim prej 21,298,601 lekësh e paraqitur me shume në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b ,rrjedhimisht për vlerën 21,298,601 lekësh nuk disponohet informacion për gjendjen e saj kontabël analitike.

- Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 218 "Inventar ekonomik" paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 7,887,006 lekë me vlere neto në fund të vitit 2025. Nga auditimi i llogarisë 218 *"*Inventar ekonomik*"* u konstatua që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje nuk disponon të dhëna të sakta analitike të llogarisë për vitin e krijimit të shtesës se llogarisë, si dhe ka ndryshim midis të dhënave sipas regjistrit të aktiveve me të dhënat

e paraqitura në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b. Sipas regjistrit të aktiveve vlera e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" është në shumen 61,882,490 lekë, ndërsa sipas Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b është 65,171,094 lekë ose me një ndryshim prej 3,288,604 lekësh e paraqitur me shume në Pasqyrën e Aneksit statistikor 7/b, rrjedhimisht për vlerën 3,288,604 lekë. Drejtoria e Financës nuk disponon informacion për gjendjen e saj kontabël analitike.
Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. Në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.74-78 të Raportit përfundimtar te auditimit).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marrë masa për verifikimin, analizimin dhe rakordimin e plotë të të dhënave analitike të aktiveve të evidentuara në llogaritë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune", 215 "Mjete transporti" dhe 218 "Inventar ekonomik", duke siguruar që çdo aktiv të jetë i identifikueshëm dhe i evidentuar në regjistrin analitik të aktiveve, në përputhje me dokumentacionin justifikues dhe të dhënat kontabël. Të kryhet rakordimi ndërmjet regjistrit të aktiveve dhe Pasqyrës së Aneksit Statistikor nr. 7/b, si dhe të analizohen dhe korrigjohen mospërputhjet e konstatuara në vlerat historike, përkatësisht **18,648,362 lekë** për llogarinë 214, **21,298,601 lekë** për llogarinë 215 dhe **3,288,604 lekë** për llogarinë 218, me qëllim që vlerat e aktiveve të paraqitura në regjistrin analitik, kontabilitet dhe pasqyrat financiare të jenë të plota, të sakta dhe të rakorduara ndërmjet tyre.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës se pozicioni financiar u konstatua që llogaria 26 *''Pjesëmarrje në kapitalin e vet''* është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën zero lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 625,621 lekë . Konstatohet që nuk është pasqyruar në ketë llogari pjesëmarrja në kapital në shoqërinë "K" SH.A e cila është shoqëri aksionare me objekt *"Mbledhja, transporti, administrimi, depozitimi i mbetjeve bashkiake dhe komunale"* për vlerën 261,821 lekë. Konstatohet që nuk është paraqitur në llogarinë 26 *''Pjesëmarrje në kapitalin e vet''* në Sh R U K K sha për vlerën 363,800 lekë.
Veprime në mos përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. Në mospërputhje me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"* kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85,
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.78-79 të Raportit përfundimtar te auditimit).

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të pasqyroje në llogarinë 26 *''Pjesëmarrje në kapitalin e vet''* pjesëmarrjen në kapital në shoqërinë "K" SH.A për vlerën 261,821 lekë dhe pjesëmarrjen në kapital në shoqërinë në "Sh R U K K" SH.A për vlerën 363,800 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës se pozicioni financiar u konstatua që llogaria 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* në fillim të vitit 2025 rezultoi në vlerën 51,269,261 lekë dhe në fund të vitit 2025 rezultoi në vlerën 74,757,665 lekë ose me një shtese gjatë vitit 2025 për vlerën prej 23,488,404 lekë. Nga auditimi i pasqyrës aneksit statistikore Formati nr.6, llogaria 231*""Investime për aktive afatgjata materiale"* është debituar për vitin 2025 në vlerën 56,962,792 lekë dhe është kredituar për vlerën 33,474,388 lekë.
Konstatohet që ka mospërputhje midis shtesës se aktivit llogaria 21 "*Aktive afat gjata materiale*" vlerës debitorë të saj dhe pakësimit të llogarisë 231*"Investime për aktive afatgjata materiale"* vlerës kreditore të saj për vlerën 5,433,658 lekë (33,474,388 - 28,040,730). Llogaria 21 "*Aktive afat gjata materiale*" është nënvlerësuar për vlerën 5,433,658 lekë.
Veprime këto në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, pika 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i Llogarive të klasës 2. Germa b, germa d.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.79-80 të Raportit përfundimtar te auditimit).

13.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të saktësoje mospërputhjen e vlerës prej 5,433,658 lekë ndërmjet shtesës së aktiveve të pasqyruara në llogarinë 21 "Aktive afatgjata materiale" dhe vlerës së regjistruar në anën kreditore të llogarisë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale"

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës se pozicioni financiar u konstatua që llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Kolonje në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 10,416,894 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka të detajuara për 30 projekte vlerën prej 8,937,618 lekë dhe për vlerën prej 1,479,276 lekë nuk disponon informacion të detajuar se kujt investimi i përket kjo vlere e ngurtësuara në llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje".
Veprime në mos përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.84-85 të Raportit përfundimtar te auditimit).

14.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marrë masa për saktësimin dhe rakordimin e të dhënave analitike të llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" me vlerat e ngurtësuara në llogarinë e Thesarit, sipas objekteve përkatëse, si dhe të identifikojë dhe dokumentojë përbërjen e shumës prej 1,479,276 lekë, për të cilën aktualisht nuk disponohen të dhëna të detajuara, duke kryer sipas rastit sistemimet përkatëse kontabël.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës se pozicioni financiar u konstatua që llogaria 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"*, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 81,863,350 lekë.
Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që llogaria 468*"Debitorë të ndryshëm"* për vitin 2025 është shtuar në vlerën 4,229,644 lekë (75,934,838 -71,705,194). Nga auditimi i pasqyrimit të llogarisë 470 *''Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë''* në pasqyrat e

pozicionit financiar u konstatua se kjo llogari është në vlerën zero lekë .Kjo llogari edhe në rakordimin e pozicionit financiar me thesarin është në vlerën zero lekë. Totali i llogarive 470*''Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë''* + 4341 *''Operacione me shtetin detyrime''* është në vlerën 81,863,350 lekë. Llogaria 470 *''Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë''* duhet të ketë në kundër parti të sajë llogarinë 468 *''Debitor të ndryshëm''* për vlerën 4,229,644 lekë të shtese se debitorëve për vitin 2025, si dhe kundër parti llogarinë 4341*''Operacionë me shtetin detyrime''* për vlerën 77,633,706 lekë (81,863,350-4,229,644).
Nga auditimi i paraqitjes se llogarisë 4341*''Operacionë me shtetin detyrime''* në pasqyrën e pozicionit financiar u konstatua që kjo llogari është mbivlerësuar për shtesën e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 në vlerën 4,229,644 lekë. Llogaria 470 *''Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë''* është nënvlerësuar për shtesën e debitorëve për vitin 2025 në vlerën 4,229,644 lekë.
Veprime janë në mos përputhje në mospërputhje me Udhëzimin *nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* rubrika 2.3 "Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik", paragrafi 21, shtohet pika c , pika 3.2. "germat a, b, c, d.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.85-87 të Raportit përfundimtar te auditimit).*

15.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të saktësoje llogarinë 470 *''Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë''* e cila është nënvlerësuar për shtesën e debitorëve për vitin 2025 në vlerën 4,229,644 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe i të dhënave kontabël të njësisë për vitin 2025, u konstatua se llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" paraqitet në vlerën 3,009,338,378 lekë në fillim të periudhës ushtrimore dhe në vlerën 2,990,399,663 lekë në fund të vitit 2025.
Nga rakordimi i gjendjes së llogarisë 101 me lëvizjet kontabël të vitit, përkatësisht shtesat dhe pakësimet e fondeve bazë, ndryshimet e aktiveve afatgjata, amortizimin/konsumin e aktiveve, si dhe me informacionin e paraqitur në Pasqyrën e Ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto dhe dokumentacionin kontabël mbështetës, rezultoi se gjendja e saktë e llogarisë 101 më 31.12.2025 duhet të jetë 2,945,107,271 lekë.
Për rrjedhojë, llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është paraqitur në pasqyrën financiare në vlerën 2,990,399,663 lekë, ndërkohë që duhej të paraqitej në vlerën 2,945,107,271 lekë, duke rezultuar e mbivlerësuar me 45,292,392 lekë.
Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar Kreu II pika 17.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.87-88 të Raportit përfundimtar te auditimit).

16.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa për saktësimin e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar", e cila rezulton e mbivlerësuar me 45,292,392 lekë, duke kryer sistemimet e nevojshme kontabël dhe reflektuar vlerën e saktë në pasqyrat financiare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

17.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion për fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2025 u konstatua që fonde të akorduara në total janë 466,736,101 lekë. Nga verifikimi i të dhënave të paraqitura në akt-rakordimin me Thesarin rezultoi se vlera e investimeve të realizuara nga fondet e akorduara (grantet) është 33,937,411 lekë, ndërsa vlera e investimeve të financuara nga të ardhurat e veta të Bashkisë është 5,656,930 lekë. Nga auditimi u konstatua se në Pasqyrën e Performancës Financiare, të ardhurat e evidentuara në llogarinë 720 "Grant korrent i brendshëm" nuk janë paraqitur në vlerën e saktë, pasi vlera që duhej të paraqitej në këtë llogari është 432,798,690 lekë, e përllogaritur si diferencë ndërmjet fondeve të akorduara në total prej 466,736,101 lekë dhe vlerës së investimeve prej 33,937,411 lekë. Në Pasqyrën e Performancës Financiare është paraqitur vlera 425,314,889 lekë, duke rezultuar me një nënvlerësim të të ardhurave në shumën 7,483,801 lekë.. Llogaria 720 *"Grant korrent i brendshëm"* në pasqyrën e performancës financiare është nënvlerësuar për vlerën 7,483,801 lekë, duke ndikuar negativisht në rezultatin e vitit ushtrimor për vlerën 7,483,801 lekë.
Veprime në kundërshtim me Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 *''Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes* së përgjithshme i ndryshuar Pika 2.3 Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik nënpika 15.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.88-91 të Raportit përfundimtar te auditimit).

17.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa për saktësimin e llogarisë 720 "Grant korrent i brendshëm" në Pasqyrën e Performancës Financiare, duke korrigjuar nënvlerësimin prej 7,438,801 lekësh dhe duke reflektuar vlerën e saktë në pasqyrat financiare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

18.Gjetje nga auditimi: Llogaria 6001 *"Paga, personel i përhershëm"* për vitin 2025 është pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare në vlerën 247,675,842 lekë. Nga auditimi i të dhënave të borderove përmbledhëse të raportuara në sistemin CATS u konstatua që për vitin 2025 pagat bruto për Bashkinë janë në vlerën 224,973,011 lekë, për njësinë vartëse Klubi Sportiv "GRAMOZI" janë 2,348,390 lekë dhe për njësinë vartëse qendra Kulturore "F. S. Noli" janë 15,960,652 lekë. Në total pagat bruto sipas borderove të tre njësive janë në vlerën 243,282,053 lekë (224,973,011 + 2,348,390 + 15,960,652). Nga auditimi u konstatua që pasqyrimi i pagave 6001 ***"Paga, personel i përhershëm"*** në pasqyrën e performancës financiare është pasqyruar në vlerën 247,675,842 lekë ose 4,393,789 lekë më shumë (247,675,842 - 243,282,053), duke ndikuar negativisht në rezultatin e vitit ushtrimor për vlerën 4,393,789 lekë.
Llogaria 85 *"Teprica ose deficiti i periudhës"* është pasqyruar në vlerën 48,932,109 lekë në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2025. U konstatua se, si pasoje e pasqyrimit të pasakte të llogarisë 720 "Grant korrent i brendshëm" në pasqyrën e performancës financiare për vlerën 7,483,801 lekë dhe llogarisë 6001 "Paga, personel i përhershëm" për vlerën 4,393,789 lekë, llogaria 85 "*Teprica ose deficiti i periudhës"* është nënvlerësuar për vlerën 11,877,590 lekë (7,483,801 + 4,393,789).
Veprime në kundërshtim me Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 *''Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar pika 4.1.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.2 faqe.91-92 të Raportit përfundimtar te auditimit).

18.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonjë të marre masa të saktësoje llogarinë 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve" në pasqyrën e performancës financiare për vlerën e mbivlerësuar 4,393,789 lekë dhe llogarinë 85 "*Teprica ose deficiti i periudhës"* për vlerën e nënvlerësuar për vlerën 11,877,590 lekë duke e pasqyruar sakte atë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

19.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të kryerjes se procesit të inventarizimit të aktiveve u konstatua se nga nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, si dhe nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri ne momentin e auditimit ne terren respektivisht; 202- "*Studime dhe kërkime"*, 210- "*Toka, Troje, terrene"*, 211 – *"Pyje, Plantacione" 212*- "Ndërtesa e Konstruksione", 213- "*Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore"*, 214 – *"Instalime teknike, makineri e pajisje.*

Proces verbalet e inventarizimit nuk kanë evidentuar llogarite kontabël të inventarizuara për llogarite 31 *"Materiale"*; 32 *''Inventar i imët"* dhe llogarinë 218 *"Inventar ekonomik"*. Inventarizimi në proces verbale përfshin vlera të grupuara të llogarive dhe jo identifikim të vlerave sipas kartelave të llogarive 31 *"Materiale"* Llogaria 32 *''Inventar i imët"* llogaria *218 "Inventar ekonomik"* rrjedhimisht nuk janë hartuar në mënyre të plote dhe të sakte. Nga auditimi u konstatua se procesi i inventarizimit të aktiveve është kryer me proces verbale të gjendjeve të aktiveve dhe vlerësimit të tyre me shkresa të pa protokolluar në zyrën e protokoll arkivës.

Veprimet janë në mos përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *" Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* neni 2, neni 4 ,pika 9 Neni 12 *''Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues''.* Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *" Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i* ndryshuar, pika 36, pika 52, pika 73, pika 85. Veprime në mos përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, "*Për arkivat*" i ndryshuar, neni 22 dhe nenet 11-20 të "N*orma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".

Udhëzimin e Ministrisë *nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* kreu 3.1.*Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme:* pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3.3 faqe.92-94 të Raportit përfundimtar te auditimit).

19.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje të marre masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, si dhe të marre masa për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të bashkisë dhe verifikimin e tyre me gjendjen kontabël, sipas kartelave të llogarive përkatëse 202- "*Studime dhe kërkime"*; 210- "*Toka, Troje, terrene"*; 211 – *"Pyje, Plantacione"; 212*- "Ndërtesa e Konstruksionë";213- "*Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore"*; 214 – *"Instalime teknike, makineri e pajisje;* 31 *"Materiale"*; 32 *''Inventar i imët"* dhe 218 *"Inventar ekonomik"*.

Deri me 31.12.2026

19.2.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Kolonje të marre masa që procesin e inventarizimit të aktive ta dokumentoje me proces verbale të inventarizimit të protokolluara në zyrën e protokoll arkivës.

Deri me 31.12.2026

20. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "*Mbi auditimin e përputhshmërisë*" trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.176, datë 09.10.2025, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 319/14.Prot, datë 20.10.2025 rezultoi se:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 34 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 34 masa. Nga masat e pranuara është zbatuar 1 masë, janë zbatuar pjesërisht 10 masa dhe 23 masa rezultojnë të pazbatuara. Nga 33 masa organizative të cilësuara si të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, ri kërkohen 23 masa pasi nuk janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual.

Për uljen e borxhit janë rekomanduar 6 masa, të cilat janë pranuar plotësisht nga subjekti. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se asnjë prej tyre nuk është zbatuar. Nga 6 masat e cilësuara si të pazbatuara, të gjitha ri kërkohen pasi nuk janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual.

Janë rekomanduar 10 masa disiplinore. Nga verifikimi rezultoi se nuk janë marrë masa disiplinore ndaj punonjësve për të cilët është rekomanduar fillimi i procedurave disiplinore. Statusi i këtyre rekomandimeve konsiderohet i pazbatuar. Nga 10 masat disiplinore të cilësuara si të pazbatuara, ri kërkohen 6 masa pasi nuk janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual.

Nga verifikimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme u verifikua se vijojnë të mbeten të pazbatuara ose pjesërisht të zbatuara rekomandime me ndikim financiar, administrativ dhe disiplinor, për Bashkinë Kolonjë, të përcjella me shkresat nr.683/26.prot., datë 23.05.2022, nr.1025/9, datë 22.05.2023 dhe nr.186/19, datë 25.07.2024. Konkretisht, për masat e shpërblimit të dëmit ekonomik rezultojnë të pa arkëtuara ose të pa përfunduara procedurat për një vlerë totale prej 14,473,730 lekë pa TVSH, si dhe vijojnë të mbeten të pazgjidhura çështje që lidhen me vlerësimin dhe zhdëmtimin e dëmit në shumën 5,655,218 lekë. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë zbatuar asnjë nga 4 masat administrative të rekomanduara ndaj subjekteve mbikëqyrëse të punimeve, për shkelje të konstatuara në kontrata ku vlera e punimeve të likuiduara por të pazbatuara arrin në 25,172,991 lekë me TVSH.

Këto rekomandime konsiderohen të pazbatuara dhe mbeten objekt ndjekjeje deri në zbatimin e plotë të tyre nga Bashkia Kolonjë. Konkretisht si më poshtë:

Për masat për shpërblimin e dëmit të lëna me shkresën nr.683/26.prot., datë 23.05.2022, rezultojnë ende të pa përfunduara procedurat për arkëtimin e vlerës 942,303 lekë pa TVSH nga BOE "A" & "4." ShPK, për punime të pakryera në objektin "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut". Gjithashtu, nuk rezulton i përfunduar procesi i analizimit të situatës lidhur me pajisjet e pavendosura dhe funksionimin e sistemit SCADA, për të cilin është rekomanduar vendosja e pajisjeve ose në të kundërt arkëtimi i vlerës 4,390,946 lekë. Po ashtu, nuk rezulton i përfunduar procesi i vlerësimit dhe arkëtimit të vlerës 1,264,272 lekë për punime të pakryera, si dhe vijojnë të mbeten të pa arkëtuara vlerat 1,323,023 lekë ndaj OE "A K " ShPK dhe 290,800 lekë ndaj OE "A." ShPK.

<u>Për masat për shpërblimin e dëmit ekonomik të lëna me shkresën nr.1025/9, datë 22.05.2023</u>, nuk rezulton të jenë arkëtuar vlerat 732,989 lekë ndaj BOE "A." SHPK & "E K" SHPK dhe 218,243 lekë ndaj BOE "Z." SHPK & "K." SHPK, të rekomanduara si dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Gjithashtu, nuk rezulton i përfunduar procesi për kërkimin e shpërblimit të dëmit në vlerën 523,391 lekë, si dhe nuk rezulton i arkëtuar detyrimi prej 428,264 lekë ndaj subjektit me NIPT K....K "A K U K", i lindur nga keq llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

<u>Për masat për shpërblimin e dëmit ekonomik të lëna me shkresën nr.186/19, datë 25.07.2024,</u> nuk rezulton të jenë arkëtuar vlerat 2,939,000 lekë pa TVSH ndaj BOE "R." SHPK & "B." SHPK, 1,515,106 lekë pa TVSH ndaj OE "Z.", 1,574,784 lekë pa TVSH ndaj BOE "Z." & "K." dhe 331,000 lekë pa TVSH ndaj OE "Z.", për punime të likuiduara por të parealizuara sipas kontratave respektive objekt auditimi.

<u>Për masat administrative të lëna me shkresën nr.186/19, datë 25.07.2024</u> për Inspektoratin e Mbrojtjes së territorit (IMT), nuk rezulton të jetë zbatuar asnjë nga rekomandimet për marrjen e masave administrative ndaj subjekteve mbikëqyrëse të punimeve: OE "V E" SHPK për shkelje të konstatuara në kontratën "Rikonstruksioni i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtimi i pritave malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë", me vlerë punimesh të likuiduara por të pazbatuara 21,058,924 lekë me TVSH; OE "T H C" SHPK për objektin "Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë – Porta e Rehovës", me vlerë 1,818,127 lekë me TVSH; OE "L C" SHPK për objektin "Rikualifikim i rrugës Pali Prifti", me vlerë 1,898,740 lekë me TVSH; si dhe OE "S." SHPK për objektin "Rikonstruksioni i kanalit vaditës fshati Gostivisht", me vlerë 397,200 lekë me TVSH.

Sa më sipër tregon se një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, veçanërisht ato që lidhen me shpërblimin e dëmit ekonomik, rikuperimin e të ardhurave të munguara dhe marrjen e masave administrative, vijojnë të mbeten të pazbatuara, duke mbajtur të hapur detyrimin e Bashkisë Kolonjë për ndjekjen dhe zbatimin e tyre deri në ezaurimin përfundimtar të efekteve financiare dhe administrative të konstatuara nga KLSH. ***Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:*** *nenin 15, "Të drejtat e KLSH" të ligjit Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe (94-121) të Raportit përfundimtar te auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe pjesërisht të zbatuara, si dhe përshpejtimin e atyre në proces, të lëna nga KLSH në auditimin e përputhshmërisë, përcjellë me shkresën nr.319/14.Prot., datë 20.10.2025. Për rekomandimet e masave organizative nga auditimi i mëparshëm ri kërkohen rekomandimet me numër 3.1;4.1;12.1;14.1;14.2;15.1;16.1;16.2.16.3;17.1;18.1;19.1;20.1;21.1;22.1;23.1;24.1;25.1;26.1;27. 1;28.1;29.1.30.1; .Për rekomandimet për Masat organizative mbi uljen e borxhit tatimor, rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim-taksat vendore dhe detyrimet nga qiradhënia ri kërkohen rekomandimet 1.1;2.1;3.1;4.1;5.1;5.2. Për masat disiplinorë ri kërkohen masat disiplinore për 6 punonjës. Konkretisht rikërkohen rekomandimet si me poshtë:

A. Masa organizative

I. Masa organizative mbi funksionimin e komponentëve të MFK-së

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për rekrutimin dhe plotësimin e strukturës së IMTV-së me punonjës me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

Menjëherë dhe në vijimësi.

II. Masa organizative mbi menaxhimin financiar, likuidimin e detyrimeve dhe kontrollin buxhetor

2.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30-ditor, nga momenti i prerjes së faturës. Gjithashtu, të marrin masa për të hartuar një planifikim të detajuar të grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, duke siguruar zbatimin e tij gjatë realizimit të buxhetit, në përputhje me burimet financiare të disponueshme për likuidimin e këtyre detyrimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi.

IV. Masa organizative mbi planifikimin, administrimin dhe kontrollin e të ardhurave vendore

3.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për të përmirësuar procesin e planifikimit të të ardhurave bazuar në analizë reale të performancës historike dhe të dhëna të verifikueshme. Po ashtu, të hartojë dhe të mbajë një listë analitike të saktë për të ardhurat e trashëguara nga burimet e veta, për të garantuar transparencë dhe kontroll mbi burimin dhe përdorimin e tyre.

Në vijimësi.

V. Masa organizative mbi raportimin në pasqyrat financiare, regjistrat kontabël dhe kontabilizimin e aktiveve

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim, Kontroll territorit (Sektori i Menaxhimit të Kontratave), Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm, për likuidimin e garancisë së punimeve, të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025.

VI. Masa për prokurimin publik dhe përgjegjësitë në procedurat e prokurimit

5.1. Rekomandimi: Sektori i Prokurimit Publik (Nj P përkatëse) në Bashkinë Kolonjë, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të marrë masa t'i argumentojë teknikisht dhe ligjërisht ato duke pasur gjithmonë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, grafikun e punimeve, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, harmonizimin me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike, me qëllim për të garantuar trajtim të barabartë të OE, duke nxitur gjithashtu konkurrencën midis tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi.

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë, të marrë masa, të analizojë me grup punë të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e B/OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST-ve.

Menjëherë dhe në vijimësi.

7.1. Rekomandimi:

-Personi përgjegjës për prokurimet të hartojë regjistrin e realizimit të prokurimeve me vlerë të vogël, duke mos iu shmangur rregullave të prokurimit publik. Të marrë masa për administrimin e relacioneve teknike ku të argumentohen sasitë e mallrave objekt prokurimit.
-Zyrtarët e përfshirë në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të hartojnë kritere që lidhen ngushtë me natyrën dhe objektin e zbatimit të kontratës, të kualifikojnë operatorë ekonomikë, që plotësojnë kërkesat e ftesës për ofertë DST dhe të hartojnë fondin limit të procedurave të prokurimit në bazë të metodave të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi.

VII. Masa organizative mbi administrimin e aseteve publike, regjistrimin e pronave dhe kontratat e qirasë

8.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një drejtorie apo sektori të posaçëm për administrimin e aseteve publike, në përputhje me rregulloren e miratuar dhe funksionet ligjore, me qëllim garantimin e organizimit institucional dhe koordinimit të proceseve të regjistrimit, inventarizimit dhe shfrytëzimit të pronave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi.

9.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa të krijojë grupe punë të përhershme me përfaqësues teknike, juridikë dhe financiarë, për të kryer verifikimin fizik dhe juridik të pronave të paluajtshme (toka, ndërtesa, pyje, kullota), për përgatitjen e dokumentacionit të regjistrimit në ASHK dhe për hartimin e regjistrit kontabël të aseteve.

Menjëherë dhe në vijimësi.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa të përfundojë procesin e hartimit dhe miratimit të listave përfundimtare të pasurive për njësitë administrative që ende nuk e kanë këtë dokument, si dhe të identifikohen sipërfaqet e pashpërndara të tokës bujqësore dhe fondit pyjor/kullosor, për t'i regjistruar dhe përfshirë në menaxhim të rregullt ekonomik dhe financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi.

11.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa që të plotësojë me dokumentacionin e nevojshëm të gjitha dosjet e kontratave për dhënien me qira të aseteve që administron dhe kontratat që do të lidhen në të ardhmen, konkretisht: mbi procesin e regjistrimit të aseteve; procesin e dorëzimit të asetit; monitorimit mbi zbatueshmërinë e kushteve të kontratës dhe marrjes në dorëzim të asetit.

Menjëherë dhe në vijimësi.

VIII. Masa organizative mbi planifikimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit/lejet e ndërtimit

12.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të territorit, Bashkia Kolonjë, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi:
- Të kërkojnë ngarkimin e plotë të dokumentacionit të detyrueshëm gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, siç janë: licenca për ushtrimin e aktivitetit, polica e sigurimit e përgjegjësisë profesionale, certifikata e regjistrimit në qendrën Kombëtare të Biznesit për hartuesit e projekteve ndërtimore, etj.;
- Të shqyrtojë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;
- Të sigurohet që gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi, dokumentacioni i pronësisë të jetë i rifreskuar brenda një periudhe jo më të gjatë se tre muaj nga data e aplikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi.

13.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të territorit, Bashkia Kolonjë, në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, të merren të gjitha masat

për të kërkuar mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, informacion i cili përcillet nëpërmjet sistemit "e-lejet", në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Gjithashtu, të respektohet në çdo rast mendimi i autoriteteve kompetente, të cilat shprehen brenda fushës së kompetencave që u njeh ligji, në lidhje me aplikimet për leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi.

IX. Masa organizative mbi funksionimin e IMTV-së, procedurat inspektuese dhe ekzekutimin e masave administrative

14.1. Rekomandimi: Struktura e IMTV-së pranë Bashkisë Kolonjë të marrë masa për përgatitjen e raportimeve periodike mbi ecurinë e veprimtarisë së saj dhe t'i paraqesë ato pranë titullarit të institucionit. Gjithashtu, Kryeinspektori i IMTV-së duhet të hartojë dhe dorëzojë në mënyrë të rregullt raportet tremujore dhe vjetore pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së territorit (IKMT), në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi.

15.1. Rekomandimi: IMTV Bashkia Kolonjë, të marrë masa të sigurojë dokumentimin e detajuar, me foto ose video, të të gjitha procedurave të konstatimit të kundërvajtjeve dhe të prishjes së ndërtimeve pa leje. Gjithashtu, Kryeinspektori të vijojë me nxjerrjen e Urdhrave të Ekzekutimit për rastet me vendim për prishje objekti të kundërligjshëm dhe në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme në hapësira publike, të kryejë përllogaritjen e dëmit dhe të njoftojë subjektin për detyrimin e rikthimit të territorit në gjendjen e mëparshme, në natyrë ose në vlerë monetare.

Menjëherë dhe në vijimësi.

16.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV-së Bashkia Kolonjë, të vijojë procedurën për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë", për subjektet që janë me procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi të mbajtura nga inspektorët.

Menjëherë dhe në vijimësi.

17.1. Rekomandimi: IMTV Kolonjë, gjatë arkëtimit, për të gjithë "Vendimet me Gjobë" që do të mbajë në vazhdim, të kërkojë edhe kamatë vonesë bazuar në llogaritjen e masës së gjobës.

Menjëherë dhe në vijimësi.

18.1. Rekomandimi: IMTV Bashkia Kolonjë, për të gjitha rastet në vijim, kur vendos masën administrative "dënim me gjobë", në akt-konstatim të referojë të dhëna të mjaftueshme, si: materialet e përdorura, përmasat, etj., në mënyrë që të bëhet e mundur kryerja e përllogaritjes së saktë të vlerës së masës administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi.

19.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV-së të marrë masa në vijimësi, që me nxjerrjen e vendimeve të mëtejshme brenda afatit 10-ditor për të gjitha rastet ku Inspektorët në terren kanë mbajtur akt-konstatime për ndërtime pa leje, duke respektuar procedurat e parashikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi.

20.1. Rekomandimi: Në të gjitha rastet, kur nga struktura e IMTV Kolonjë konstatohen punime pa leje ndërtimi, të referohen me kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Menjëherë dhe në vijimësi.

21.1. Rekomandimi: IMTV të marrë masa të ndjekë procedurat ligjore për ekzekutimin e masave administrative, duke dërguar fillimisht "Njoftimit për shlyerje vullnetarë të detyrimit" ndaj kundërvajtësve. Gjithashtu, të intensifikojë bashkëpunimin dhe koordinimin me Sektorin Juridik të Bashkisë Kolonjë për ndjekjen e mëtejshme të procedurave ligjore dhe paraqitjen në gjykatë të kërkesave për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit. Në rastet kur detyrimet nuk shlyhen në mënyrë

vullnetarë, çështjet të referohen pranë Zyrës së Përmbarimit Shtetëror, me qëllim rritjen e të ardhurave nga veprimtaria inspektuese.

Menjëherë dhe në vijimësi.

22.1. Rekomandimi: Zyra e kontrollit të territorit, Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, për kryerjen e inspektimeve duke përdorur dokumentet standard të procedurës së inspektimit. Gjithashtu të hartojë dhe përcjellë për miratim pranë Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, planin vjetor të aktivitetit. Drejtoria e Urbanistikës dhe Zyra e Kontrollit Bashkia Kolonjë të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe Zyra e Kontrollit, me qëllim miratimin e akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Kolonjë.

Menjëherë dhe në vijimësi.

23.1. Rekomandimi: Struktura e IMTV-së, të marrë masa, që në të ardhmen të administrojë në çdo dosje, ecurinë e procedurave të ndjekura rast pas rasti, në mënyrë që të lihet edhe gjurma e auditimit. Në vijim, procesverbalet (PVK, vendim gjobe, vendim pezullimi, vendim prishje), të firmosen nga inspektorët e pranishëm (apo kryeinspektori). Procesverbali të mbahet në vendin e kryerjes së kundërvajtjes dhe në kohën e konstatimit të saj, si rregull, në prani të kundërvajtësit dhe të dëshmitarëve të pranishëm dhe nënshkruhet nga përpiluesi, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka.

Menjëherë dhe në vijimësi.

B. Masa organizative mbi uljen e borxhit tatimor, rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim-taksat vendore dhe detyrimet nga qiradhënia

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa të menjëhershme për verifikimin dhe përditësimin e sipërfaqeve reale të ndërtesave për të gjitha subjektet aktive, bazuar në inspektime në terren dhe dokumentacion zyrtar. Për subjektet J H me NIPT L..L; A 9 me NIPT L...J; 6 K me NIPT K..T të kryej përditësimin e të dhënave mbi sipërfaqen e ndërtesës dhe të arkëtojë vlerën përkatëse. Gjithashtu, të nisë procesin e regjistrimit dhe detyrimit për pagesë të të gjitha subjekteve që kanë kontrata qiraje mbi pasuri të bashkisë, pavarësisht nëse kanë apo jo NIPT, duke përfshirë edhe ato me NIPT aktiv të cilat deri më sot nuk janë përfshirë në regjistrin tatimor vendor. Po ashtu, të marrë masa për rakordime ndërinstitucionale midis QKB dhe DRT për të garantuar që çdo subjekt aktiv në territorin e Bashkisë Kolonjë të jetë i regjistruar, i vlerësuar dhe i faturuar sipas ligjit për detyrimet vendore.

Brenda datës 31.12.2025.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave dhe strukturave të tjera përgjegjëse, të marrë masa për të përditësuar dhe përmirësuar regjistrin e familjeve tatimpaguese në përputhje me të dhënat e gjendjes civile dhe të përjashtimeve të miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak. Të rishikojë metodologjinë e planifikimit të të ardhurave për këtë kategori në mënyrë që të bazohet në të dhëna reale dhe të verifikueshme, si dhe të ndërtojë një sistem evidentimi që mundëson ndarjen e detyrimeve të vitit aktual nga detyrimet e mbartura. Të përfshihen në planifikim të gjitha familjet rezidente që nuk përfitojnë përjashtime ligjore dhe të rishikohet sistemi i përllogaritjes së tarifave në mënyrë që të pasqyrojë saktë ngarkesën fiskale. Po ashtu, të merren masa për përmirësimin e menaxhimit të regjistrit elektronik në përputhje me kuadrin rregullator për të garantuar transparencë, kontroll dhe përputhshmëri me kuadrin ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, strukturat përgjegjëse të marrin masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, duke evidentuar saktësisht të gjithë sipërfaqen e tokës në përdorim dhe duke identifikuar përdoruesit aktualë, përfshirë ato familje që kanë hequr dorë për efekt taksimi, por vijojnë të përfitojnë nga shfrytëzimi i tokës. Të përditësohet regjistri i AMTP-ve, të kryhet rakordimi midis të dhënave të drejtorisë së bujqësisë, drejtoria e të ardhurave dhe strukturat në terren, dhe të përfshihen në planifikim detyrimet e pa mbledhura për periudhën e mëparshme si dhe sipërfaqet shtesë të shpërndara. Po ashtu, të merren masa për analizën e trendit të arkëtimeve dhe përmirësimin e nivelit të mbledhjes së taksave për këtë zë, veçanërisht në njësitë administrative me debitë më të larta.

Menjëherë dhe në vijimësi.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për ndërtimin dhe zbatimin e një strategjie të posaçme për administrimin dhe uljen e detyrimeve të prapambetura, përmes analizës individuale të detyrimeve të prapambetura për çdo tatimpagues, evidentimit të shkaqeve të mospagimit, dhe përdorimit të mjeteve ligjore dhe administrative për rikuperimin e borxheve. Të hartohen planë vjetore dhe mujore për ndjekjen e arkëtimeve, të intensifikohet komunikimi me debitorët dhe të aplikohen penalitete ligjore kur është e nevojshme, përfshirë ndërprerjen e marrëdhënieve kontraktuale për shfrytëzimin e aseteve publike. Po ashtu, të përmirësohet raportimi dhe monitorimi i ecurisë së borxhit për të siguruar transparencë dhe kontroll efektiv mbi të ardhurat vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, strukturat përgjegjëse për përmirësimin e ndjekjes së kontratave dhe uljes së borxhit të marrin masa për forcimin e ndjekjes së zbatimit të kontratave të qirasë nëpërmjet krijimit të një mekanizmi të efikas për kontrollin periodik të shlyerjes së detyrimeve, përditësimin në kohë reale të regjistrave kontabël si dhe evidentimin e subjekteve debitorë. Duhet të hartohen planë-veprimesh për uljen graduale të debitit dhe të merren masa konkrete administrative dhe/ose ligjore për rikuperimin e të ardhurave të munguara nga subjektet qiramarrëse, përfshirë edhe aplikimin e penaliteteve për vonesa sipas përcaktimeve kontraktuale respektive.

Menjëherë dhe në vijimësi.

6.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë strukturat përgjegjëse të rishikojë praktikat aktuale për lidhjen e kontratave të reja të qirasë, ku në to të përfshijë klauzola me afate të qarta për fillimin e shfrytëzimit dhe arkëtimin e të ardhurave. Në kontratat e reja të qirasë, duhet të shmangen periudhat pasive nga hartimi i kontratës deri në fillimin e punimeve, ku prona është e dhënë me qira por nuk krijon të ardhura. Gjithashtu, çdo ndryshim i destinacionit të pasurisë duhet të kryhet me procedura dhe dokumentacion përkatës që justifikon kalimin e pasurisë nga pyll/kullotë në truall, në përputhje me kuadrin ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi.

C. Masa disiplinore Për punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, përcjellë me shkresën nr.319/14.Prot., datë 20.10.2025 mbështetur në nenin 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **ri kërkojmë**

dhe i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a -"Vërejtje" neni 58 shkronja (a), për 6 punonjës si më poshtë:

1. Z. G. E, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për mangësitë e konstatuara në dhënien me qira të tokave bujqësore.

***2.* Z. O. L,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, për mangësitë e konstatuara në arkëtimin e të ardhurave nga qiratë e tokave pyjore dhe bujqësore.

3. **Z. Sh. L,** në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:

Për mos zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara" i ndryshuar.

4. **Znj. E. D,** në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit pasi në 3 raste u konstatuar probleme në kriteret e veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar, përkatësisht "Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara, Bashkia Kolonjë"; "Rikonstruksion i terreneve sportive të shkollës së mesme të Bashkuar Jani Vreto Leskovik" dhe "Blerje materiale ndërtimi, hidraulike, elektrike, dekori, etj., Bashkia Kolonjë".

5. **Znj. A. K,** në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, pasi në 1 rast u konstatuar probleme në kriteret e veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar, përkatësisht "Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara, Bashkia Kolonjë".

6. **Z. E. Z,** në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 3 procedura, "Blerje Karburanti për nevojat e Bashkisë Kolonjë"; "Rikonstruksion i terreneve sportive të shkollës së mesme të Bashkuar Jani Vreto Leskovik"; "Blerje materiale ndërtimi, hidraulike, elektrike, dekori etj., Bashkia Kolonjë", vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.2 Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe pjesërisht të zbatuara, si dhe përshpejtimin e atyre në proces, të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme me ndikim financiar, administrativ dhe disiplinor, për Bashkinë Kolonjë, të përcjella me shkresat nr.683/26.prot., datë 23.05.2022, nr.1025/9, datë 22.05.2023 dhe nr.186/19, datë 25.07.2024. Konkretisht:

- Për masat e shpërblimit të dëmit dhe shpërblimit të dëmit ekonomik rezultojnë të pa arkëtuara ose të pa përfunduara procedurat për një vlerë totale prej 14,473,730 lekë pa TVSH. si dhe vijojnë të mbeten të pazgjidhura çështje që lidhen me vlerësimin dhe zhdëmtimin e dëmit në shumën 5,655,218 lekë.
- Për 4 masat administrative të rekomanduara ndaj subjekteve mbikëqyrëse të punimeve, për shkelje të konstatuara në kontrata ku vlera e punimeve të likuiduara por të pazbatuara është në total 25,172,991 lekë me TVSH. Këto rekomandime konsiderohen të pazbatuara dhe mbeten objekt ndjekjeje deri në zbatimin e plotë të tyre nga Bashkia Kolonjë. Konkretisht si më poshtë:

I. Masa për shpërblimin e dëmit të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.683/26.prot, datë 23.05.2022.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej 942,303 lekë pa TVSH nga shoqëria BOE "A."& "4." ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 2104.Prot., datë 08.06.2020 me objekt "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut" Bashkia Kolonjë.
1.2. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup punë të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe grupin e kolaudimit të punimeve si dhe SH.A. UJESJELLES-KANALIZIME, Ersekë me NUIS (NIPT) – K...O, Kolonjë në cilësinë e administrimit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pa vendosura në objekt.
-Gjithashtu të marrë masa për vendosjen e pajisjeve dhe funksionimin e scadës, në të kundërt arkëtimin e vlerës 4,390,946 lekë.
2.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup punë të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera, me qëllim arkëtimin e vlerës 1,264,272 lekë.
3.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej 1,323,023 lekë pa TVSH nga shoqëria OE "A K" ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 1022.Prot., datë 25.02.2021 me objekt "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës" Bashkia Kolonjë.
4.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej 290,800 lekë pa TVSH nga shoqëria OE "A." ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 5151.Prot., datë 29.10.2020 me objekt "Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit" Bashkia Kolonjë.

*II. Masa për shpërblimin e dëmit ekonomik të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.1025/9, datë 22.05.2023***.**
Rekomandimi 2.1: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 732,989 lekë pa TVSh nga BOE "A." SHPK & "E K" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2626.Prot, datë 07.08.2019, me objekt "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", Ersekë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
Rekomandimi 3.1: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 218,243 lekë pa TVSh nga BOE "Z." SHPK & "K." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5318.Prot, datë 05.11.2020, me objekt "Rikonstruksion i pjesshëm i godinës së Bashkisë Ersekë", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
Rekomandimi 4.1 Inspektorati i Mbrojtjes së territorit të Bashkisë Kolonjë të marren masa të menjëhershme për vendosjen e masës së gjobës si dhe nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit të merren masa të menjëhershme duke nxjerrë aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total 523,391 lekësh.

Rekomandimi 5.1: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit të merren masa të menjëhershme për ndjekjen e procedurave për vjeljen e detyrimit që ka lindur nga keq llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë prej 428,264 lekë ndaj subjektit me NIPT K...K "A K U K".

III. Masa për shpërblimin e dëmit ekonomik të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.186/19, datë 25.07.2024.

Rekomandimi 1.1: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,939 mijë lekë pa TVSH nga BOE "R." SHPK & "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5885.prot., datë 06.12.2023, me objekt "Rehabilitimi i digës së rezervuarit Gjonçit, Bashkia Kolonjë".

Rekomandimi 2.1: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë/Sektorin Juridik, Bashkia Kolonjë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës prej 1,515,106 lekë pa TVSH nga kontraktori OE "Z.", për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Rekomandimi 3.1: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë/Sektorin Juridik, Bashkia Kolonjë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës prej 1,574,784 lekë pa TVSh nga kontraktori BOE "Z." & "K.", për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Rekomandimi 4.1: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë/Sektorin Juridik, Bashkia Kolonjë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës prej 331,000 lekë pa TVSH nga kontraktori OE "Z.", për punime të likuiduara por të pa realizuara.

IV. Masa administrative për Inspektoratin e Mbrojtjes territorit, (IMT), të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.186/19, datë 25.07.2024.

1. Subjekti OE "V E" shpk, përfaqësuar nga administrator z. M. Sh, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

Në kontratën me objekt: "Rikonstruksioni i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtimi prita malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë", datë 06.12.2023, për punimet të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara **në vlerën 21,058,924 lekë me TVSH**.

2. Subjekti OE "T H C" shpk, përfaqësuar nga administrator z. E. C, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

Në kontratën me objekt: "Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë "Porta e Rehovës", datë 27.07.2022, për punimet të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara **në vlerën 1,818,127 lekë me TVSH.**

3. Subjekti OE "L C" Shpk, përfaqësuar nga administrator z. A. K, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

Në kontratën me objekt: "Rikualifikim i rrugës "Pali Prifti" Qyteti Ersekë", datë 12.07.2021, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara **në vlerën 1,898,740 lekë me TVSH.**

4. Subjekti OE "S." shpk, përfaqësuar nga administrator z. E. L, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

Në kontratën me objekt: "Rikonstruksioni i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë", datë 15.09.2022, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara **në vlerën 397,200 lekë me TVSH.**

Menjëherë dhe në vijimësi

B.MASA PER ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICIECNË DHE EFEKTIVITET TË ARDHURA TE MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të kontratave të qirasë së tokës bujqësore dhe fondit pyjor-kullosor rezultoi se, Bashkia Kolonjë administron 22 kontrata aktive për tokë bujqësore, me sipërfaqe totale 129.54 ha dhe vlerë vjetore kontraktore 730,339 lekë, si dhe 21 kontrata aktive për fondin pyjor-kullosor, me sipërfaqe totale 236.51 ha dhe të ardhura vjetore kontraktore në vlerën 4,096,115 lekë.
Nga verifikimi i detyrimeve kontraktore rezultoi se, në fund të vitit 2025, mbeten të pa arkëtuara detyrime në vlerën totale 235,316 lekë**,** nga të cilat 92,400 lekë lidhen me dy kontrata të tokës bujqësore, konkretisht: "G N" në vlerën 44,610 lekë dhe "B C" në vlerën 47,790 lekë; ndërsa 142,916 lekë lidhen me katër kontrata të fondit pyjor-kullosor, konkretisht: "6 K" në vlerën 25,000 lekë, "P B" në vlerën 60,000 lekë, "R A" në vlerën 48,200 lekë dhe "E Sh" në vlerën 9,716 lekë.
Gjithashtu, për tre kontrata aktive të fondit pyjor-kullosor, konkretisht "G G E", "S B K" dhe "L M", në evidencat përmbledhëse të Bashkisë nuk është pasqyruar vlera e qirasë dhe/ose e ardhurave kontraktore, por vetëm shënimi "sipas nenit 3 të kontratës". Për rrjedhojë, evidencat administrative nuk japin një pasqyrim të plotë dhe të unifikuar të të ardhurave të pritshme dhe të realizuara nga të gjitha kontratat aktive.
Konstatimet e mësipërme evidentojnë mangësi në sistemin e monitorimit dhe ndjekjes së kontratave të qirasë, veçanërisht në identifikimin në kohë të detyrimeve kontraktore, ndjekjen e arkëtimit të tyre, evidentimin e plotë të të ardhurave të pritshme dhe administrimin e unifikuar të informacionit kontraktor. Mungesa e një evidence të plotë dhe të përditësuar kufizon mundësinë e strukturave përgjegjëse për të monitoruar në mënyrë efektive përmbushjen e detyrimeve nga qiramarrësit dhe krijon risk për vonesë ose mos arkëtim të të ardhurave, moszbatim të penaliteteve kontraktore, si dhe mungesë transparence mbi të ardhurat që gjenerohen nga administrimi i aseteve publike. Këto veprime dhe mosveprime nuk janë në përputhje me kërkesat e neneve 4, 16 dhe 20 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe me kërkesat për administrimin financiar dhe menaxhimin e të ardhurave të parashikuara në ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", dhe nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 56–58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e të Ardhurave dhe strukturat përgjegjëse për administrimin e aseteve publike të marrin masa të menjëhershme për identifikimin, njoftimin dhe arkëtimin e plotë të detyrimeve kontraktore të papaguara në vlerën 235,316 lekë, duke respektuar afatet dhe procedurat.

Menjëherë.

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit, monitorimit dhe arkëtimit të detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kolonjë rezultoi se, në fund të vitit 2025, stoku i detyrimeve të prapambetura paraqitet në vlerën 75,900,866 lekë, kundrejt 71,671,222 lekë në fund të vitit 2024, duke shënuar një rritje neto prej 4,229,644 lekë, ose rreth 5.9%. Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar detyrime në vlerën 10,145,804 lekë, ndërkohë që janë krijuar detyrime të reja në vlerën **14,736,423**

lekë. Diferenca prej 4,590,619 lekë ndërmjet detyrimeve të reja të krijuara dhe detyrimeve të arkëtuara ka sjellë rritjen neto të stokut të detyrimeve të prapambetura në fund të periudhës.
Nga analiza sipas kategorive rezultoi se peshën kryesore të stokut të detyrimeve e zënë detyrimet e familjarëve për taksa dhe tarifa vendore, në vlerën 51,889,298 lekë, të cilat janë rritur me 4,958,925 lekë krahasuar me fundin e vitit 2024, pavarësisht arkëtimit gjatë vitit 2025 të shumës prej 3,491,348 lekë**.**
Detyrimet e subjekteve të biznesit paraqiten në vlerën 10,187,719 lekë, nga të cilat 5,502,986 lekë i përkasin subjekteve juridike dhe 3,804,661 lekë subjekteve fizike, ndërsa detyrimet për kamatëvonesa paraqiten të rritura në vlerën 892,464 lekë.
Gjithashtu, detyrimet që burojnë nga kontratat e qirasë paraqiten në vlerën 9,434,947 lekë, nga të cilat detyrimet e kontratave të HEC-eve përbëjnë 6,331,803 lekë, ose rreth 67.1% të kësaj kategorie. Në të njëjtën kohë, detyrimet ndaj operatorëve të telekomunikacionit, së bashku me kamatëvonesat përkatëse, arrijnë në vlerën 1,983,700 lekë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura rezultoi se strukturat përgjegjëse të Bashkisë Kolonjë nuk kanë siguruar një administrim të mjaftueshëm, sistematik dhe efektiv të debitorëve, nëpërmjet identifikimit dhe klasifikimit të tyre sipas nivelit të riskut, monitorimit periodik të detyrimeve, njoftimit dhe ndjekjes së debitorëve, si dhe ndërmarrjes në kohë të masave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve. Mos administrimi dhe mos ndjekja në mënyrë efektive e detyrimeve të prapambetura nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 22, nenit 32, nenit 39 dhe nenit 41 të Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", me nenin 4, nenin 16 dhe nenin 20 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe me kërkesat e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqet 58–60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e të Ardhurave dhe strukturat e tjera përgjegjëse për administrimin e të ardhurave vendore, në zbatim të paketës fiskale dhe legjislacionit në fuqi, të marrin masa për forcimin e sistemit të administrimit, monitorimit dhe kontrollit të detyrimeve të prapambetura, duke hartuar dhe miratuar një plan të detajuar masash, i cili të përcaktojë debitorët, shumën e detyrimit, kategorinë, vjetërsinë, nivelin e riskut, masën administrative/ligjore që do të ndërmerret, strukturën përgjegjëse dhe afatin e realizimit.
Të vendoset një mekanizëm periodik raportimi pranë Kryetarit të Bashkisë dhe strukturave drejtuese, në mënyrë që të monitorohet realizimi i arkëtimeve, krijimi i detyrimeve të reja dhe ndryshimi i stokut të debisë, me synim që detyrimet e reja të krijuara të mos tejkalojnë detyrimet e arkëtuara dhe që stoku i detyrimeve të prapambetura të reduktohet në mënyrë progresive.

Menjëherë dhe në vijimësi.

2.2. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave dhe strukturat përgjegjëse për administrimin e të ardhurave vendore të marrin masa për intensifikimin e procedurave të evidentimit, njoftimit, ndjekjes dhe arkëtimit të detyrimeve të prapambetura prej **75,900,866 lekë**, me përparësi ndaj:
- detyrimeve të familjarëve për taksa dhe tarifa vendore, në vlerën 51,889,298 lekë;
- detyrimeve të subjekteve të biznesit, në vlerën 10,187,719 lekë;
- detyrimeve që burojnë nga kontratat e qirasë, në vlerën 9,434,947 lekë, veçanërisht detyrimet e kontratave të HEC-eve në vlerën 6,331,803 lekë;
- detyrimeve për kamatëvonesa dhe detyrimeve të tjera të pashlyera ndaj operatorëve ekonomikë dhe qiramarrësve.

C.MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shte*tit"; shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civi*l"; nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*", kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kolonjë** të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

"*Vërejtje*" për 13 (trembëdhjetë) punonjësit, si më poshtë:

1.Z. P. R, Nënkryetar i Bashkisë Kolonjë
2.Znj. **D.T,** Drejtor i Drejtorisë se Burimeve Njerëzore për mangësitë e konstatuara ne menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe për mos zbatimin e rekomandimeve te KLSH-se në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shte*tit" dhe Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar.
3. Znj. L. S, Përgjegjëse në Sektorin e Auditit të Brendshëm për mangësitë e konstatuara ne auditin e brendshëm, dhe për mos zbatimin e rekomandimeve te KLSH-se në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shte*tit" dhe Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar
4. Znj. G. D, në cilësinë e nëpunësit zbatues në Bashkinë Kolonjë për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare si dhe për mos zbatimin e rekomandimeve te KLSH në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shte*tit", Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar.
5. Z. P. L, kryeinspektor i IMTV;
6. Z. E. J, Drejtor i të Ardhurave;
7. Z. M. T, Drejtor i Urbanistikes;
për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara për mos zbatimin e rekomandimeve te KLSH në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shte*tit"
8. Z. A. F, *specialist në Sektorin e Auditit të Brendshëm, Bashkia Kolonjë* për mangësitë e konstatuara ne auditin e brendshëm ne kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar.
9. Znj. L. K, specialiste e te ardhurave;
10. Z. F. D, specialiste e te ardhurave;

11. Znj. E. I, specialiste e te ardhurave;
12. Z. J. Z, Inspektorë te taksave dhe tarifave vendore;
13. Z. R. H, Inspektorë te taksave dhe tarifave vendore;
për mangësitë e konstatuara ne mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ne kundërshtim Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligjin nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*"; Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "*Për regjistrimin e biznesit*" i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore.*

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Kolonjë, Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT